

"Beledije - Objekti Rajonal i trajnimit për Trashëgimi Kulturore"

Konspekt i ligjëratave për menaxhimin e trashëgimisë Ekstrakt nga kurset e trajnimit të Beledijes

Beledije



Projekti: "Zhvillimi i një Objekti Rajonal për
Trashëgimi Kulturore në Kosovë"



An EU funded project managed by
the European Union Office in Kosovo

Projekti: 'Zhvillimi i një Objekti Rajonal
për Trashëgimi Kulturore në Kosovë'

Konspekt i ligjëratave për menaxhimin e trashëgimisë

Ekstrakt nga kurset e trajnitimit të Beledijes

Beledije



An EU funded project managed by
the European Union Office in Kosovo

Tabela e Përmbajtjes

Parathënie	5
Ambasadori i Zyrës së BE-së në Prishtinë	5
Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kosovë	7
Lista e autorëve	8
Hyrje nga Maria Luigia Calia, Udhëheqëse e Ekipit	9
Kapitulli 1	15
Konservimi dhe Menaxhimi i Trashëgimisë	15
Metodat dhe praktikat për ruajtjen dhe jetësimin e Qendrave historike, nga Prof. Emin RIZA	15
Qasjet e menaxhimit të trashëgimisë, nga Jukka Jokilehto	23
Definimi i Trashëgimisë Botërore	35
Sistemet e Menaxhimit	30
Konkluzion	36
Definicioni dhe Ruajtja e Peizazhit Urban Historik, nga Jukka Jokilehto	39
Definicionet Përkatëse	39
Lidhur me identifikimin e PUH-it	42
Referencat doktrine?	44
Qasjet në PUH	46
Korniza strategjike	47
Veglat e Planifikimit dhe Menaxhimit	51
Dimensioni i paprekshëm në trashëgiminë kulturore	55
Disa reflektime për interpretimet moderne dhe tradicionale, nga Jukka Jokilehto	55
Çmagjepsja e Perëndimit	56
Hyjnorja dhe shpirtërorja në shoqërinë tradicionale	58
Dimensioni i paprekshëm në veprën e artit	60
Kapitulli 2	63
Dokumentimi dhe Hetimi	63
Parimet Udhëzuese, Mjetet dhe Teknikat për Dokumentim, nga Rand Eppich	63
Dokumentacioni për zhvillimin e Planit të Konservimit, nga Alessandro Pergoli Campanelli	75
Kapitulli 3	89
Menaxhimi i Muzeut	89
Prezantimi i Menaxhimit të Muzeut nga Barbara Ravnik	89

Politikat për Menaxhimin e Muzeut në Shqipëri, nga Ols Lafe	95
Kapitulli 4	107
Ekonomiciteti i Trashëgimisë	107
Vlera ekonomike e Trashëgimisë Kulturore, nga Xavier Greffe	107
Trashëgimia Kulturore për zhvillim lokal nga Marco Acri	133
Kapitulli 5	
Komunikimi dhe Promovimi i Trashëgimisë	145
Komunikimi dhe Interpretimi i Trashëgimisë Kulturore, nga Mirko Tattarini	145
Bibliografi	163

Parathënie

Ambasadori Samuel ŽBOGAR i Zyrës së BE-së në Prishtinë

Ishte një kohë kur thënia më e përshtatshme në arkitekturë ishte “forma e ndjek funksionin”. Nganjëherë këtu në Kosovë e kam përshtypjen se thënia më e përshtatshme është “Përmbajtja e ndjek ndërtesën”.

E kam pasur këtë ndjenjë kur vizituam qendrën Europa në Prizren, e mbushur me një përmbajtje të madhe të filmave dokumentarë. Dhe e kam të njëjtën ndjenjë tani, derisa po e lexoj këtë konspekt të ligjëratave për menaxhimin e trashëgimisë të kurseve të trajnimit të Beledijes. Ai është aq i pasur në përmbajtje që jep, nganjëherë edhe në mënyrë retroaktive, kuptimin e aktiviteteve tona të restaurimit, duke i kthyer ato në njëfarë renesance, rilindje. Sikurse këto mure të bukura dhe dhoma të vjetra të bukura e kanë marrë ndonjë injektim të ri të jetës, pasi që diçka energjike po ndodh këtu, qofshin ato ligjëratat, turistët që vizitojnë, madje edhe fëmijët që luajnë në kopsht.

Natyrisht, kjo është e dyanshme: pa përmbajtje shumë mirë të konceptuar, pa reflektim të plotë dhe shumë studime asnjë ndërtesë nuk do të ndërtohet ose restaurohet. Në këtë kuptim, ndërtesa gjithmonë e ndjek përmbajtjen. Dhe për fat të mirë, që nga dita e parë, përmbajtja e Beledijes së restauruar ishte menduar mirë: ajo ishte identifikuar që të bëhet, siç e thotë Udhëheqësja e Ekipit Maria Luigia Calia në mënyrë ambicioze në hyrjen e vet, “Qendra e Parë Rajonale për Trashëgiminë Kulturore në Ballkan”.

Në mënyrë që ta përmbushim këtë ambicie, shumë lojtarë duhet të na bashkohen në lojën tonë, duke ia filluar nga autoritetet komunale e deri tek universitetet kombëtare, por ambicia ekziston - ndërsa kurset e trajnimit me programet e tyre të cilësisë së ekspertit, që shtrihen prej restaurimit deri në menaxhimin dhe promovimin, e tregojnë rrugën e drejtë. Vetëm me standardet evropiane dhe me respektimin më të madhe të trashëgimisë lokale është e mundur që të lëvizen gjërat dhe për t’i ndryshuar ato për të mirë.

Ne të gjithë e dimë se Kosova i ka pasur disa përvoja të hidhura kur flasim për ruajtjen e cilësisë edhe të peizazhit urban dhe atij natyror. Njohuria eksperte, e kombinuar me një përkushtim të fortë të autoriteteve për t’iu ndihmuar ekspertëve që ta bëjnë punën e tyre, është e vetmja mënyrë për riparimin e disa prej gabimeve më të dhimbshme - dhe që të mos bëhen të reja.

Prizreni, me përzjerjen e vet unike të kulturave dhe historive, të njerëzve dhe tregimeve, mund të jetë qendra prej së cilës një mesazh i tillë themelor i res-

pektit ndaj traditës, mund të komunikohet më së miri. Dhe Beledije duhet të jetë “syri i kësaj stuhie”, qendra e kësaj qendre. Përmes çdo nxënësi të ri ose profesionisti, të arsimuar në këtë qendër, mesazhi do të transmetohet përreth, jo vetëm në Kosovë por në tërë rajonin. Dhe nëse shikoni përreth në rajon, ky mesazh është i nevojshëm në shumë adresa.

Kështu që unë shoh një të ardhme të madhe për qendrën Beledije, një potencial të madh për ligjëratat e saj, madje edhe një nevojë të madhe për brezin e ri të profesionistëve të shkolluar dhe të përkushtuar në fushën e restaurimit dhe menaxhimit të trashëgimisë. Ne Bashkimi Evropian do të bëjmë atë që mundemi: të këmbëngulim në standarde të larta, t’i bashkojmë njerëzit, të përpiqemi për të gjetur burime njerëzore dhe financiare – dhe ta mbështesim çdo lëvizje për një jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës. Kjo është arsyeja pse ne jemi këtu.

Ministri Z. Memli Krasniqi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kosovë

Kosova është e pasur me trashëgimi kulturore dhe një qendër sikur Beledije, e para në Ballkanin Perëndimor, ka qenë një hap shumë i rëndësishëm që kemi bërë bashkërisht. Konsideroj se për një vit, prej kur është hapur kjo qendër për trajnime në fushën e trashëgimisë kulturore, në qytetin historik të Prizrenit, ajo i ka shërbyer shumë qëllimeve për të cilat edhe është ngritur.

Beledije ka qenë vërtetë një vend bashkëpunimi dhe i shkëmbimit të përvojave nga gjitha anët e Ballkanit Perëndimor. Po ashtu ka qenë një shtytës shumë i rëndësishëm për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e trashëgimisë kulturore, e aq më tepër në ngritjen profesionale të kuadrove të reja. Është shumë domethënëse që në trajnimet e organizuara gjatë një viti kanë marrë pjesë ekspertë të njohur botërorë të fushës së trashëgimisë dhe interesimi për të ndjekur këto trajnime ka qenë nga i gjithë rajoni.

Unë dua të shpreh një falënderim për të gjithë mbështetësit e kësaj qendre, në veçanti Komisionin Evropian, për kontributin që kanë dhënë që vërtetë Qendra Beledije të kryejë me sukses misionin e vet.

Ky është viti i dytë nëpër të cilin po hyn Qendra Beledije dhe natyrshëm që na presin ditë edhe më të mira. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është shumë e përkushtuar që kjo qendër trajnuese të jetë një tregim i suksesshëm që do na shërbej në rritjen e aftësive tona në menaxhimin, promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore.

Dua të ritheksoj edhe një herë përkushtimin tonë për të punuar edhe më shumë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ne kemi diversitet kulturor që na bën unik, dhe që duhet të na shërbejë të gjithëve si një pikë afrimi.

Lista e autorëve

Arkitekt. Marco ACRI, Konsultues në Universitetin e Nova Gorica-s, Slovenia

Arkitekt. Rand EPPICH, ekspert ndërkombëtar për Dokumentimin dhe Sondazhin e Trashëgimisë Kulturore, Spanjë

Prof Xavier GREFFE, Paris 1, Sorbonne, Francë

Prof Jukka JOKILEHTO, Këshilltar Special i Drejtorit të Përgjithshëm të ICCROM-it, Itali

Dr. Ols LAFE, Drejtor i Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Shqipëri

Prof. Alessandro PERGOLI CAMPANELLI, Universiteti i Romës, Itali

Dr. Barbara RAVNIK, Drejtoreshë e Muzeut Kombëtar, Slloveni

Prof. Emin Riza, Kryetar i Akademisë së Shkencave Shqiptare, Shqipëri

Prof. Mirko TATTARINI, ISIA - Universiteti i Firences, Itali

Hyrje nga Maria Luigia Calia, Udhëheqëse e Ekipit

Ky konspekt e përmbledh një përzgjedhje të ligjëratave të cilat janë dhënë në 5 kurse serike të trajnimit, të implementuara nga projekti **“Zhvillimi i një Objekti Rajonal për Trashëgimi Kulturor në Kosovë”** në **Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturorë Beledije** me vendndodhje në Prizren. Projekti është financuar dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Projekti “Zhvillimi i një Objekti Rajonal të Trashëgimisë Kulturorë në Kosovë” kishte për qëllim që të siguronte zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e ekspertizës në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturorë dhe praktikave të konservimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet themelimit dhe menaxhimit të një Objekti për Trajnim mbi Trashëgiminë Kulturorë. Programi i trajnimit është përpiluar si rezultat i vlerësimit të nevojave për trajnim, në mënyrë që të përmbushen nevojat e burimeve njerëzore të Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor për restaurimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturorë. Ndërtesa e Beledijes në Prizren¹ është identifikuar që të bëhet “Qendra e Parë Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Ballkan.”

Pesë kurset e trajnimit të Beledijes (Secili me kohëzgjatje 2 javore dhe me një numër mesatar të trajnuarve prej 20) ishin të dedikuara që ta përmirësojnë ndërtimin e kapaciteteve individuale dhe institucionale dhe për t'i rritur aftësitë Kosovare dhe rajonale, më saktë, konceptin e konservimit dhe teknikat e ndryshme të tij, mjetet për inventarizim dhe sondazh, valorizim, interpretim dhe promovim, paraqitje për vlerën e trashëgimisë dhe rolin e saj në zhvillimin lokal, operacionet e marketingut dhe përfshirjen e komunitetit lokal.

Ky koleksion i ligjëratave është i bazuar në qasjen e menaxhimit të integruar² të trashëgimisë kulturorë, me fokus në mënyrën e të menduarit bashkëkohor, praktikave të planifikimit dhe dizajnit e parimeve dhe metodave të aplikuar në restaurim, konservim dhe në menaxhimin e trashëgimisë. Konceptet i ndjekin konventat ndërkombëtare, kartat dhe politikat e përcaktuara në veçanti nga Këshilli i Evropës, UNESCO, ICOM, ICOMOS dhe ato të adoptuara nga shumica e vendeve në botë. Këtu përfshihen raste studimore që kanë të bëjnë me aspektet e menaxhimit për mbrojtjen e trashëgimisë dhe kërkime për konservimin e ndërtesave historike, siteve arkeologjike dhe menaxhimin e siteve të trashëgimisë dhe muzeve.

1 Ndërtesa është restauruar nga Zyra e BE-së në Kosovë

Programi mësimor i trajnimit të Beledijes i përcaktuar nga një grup ekspertësh³, në bashkëpunim me përfituesit e projektit, është përshtatur që t’u përballur me nevojat reale për ngritjen e shkathtësive dhe njohurive që kanë të bëjnë me konservimin e trashëgimisë. Ky program përfshiu tendenca të ndryshme bashkëkohore mbi metodat teknologjike për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore nëpër muze dhe vende arkeologjike, qasje të mirëmbajtjes dhe teknika të restaurimit, qëndrueshmëri në bazë të zhvillimit lokal, ndërtimin e kapaciteteve, implementimin dhe monitorimin e aktiviteteve.

Përveç ligjëratave, kurset ofruan ushtrime të vlefshme praktike për të zhvilluar shkathtësi të posaçme në vlerësim, interpretim, menaxhim, formulim të politikave, dokumentim të vendeve të rëndësishme kulturore, konservimin e materialeve tradicionale, metoda të sondazhit dhe dokumentimin për regjistrimin e komponentëve, identifikimin e metodave kërkimore, metodologji vlerësuese për t’i caktuar prioritetet e konservimit dhe planet e përshtatshme për konservim dhe menaxhim, politika dhe strategji.

Përmbajtja e këtij konspekti është hartuar nga kontributet e një grupi ndërkombëtar të ligjëruesve që kanë qenë të përfshirë gjatë 5 kurseve të trajnimit të Beledijes, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e pasurisë trashëgimore dhe politikat për menaxhimin e saj.

Përpjekja e vënë në këtë seri të programeve të trajnimit ka dhënë një ndikim pozitiv në praktikën e mirë dhe interesim në një proces ndërgjegjshëm të konservimit dhe restaurimit. Sesionet e trajnimit dhe punëtoritë gjithashtu e krijuan një gjuhë të përbashkët dhe shkëmbime profesionale duke krijuar një marrëdhënie (përfituese për të dyja palët) në mes të teorisë dhe praktikës për të gjetur zgjidhje lokale për menaxhimin e trashëgimisë lokale.

Ky konspekt është strukturuar në 5 kapituj:

1. Konservimi dhe Menaxhimi i Trashëgimisë

Në këtë kapitull, objektivat kryesore sa i përket menaxhimit janë paraqitur për të ofruar dhe siguruar efikasitetin e burimeve të trashëgimisë kulturore. Nocioni

2 Qasja e menaxhimit të integruar është definuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1976 në “Kërkesat e Rezolutave për Konservim të Integruar të Trashëgimisë Kulturore”. Konservimi i Integruar e trashëgimisë së ndërtuar kulturore paraqet një qasje të re, duke filluar nga analizat e politikave relevante Evropiane në një aspekt ekonomik. Shih tekstin e plotë: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=664497>

3 Programi mësimor dhe drafti i parë i trajnimit të Beledijes është përgatitur nga një grup ekspertësh të angazhuar për afat të shkurtër: Prof. Zeynep Ahumbay, Profesor në Universitetin Teknik të Stambollit, Turqi, Prof. Alkiviadis Prepis, Profesor në Universitetin Dimokritos, Greqi, Prof. Emin Riza, Shqipëri, Prof. Irina Subotić, Professore në emeritus, Serbi.

i konservimit që aplikohet në trashëgiminë kulturore merr një kuptim shumë kompleks i cili fokusohet në aspekte të ndryshme. Konservimi definon veprimet që fokusohen në kuptimin e trashëgimisë kulturore, njohjen e historisë së saj dhe rëndësisë së saj, sigurimin e mbrojtjes së saj fizike dhe prezantimin, restaurimin dhe përmirësimin. Njohuria është një hap për ta siguruar një analizë në kushtet aktuale fizike dhe funksionale të trashëgimisë, për t'i identifikuar kërkesat specifike të restaurimit dhe mirëmbajtjes së sitit.

Temat që kanë të bëjnë me konservimin, si cenueshmëria dhe mirëmbajtja, duhet të trajtohen me një qasje të e cila nuk i ka konsideruar vetëm relacionet midis funksioneve të ndryshme të menaxhimit përbrenda sajtit, por edhe relacionin e ri që del midis sitit dhe territorit, nga këndvështrimi i qasjes së integruar.

Kurset e trajnimit ofruan ligjërata për:

- Aktivitetet që ndërliiden me implementimin e Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës (Konventa e Trashëgimisë Botërore)
- Mbështetjen teknike për hartimin dhe Implementimin e Planeve të Konservimit dhe Menaxhimit
- Definicionin e proceseve kërkimore zhvillimore, në veçanti për çështjet e konstruktimit.

2. Dokumentimi dhe Hetimi

Sondazhi dhe dokumentimi, që mbulojnë një gamë të gjerë të teknikave të aplikuara në tipologji të ndryshme të siteve, duke ia filluar nga ndërtesat individuale e deri tek peizazhet kulturore janë hapi themelor për ta kuptuar një ndërtesë historike dhe janë vendimtare për vlerësimin e një Plani të Konservimit. Trajnimi prezantoi metoda dhe teknika të ndryshme duke filluar nga sondazhi me dorë e deri tek skanimi me laser dhe modelimi kompjuterik 3D, si dhe nocionet mbi regjistrimin, vlerësimin e kushteve, menaxhimin e të dhënave dhe mjetet për hetim dhe monitorimin. Dokumentimi i siteve të trashëgimisë mundëson një kuptim më të mirë të vlerës së sitit dhe nevojat e tij reale për ruajtje dhe punë restauruese. Informatat e siguruar përmes procesit të dokumentimit iu ndihmojnë profesionistëve të konservimit që ta vlerësojnë gjendjen e artit të ndërtesës dhe i ndihmon ata që ta gjejnë planin më të përshtatshëm ndërhyrës dhe trajtimet që duhet të aplikohen. Kemi ilustruar disa shembuj të aktiviteteve të sondazhit dhe të dokumentimit si praktikat më të mira ku demonstron përdorimi i suksesshëm i qasjeve të ndryshme të regjistrimit dhe dokumentimit nëpër situata të ndryshme.

3. Menaxhimi i Muzeve

Administrimi i Muzeve i paraqet kërkesat për ta krijuar një administrim dhe menaxhim të ri të një Muzeu të caktuar, që korrespondon me një institucion modern, duke e bërë përditësimin e dokumentimit, prezantimit, konservimit dhe nivelin e sigurisë së koleksionit. Disa tema kryesore janë marrë parasysh si definicioni i funksioneve të muzeve, misioni dhe roli, deklarata menaxheriale dhe administrimi financiar dhe planifikimi i efikasitetit, konservimi i koleksioneve dhe studimi i tyre, qasja e tyre dhe mirëmbajtja, marrëdhënia me komunikimin publik, promovimi dhe krijimi i politikave arsimore, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mjetet e TIK-ut të aplikuara nëpër muze.

4. Ekonomiciteti i Trashëgimisë

Vëmendje e veçantë është dhënë për ta theksuar rëndësinë e mënyrave, përmes së cilave trashëgimia e prekshme dhe e paprekshme është e ndërlidhur me traditat, njohurinë teknike dhe kreativitetin lokal, si dhe me vlerat shoqërore dhe një rol të rëndësishëm si një identitet dhe faktor i përfshirjes shoqërore. Roli i trashëgimisë kulturore kërkon një rëndësi në rritje brenda modeleve në zhvillim, duke u bazuar në identitetin lokal dhe valorizimin e burimeve vendore, nëpërmjet rritjes së burimeve lokale, pjesëmarrjen dhe ndarjen e proceseve zhvillimore me palët lokale të interesit. Procesi ka filluar me anë të negociatave dhe planifikimit të sistemeve dhe parimeve të llogaridhënies, pajtueshmërisë dhe qëndrueshmërinë së intervenimeve, që ka të bëjë me burimet e përfshira të cilat stimulojnë turizmin dhe inkurajojnë zhvillimin lokal drejt konservimit të trashëgimisë.

Për ta siguruar një integrim të plotë në zhvillimin territorial, sektori i trashëgimisë kulturore ka nevojë për mjete të cilat janë të mjaftueshme për t'i rritur dhe mbajtur potencialet e territorit të caktuar, në mënyrë që të tejkalohen pengesat dhe t'i ulin faktorët e rrezikut për konservimin dhe mbijetesën e trashëgimisë kulturore, si:

- Zhvillimin e një sistemi të përbashkët për menaxhimin e njohurisë për t'i definuar proceset e vendimmarrjes, i cil e përbën bazën e veprimtarive të konservimit.
- Nevoja e njohurisë specifike shkencore dhe përvojat për hulumtim, planifikim dhe menaxhimin e ndërhyrjeve për konservim, konsolidim dhe restaurim.

5. Komunikimi dhe Promovimi i Trashëgimisë

Procesi i komunikimit dhe i interpretimit të Trashëgimisë konsiderohet qendror për përmirësimin e qasjes në të dhe të kuptuarit e trashëgimisë nga publiku.

Në mënyrë që të arrihet ky qëllim, në trashëgiminë kulturore janë përcaktuar një grup i parimeve dhe strategjive në përputhje me teoritë dhe praktikat aktuale, në veçanti sipas ICOMOS-it "*Kartës për interpretimin dhe Paraqitjen e objekteve të Trashëgimisë Kulturore*" (2008). Kjo Kartë paraqiti nevojën për zhvillim, për t'i udhëhequr metodat e interpretimin dhe prezantimit për ta siguruar një kuptueshmëri më të mirë dhe mbështetje për konservimin e trashëgimisë, si për vizitorët ashtu edhe për lokalët.

Midis sfidave tjera që menaxherët e muzeve dhe të trashëgimive ballafaqohen është nevoja për të zhvilluar strategji efektive të interpretimit, ndërsa sigurojnë atraktivitet dhe qasje për vizitorët dhe turistët të cilët kanë pritje dhe formime të ndryshme kulturore. Në këtë kontekst, interpretimi është një mjet fundamental për ngritjen e vetëdijesimit kulturor dhe mirëkuptimin reciprok. Përdorimi i mjeteve të ndryshme dhe TIK-ut, si metoda më e përshtatshme është ekzaminuar që t'iu përshtatet audiencave të ndryshme me një njohje të dokumentuar të rëndësisë së trashëgimisë.



Kapitulli 1

Konservimi dhe Menaxhimi i Trashëgimisë

Metodat dhe praktikat për ruajtjen dhe jetësimin e Qendrave historike, nga Prof. Emin RIZA

Ndjeshmëria për vlerat e trashëgimisë së paluajtshme ndërtimore në hapësirat europiane dhe më gjerë, është dukuri e shfaqur rreth fillimit të shek. XIX. Kryesisht atë e ndeshim në Francë, Angli dhe Itali. Ecuria e kristalizimit të parimeve të vlerësimit të kësaj pasurie unike, në rrafsh mbarëbotëror, pati ecuri rreth 150 vjeçare. Kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore, në hapësirat perëndimore europiane shkallërisht, por krahasimisht shpejt, u formësuan parimet e vlerësimit të monumenteve, pra edhe të Qendrave historike, Dokumenti i parë ndërkombëtar, i cili trajton thujtë mbarë problematikën e monumenteve në kuptimin e gjerë të termit është karta e Athinës e vitit 1931. Është rasti për të theksuar se arritja, krahasimisht shpejt, e mendësisë së trajtimit të njësuar të kriterëve të vlerësimit të trashëgimisë së kulturës ndërtimore, është pasqyrimi i drejtpërdrejtë i së vërtetës mbi njësinë e treguesve thelbësorë të kësaj trashëgimie. Për pasojë, mes të tjerash, mund të pohohet që në krye, se dallimet etniko-rajonale, gjithë duke qenë të pranishme, janë dytësore, në përjasje me njësinë e këtyre krijimeve, e cila është parësore. Ndër aktet metodiko-normative më të rëndësishme të përpjekjeve të arritura për kodifikim të kriterëve vlerësues të monumenteve, përmendim: “Karta Ndërkombëtare e Konservimit dhe Restaurimit të Monumenteve dhe Siteve” e vitit 1964, e cila tashmë emërtohet Karta e Venecias, si dhe “Dokument i Naras mbi Autenticitetin”, i vitit 1995. Krahas, një sërë udhëzimesh, rekomandimesh dhe konventash, synojnë të njësojnë vlerësimin e monumenteve, si dëshmi të pazëvendësueshme historiko-kulturore në hapësirë dhe kohë.

Monumentet e kulturës së gjinisë ndërtimore ndahen në disa kategori, mbi bazën e kriterëve të ndryshme cilësues të këtyre kategorive. Sipas gjinisë, në ndërtime mbrojtëse, kulti, shoqërore dhe banesa. Sipas kriterit numerik, dallojmë monumentet e veçantë, ansamblet dhe Qendrat historike. Sipas gjendjes teknike, në rrënoja, shpesh të dala në dritë prej gërmimesh arkeologjike dhe ndërtime që ende ruhen në këmbë. Kuptueshëm kategorizime të tjera nuk përjashtohen. Bashkëmarrëdhëniet e monumenteve, të përfshirë në klasifikimet e mësipërme, janë të ndryshme. Qendrat historike, shfaqin llojin më gjithëpërfshirës të vlerave të monumenteve ndërtimore. Këto qendra, sipas rastit, përfshijnë një kategori të vetme ndërtimore, ndërsa përgjithësisht mbarë kategoritë ndërtimore në gjendje rrënoje, në atë funksionale, apo në të gjitha gjendjet, në shkallë të ndryshme

raportesh numerike. Me termin Qendër historike, emërtohet një bashkësi urbanistiko-ndërtimore e një apo disa periudhave historike, e cila, ruhet në shkallë të përfillshme autenticiteti dhe si e tillë shfaq vlera historikokulturore.

Qendrat historike lidhur me mënyrën e sigurimit të mjeteve të jetesës së banorëve të tyre, ndahen në qendra të banuara fshatare apo qytetare. Në hapësirat shqiptare, tradicionale dhe të sotme, për arsye të kuptueshme jashtëshken-core, përkujdesjet për identifikimin dhe ruajtjen e këtyre vlerave unike shfaqen së pari në hapësirat e Shqipërisë politike. Që në vitin 1961, qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës vihen në mbrojtje shtetërore, në cilësinë e “qyteteve muze”, duke u rreshtuar Shqipëria ndër vendet e para europiane për përkujdesjet ndaj bashkësive ndërtimore. Më pas u vunë në mbrojtje qendrat historike të Korçës, Elbasanit, Shkodrës, Vlorës, Durrësit dhe Tiranës. Në Kosovë, është vënë në mbrojtje vetëm një zonë në Prizren, qytetin shumëvlerësh për historinë dhe kulturën shqiptare, ndërsa në hapësirat e banuara historikisht dhe sot prej shqiptarësh në Serbi, Malin e Zi, Maqedoni dhe Greqi, nuk ndeshim asnjë përkujdesje për trashëgiminë kulturore të etnosit shqiptar. Kriteret për klasifikimin e zonave, brenda dhe përreth hapësirave të qendrave historike, si dhe ndërtimeve që formojnë këto qendra, krahas rrugëve, i kanë qëndruar kohës. Rregullorja e mbrojtjes së qytetit-muze të Beratit dhe zonifikimi i tij i vitit 1961 janë dëshmi të prekshme për sa u përmend. Së fundi, shpallja “Pasuri Botërore” e qendrës arkeologjike të Butrintit dhe atyre historike të Gjirokastrës dhe Beratit, janë dëshmi të konfirmuara prej organit më kompetent, UNESCO-s, të këtyre vlerave të trashëgimisë shqiptare, të cilat tashmë janë pasuri e mbarënjëzimit.

Për arsyet e përmendura më sipër, në këtë leksion, i cili synon parashtrimin e problematikave të vlerësimit të Qendrave historike, pra, gjurmimit, vënies në mbrojtje, dokumentimit, studimit, restaurimit, rijetësimit dhe botimeve, jemi mbështetur kryesisht në përvojën e Shqipërisë dhe natyrisht në atë tashmë të kristalizuar ndërkombëtarisht. Siç përmendëm, këto përvoja kanë qenë në bashkëpërputhje që në krye të herës, pra që rreth viteve 1960. Qendrat historike, në kuptimin e gjerë përfshihen në kategorinë monument, gjithë duke qenë bashkësi ndërtimore, të cilat ruajnë dëshmi autentike urbanistiko-ndërtimore, kryesisht banesa, ndërtime kulturi etj., brenda muresh rrethues, pra të fortifikuara, ose pa mbrojtje të këtij lloji. Në krahasim me monumentet e veçantë, apo me njësi të vogla ndërtimore, qendrat historike, për shkak të hapësirave të gjera jetësore që përfshijnë, shfaqin vlera madhore dëshmish historiko-kulturore. Mënyra e jetesës në të kaluarën, një tregues i dorës së parë, me vlera të mirëfillta dokumentare, shfaqet dukshëm te Qendrat historike të së kaluarës, përgjithësisht të dala në dritë prej gërmimesh arkeologjike apo të jetueshme ende, me vështirësi. Pra, Qendrat historike, ashtu si monumentet në përgjithësi, janë dëshmi të prekshme historiko-kulturore, krahasimisht të rralla, për arsye të ndërgjegjësimit

të vonë të shoqërisë njerëzore të këto pasuri të prekshme dokumentare.

Qendra historike, ashtu si dhe monumentet e kulturës në përgjithësi, për shkak të zgjidhjeve të cilat lidheshin me një kulturë jetësore, tashmë të tejkaluar, i nënshtrohen ndryshimeve deri në rrafshim, për t'u përmirësuar, apo rindërtuar. Për këto arsye vënia në mbrojtje sa më parë e këtyre vlerave, objekt ndërhyrjesh transformuese, është urdhëruese. Për kryerjen e këtij veprimi në rrafsh ligjor, i cili synon të sigurojë ruajtjen e këtyre vlerave, ashtu siç i ka prurë historia e tyre, është e domosdoshme njohja e tyre në rrafshet urbanistiko-arkitekturore në rrjedhë të kohës. Theksojmë se, bashkëpunimi i studiuesve të veprimtarive ndërtimore, historianëve dhe përgjithësisht të interesuarve për trashëgiminë kulturore, si në rrafsh kombëtar dhe më gjerë, natyrisht për kategori të veçanta veprash, është kërkesë urdhëruese. Çdo gabim në këtë përzgjedhje, veçanërisht kur ajo lë jashtë saj vlera të vërteta, shfaqet si humbje e parikthyeshme për kulturën kombëtare dhe më gjerë.

Vënia në mbrojtje e Qendrave historike, përsërisim, lidhet me ndjeshmërinë e shtresës intelektuale dhe posaçërisht të atyre të fushës së vlerësimit të trashëgimisë materiale për këto vlera dhe interesimit të shtetit, organit i cili realizon mbrojtjen e monumenteve, në kuptimin e gjerë të termit.

Zbatimi i kriterëve për mbrojtjen e Qendrave historike, parakupton njohjen profesionale të tyre, në mbarë hapësirën kombëtare dhe më gjerë, për t'u afruar sa më shumë zgjedhjeve të drejta. Kriteret për vënien në mbrojtje të Qendrave historike, në thelbin e tyre, përputhen me ato të vënies në mbrojtje shtetërore të monumenteve në përgjithësi. Kriteri themelor është ai i vlerave të këtyre qendrave, në rrafshin kombëtar dhe më gjerë, i cili shoqërohet kuptueshëm me kriterin e autenticitetit, pra të shkallës së ruajtjes së vlerave origjinale të monumentit. Edhe në rastin e Qendrave historike, vlera autentike janë mbarë fazat e ndërtimit formësuese të këtyre qendrave me histori të ndryshme zhvillimi. Tipologjia e qendrave historike, megjithëse për të kaluarën, pra deri rreth fillimit të shek. XX, periudhë e gjatë në të cilën ka mbisunduar praktika e improvizimeve urbanistike, është kushtëzuar prej faktorësh të përkatësisë shoqërore të banorëve, llojit të relievit etj. Përkatësia kohore e Qendrave historike, apo pjesëve të tyre, është gjithashtu një faktor që duhet vlerësuar, lidhur me vënien në mbrojtjen e tyre. Edhe shpërndarja tipologjike e Qendrave historike është faktor, i cili duhet përfillur, në bashkësinë e mbarë faktorëve ndikues në vendimet eventuale për mbrojtjen e Qendrave historike.

Dokumentimi i Qendrave e historike është një domosdoshmëri, sepse me mjete grafike, fotografike dhe përshtatimore, fiksohen me vërtetësi të dhëna të sakta për thelbin dhe shfaqjen e dukurive të kësaj kategorie ndërtimore. Ky dokumentim, i cili kuptueshëm, kryesisht paraqet gjendjen ekzistuese, shprehet njëherazi

edhe pasqyrues i zhvillimit në kohë të bashkësisë ndërtimore, mbi bazën e vrojtjeve dhe interpretimeve të tyre prej specialistëve të fushës. Shkalla e gjerësisë dhe thellësisë së dokumentacionit të Qendrave historike, është e ndryshme dhe përherë e në zgjerim, për shkak të mënyrave të reja të dokumentimit të asambleve.

Dokumentacioni grafik, pasqyron gjendjen ekzistuese, sipas matjeve metrike, nëpërmjet planimetrive, prerjeve, pamjeve të jashtme, të brendshme dhe hollësive. Treguesit e mësipërm, vizitohen në shkallë të ndryshme.

Dokumentacioni fotografik, është paraqitja e vërtetësishme e pamjeve të ndryshme të Qendrave historike, ndërsa pjesa shkrimore e këtij dokumentacioni, trajton fazat e ndërtimit, gjendjen teknike dhe të dhëna të tjera, përfundime vrojtimesh të kujdeshme dhe studimesh. Dokumentacioni i Qendrave historike, përfshin edhe atë të ndërhyrjeve mirëmbajtëse dhe restauruese. Mbarë llojet e dokumentacionit, paraqesin me mënyra të ndryshme gjendjen e Qendrave historike në një moment të caktuar kohor. Meqë në rrjedhë të kohës, ashtu si çdo krijesë dhe vepër e krijesave njerëzore pësojnë ndryshime, këto duhen pasqyruar në mbarë llojet e dokumentacionit. Kështu, ndiqet me hollësi ecuria në kohë e Qendrave historike dhe monumenteve në përgjithësi. Dokumentacioni, i çfarëdo lloji, është veprimtari e cila kryhet prej institucionit shtetëror të ngarkuar për vlerësimin e monumenteve. Çdo dokument përmban detyrimisht tregues të emërtimit të objektit, kohës së kryerjes dhe autorit, apo autores.

Dokumentacioni i shkallëve dhe synimeve të ndryshme, mund të kryhet dhe prej institucioneve, apo personash privatë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ai gjithashtu, sipas akteve të përmendur, shfrytëzohet prej studiuesish të ndryshëm.

Mbrojtja dhe administrimi i Qendrave historike, veçanërisht i atyre që ende dhe vijimisht do të bashkëpërfshihen në jetën e sotme, është një prej detyrave më problematike të ruajtjes së kësaj trashëgimie të kulturës ndërtimore. Shkaku është se Qendrat historike, thuhet vetëm bashkësi banesash, i shërbejnë njëres prej kërkesave thelbësore të jetesës në banesë, është një dukuri në ndryshime të shkallëve të ndryshme në rrjedhë të kohës, për hapësira me kushte ekonomiko-shoqërore të afërta. Veçanërisht ndryshimet në kërkesat ndaj banesës, prej kalimit të ekonomisë feudale në atë kapitaliste, rreth mesit të shek. XIX, në hapësirat shqiptare, u karakterizua prej kërkesash të reja, madje thellësisht të ndryshme ndaj strehës familjare. Krahas, sistemi i rrjetit rrugor, teknika e ndërtimit të tyre, mungesa e ndjeshme e ndërtimeve të shërbimit dhe atyre shoqërore etj., i shfaqin Qendrat historike në mospërputhje të ndjeshme me kërkesat e kohës ndaj këtyre njësive. Nëse do ta përmbledhim këtë dukuri, në bashkëmarëdhënie me përfshirjen e saj në jetën e sotme dhe në vijim, do të pohojm pamëdyshje mospërputhjet përherë dhe në rritje të banorëve me këto vepra

të ngurtësuar. Në këtë këndshikim, shteti si përfaqësues i shoqërisë, duhet të përpiqet për një shkallë kompensimi të dëmeve të pronarëve të këtyre vlerave, të cilat rrjedhin pikërisht prej ruajtjes së kompozimit, trajtimit urbanistiko-ndërtimor dhe teknikave tradicionale të ndërtimit. Ruajtja e autenticitetit, thelbit të ruajtjes së vlerave historikokulturore të Qendrave historike, është kërkesa thelbësore e cila plotësohet me të pajtuarit me kushtet e jetës përherë dhe më të largëta me ato të sotmet dhe në vijim.

Jemi tashmë përpara temës sa të qenësishme, aq edhe të vështirë, atë të jetëzimit të Qendrave historike në të sotmen dhe vijimisht. Kuptohet se data e vënies në mbrojtje ligjore të vlerave të trashëgimisë së kulturës materiale, paraqet një cak kohor të gjendjes së monumentit, i cili përgjithësisht është pikëreferimi për mbarë trajtesat e mëparshme të kësaj trashëgimie. Qendrat historike, më dukshëm se kategoritë e tjera të trashëgimisë materiale përballen me faktorët dëmtues të vlerave të tyre, krahas shpërbërjes natyrore të çdo krijese, bimësie dhe përgjithësisht pjesë të natyrës dhe objekteve të krijuara prej mbarëbrevave njerëzore. Shtysa e natyrshme për të përputhur Qendrën historike, në mbarë përbërësit, me kërkesat e kohës, paraqet një rrezik gjithëheri të pranishëm. Zbutja më efektive e kësaj mospërputhje, arrihet në shkallë të përfillshme realizimesh për përfshirjen e Qendrave historike në jetën bashkëkohore. Karta e Venecias, një "monument për monumentet", siç shkruante një personalitet ndërkombëtar i vlerësimit të monumenteve, thekson se monumentet bartin edhe funksione të reja, me kusht që të mos cenohen vlerat për të cilat ato janë vënë në mbrojtje. Rijetëzimi i Qendrave historike, apo përfshirja sa më organike e tyre në jetën e sotme dhe paskëtajme, është kushti i pandryshueshëm për ruajtjen e vlerave të tyre historiko-kulturore, dhe si të tilla të shikueshme dhe mësimdhënëse për brezat pas vënies në mbrojtje.

Ruajtja e vlerave origjinale të qendrave historike, me shfrytëzimin e skajmë të metodologjive dhe teknikave bashkëkohore, gjithë duke qenë ato pjesë organike e qendrës së banuar ku janë ngritur, parakuptojmë përkujdesje sistematike mbarëkohore. Përkujdesjet e vazhdueshme, shoqërohen me njohjen e vijueshme të gjendjes së ndërtimeve përbërëse të Qendrave historike dhe riparimet e tyre të menjëhershme për të mos cenuar më tej vlerat origjinale të monumenteve. Me të drejtë në dokumente ndërkombëtare për vlerësimin e monumenteve, pohohet se thelbi i restaurimit është vazhdimësia e ndërhyrjeve mirëmbajtëse. Natyrisht, ndërhyrjet restauruese në pjesë, apo njësi urbanistiko-ndërtimore janë dukuri e pranishme, veçanërisht në dhjetëvjeçarët e parë, pas shpalljes në mbrojtje të Qendrave historike. Përsërisim se këto ndërhyrje synojnë ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave origjinale të elementeve përbërës të Qendrave historike, sipas parimeve të njohura të restaurimit të veprave ndërtimore. Një problem i vërtetë i vlerësimit të qendrave historike, është qëndrimi karshi

hapësirave boshe të ndërtimit, ngritjes së ndërtimeve të reja, para shpalljes në mbrojtje, të cilat cenojnë rëndë njësinë kompozicionale dhe plotësimin e kërkesave të reja ndërtimore ndaj këtyre qendrave. Parimet e restaurimit në Qendrat historike, synuese të ruajtjes së vlerave autentike, të ndërtimeve të veçanta, zhvillimit urbanistik, dhe hapësirave brenda dhe jashtë mureve rrethues të ndërtimeve dhe trojeve pa ndërtime, apo atyre të rrënuara, kohët e fundit kanë pësuar largim prej parimeve të rrepta puriste. Në këtë kontekst, sot, në Qendrat historike, përgjithësisht ngritja e ndërtimeve të reja në trojet bosh, si dhe rindërtimi i pjesshëm i atyre rrënojë, është i pranueshëm, me kusht që ato të harmonizohen me karakteristikat e Qendrës historike në rrafshet vëllimore dhe të trajtimit të jashtëm arkitekturor. Nevojat për kategori ndërtimore shoqërore, si hotele, shkolla, ambiente çlodhjeje, shitore etj., në Qendrat historike, gjejnë zgjidhje të përshtatshme në hapësirat e monumenteve të kategorisë së dytë, rreth 90% të mbarë monumenteve në këto qendra. Siç dihet, monumenteve të kategorisë së dytë, iu ruhet vëllimi dhe trajtimi i jashtëm arkitekturor, ndërsa hapësira e brendshme mund të ndryshohet, duke mundësuar përshtatjen e tyre për nevojat bashkëkohore.

Lidhur me rritjen, pra përfshirjen aktive të Qendrave historike në bashkësinë e hapësirave të reja ndërtimore të qyteteve dhe fshatrave, vend të rëndësishëm zë turizmi në përgjithësi dhe ai kulturor në veçanti. Është fjala për përfshirjen e qendrave historike dhe më gjerë monumenteve ndërtimore në synimet e kahershme dhe sot dhe më pas në rritje, për të njohur dëshmitë ndërtimore në funksionin e dëshmisë së prekshme historiko-kulturore.

Turizmi për natyrën e tij është burim të ardhurash për pronarët e monumenteve, në hapësirat e Qendrave historike, realitet ky i cili rrit ndjeshëm pajtimin me papërshtatshmëritë funksionalo-ekonomike të ndërtesave-monument, tashmë të ngurtësuara, pas shpalljes së tyre në mbrojtje.

Qendrat historike, mbrohen sipas rregulloreve të veçanta, të cilat kodifikojnë mënyrën dhe mjetet e mirëmbajtjes së këtyre vlerave të së kaluarës në kontekstin bashkëkohor. Pushteti vendor, krahas atij qendror, bartin përgjegjësi ligjore për ruajtjen e vlerave të këtyre qendrave në mbarë rrafshet, shpesh problematike. Personeli i kualifikuar teknik, merret me mbikëqyrjen e përhershme të Qendrave historike dhe ndërhyrjeve në to.

Këto qendra, fill pas vënies në mbrojtje, studiohen, në kuptimin e gjerë të termit, për t'u pasuar me plane-veprimi, afatesh të ndryshme, garanci për ruajtjen sistematike të vlerave. Zonat kalimtare, apo të mbrojtura rreth Qendrës historike, gjithashtu janë në vërtetë të vazhduar, për të mos lejuar kalime të mprehta prej traditave në të renë, të cilat eventualisht do të cenonin paraqitjen e vlerave të qendrës historike. I cilësuar konservim i integruar, si pasojë e mbrojtjes së Qendrave historike, në veprimtarinë për zhvillimin e qendrave të banuara, është

bërë tashmë pjesë e kulturës vlerësuese për trashëgiminë historiko-kulturore ndërtimore.

Popullarizimi i vlerave të Qendrave historike dhe përgjithësisht i monumenteve të kulturës, është veprimtari përmbyllëse e termit përgjithësues vlerësim i monumenteve. Popullarizimi i vlerave historikokulturore, pra dhe i qendrave historike, është përmbyllja e synimit madhor për të përhapur sa më gjerë dijet për vlerat e trashëgimisë kulturore.

Popullarizimi, nëpërmjet botimeve të llojeve të ndryshme, krahas mjeteve të sotme, përherë dhe në rritje, të informacionit masiv, kryesisht atij televiziv dhe kompjuterik, po bëhet përherë dhe më kapilar. Kështu trashëgimia historiko-kulturore po i afrohet përherë dhe më shumë qytetarëve, të cilët nëpërmjet njohjes, duke përfshirë dhe atë në vend, të Qendrave historike, rrisin shkallët e dijes për këtë trashëgimi dhe njëherazi rrisin ndihmesat për ruajtjen e saj.

Në trojet shqiptare, ende Qendrat historike nuk janë gjurmuar sistematikisht dhe vënë në mbrojtje, krahas arritjeve, veçanërisht në Shqipëri. Është urdhëruese që menjëherë specialistët e fushës përkatëse, veçanërisht në Kosovë të gjurmojnë dhe të paraqesin kërkesa profesionale për vënien në mbrojtje të këtyre vlerave të cilat dita-ditës po tjetërsohen.

Anashkalim i dëmshëm, duhet cituar edhe mospërfillja e qendrave historike fshatare të cilat kuptueshëm janë të një vlere të posaçme si dëshmi historikokulturore e së kaluarës. Përvoja e derisotme e veprimtarive në fushën e vlerësimit të Qendrave historike në Shqipëri, në disa drejtime është në nivele të larta, por kjo veprimtari duhet zgjeruar dhe thelluar për t'iu afruar synimeve përherë dhe në rritje për përfshirjen e tyre në jetën bashkëkohore.




Qasjet e menaxhimit të trashëgimisë, nga Jukka Jokilehto

Konventa e Trashëgimisë Botërore e vitit 1972 është bërë njëra nga instrumentet ndërkombëtare më me ndikim për mbrojtjen e burimeve trashëgimore. Gjatë dyzet viteve të para të ekzistencës së saj, ajo është shfaqur si një lider në identifikimin dhe njohjen ndërkombëtare të llojeve të reja të burimeve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe peizazhet dhe rrugët kulturore. Për më tepër, ajo ka promovuar takime ndërkombëtare të ekspertëve dhe qartësimin e koncepteve, si autenticitetin dhe integritetin, ku të dyja janë thelbësore për vlerësimin e cilësive dhe vlerave të trashëgimisë. Qëllimi i këtij dokumenti është ekzaminimi se si kanë evoluar aktivitetet ndërkombëtare të cilat rrjedhin nga adoptimi i Konventës së Trashëgimisë Botërore, veçanërisht në lidhje me njohjen dhe menaxhimin e burimeve të trashëgimisë.


Kriteri kryesor për futjen e pronave në Listën e Trashëgimisë Botërore është se këto duhet t'i përmbushin kërkesat e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale (VJU). Ky nocion shpjegohet më thellësisht në Udhëzimet Operative (UO) për implementimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore, drafti i së cilës daton që nga viti 1977. Që prej atëherë UO është ndryshuar disa herë. Në të njëjtën kohë ka evoluar edhe definicioni i trashëgimive të cilat përmbushin kriteret për t'u futur në Listën e Trashëgimisë Botërore. Fillimisht, trashëgimi kulturore definohejshin monumentet, grupet e ndërtesave dhe siteve. Më pas, nocioni i grupeve të ndërtesave ishte specifikuar në lidhje me llojet e ndryshme të vendeve historike dhe zonave urbane. Nocioni i 'siteve' në fillim i referohej kryesisht vendeve arkeologjike. Pastaj, me këtë gjithashtu janë referuar peizazhet kulturore dhe rrugët kulturore. Në nëntor të vitit 2011 UNESCO miratoi një rekomandim ndërkombëtar për peizazhet urbane historike, i cili në mënyrë thelbësore fokusohet në çështjet e menaxhimit. Megjithatë, kjo gjithashtu mund të çojë deri në opsionin e definimit të një qyteti historik si 'sit', me këtë rast duke e zgjeruar vëmendjen nga ndërtesat në funksione dhe në rrethina.

Menaxhimi i burimeve të trashëgimisë varet nga identifikimi dhe njohja e Komunitetit të Trashëgimisë, të cilët janë rrënjësisht përgjegjës për kujdesin dhe mbrojtjen, siç ceket në Konventën e Këshillit të Evropës Faro të vitit 2005. Mund të theksohet se i njëjti vend mund të definohet në mënyra të ndryshme, varësisht prej njohjes së rëndësisë së tij dhe karakteristikave që e shoqërojnë. Në vitin 1992, Komiteti i Trashëgimisë Botërore miratoi nocionin e Peizazhit Kulturor, i cili është bërë një nxitje e rëndësishme ndërkombëtare për identifikimin e zonave trashëgimore të cilat gjithnjë e më shumë janë në rritje dhe më komplekse. Në të vërtetë, edhe pse Konventa e Trashëgimisë Botërore ishte paraparë edhe për trashëgiminë kulturore edhe për atë natyrore, këto dy aspekte të trashëgimisë

ia kanë arritur që të mbesin të ndara. Është vetëm nga njohja e peizazheve kulturore që po shfaqen më shumë lidhje. Kërkesa e menaxhimit është përfurcuar sidomos që nga vitet e 1990'ta, si një detyrim për t'u futur në listë. Në thelb, menaxhmenti i ndjek disa metodologji specifike që drejtohen nga akterët, si dhe duke e marrë parasysh atë që është njohur si trashëgimi për secilin rast. Kjo mund të shihet si një meritë e komunitetit e cila është ndërlidhur me aktivitetet e Trashëgimisë Botërore për ta gjeneruar një proces ndërkombëtar për njohjen e trashëgimisë, duke i marrë parasysh dallimet kulturore dhe trashëgimore, e cila rezultoi me pranimin e udhëzimeve dhe parimeve relevante në kornizat kombëtare ligjore dhe administrative.



Sistemet e Menaxhimit/Planet



Origjina e shqetësimit ndërkombëtar për trashëgiminë

Origjina e qasjes ndërkombëtare ndaj trashëgimisë kulturore daton së paku që nga Renesanca italiane në shekujt e 15'të dhe 16'të dhe fillimit pasues të turizmit kulturor. Në shekujt e 18'të dhe 19'të veçse kishte rekomandime specifike në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e konflikteve të armatosura. Njëra nga më të hershmet është publikimi i një juristi zviceran, Emmerich de Vattel (1714-1767) me rekomandimin e tij ***Le Droit des gens ou principes de la loi naturelle appliqués à la conduite et aux affaires des Nations et des Souverains*** ai thotë:

Vlen që të mbrohen ndërtesat të cilat i bëjnë nder njerëzimit dhe që nuk i kontribuojnë fuqisë ushtarake të armikut. Këtu bëjnë pjesë tempujt, varret, ndërtesat publike, me një fjalë, të gjitha arritjet që respektohen për bukurinë e vet.

Çfarë mund të përfitohet me shkatërrimin e tyre? Ata që janë fajtorë nuk mund të shpallen asgjë tjetër veçse armiq të njerëzimit.

(Il convient de les sauvegarder edifices qui font l'Honneur de l'Humanité, et ne contribuent superioritet au pouvoir de l'Militaire ennemi. Ce sont les notamment tempuj, les sépultures, les edifices publikut, en un batuta toutes les REALISATIONS respectées derdh Leur Beaute. Qu'y at-il à gagner një shkatërrim Leur? Celui qui s'en Grisni coupable ne peut qu'être deklarojnë un ennemi de l'Humanité.)⁴

Definimi i Trashëgimisë Botërore

Kur UNESCO u themelua në fund të Luftës së Dytë Botërore, njëra nga qëllimet e saja ishte që të krijojë instrumentet ligjore ndërkombëtare për të ndihmuar në mbrojtjen e burimeve të trashëgimisë. Instrumenti i parë i tillë ishte *Konventa për Mbrojtjen e Pronës Kulturore në Rast të ndonjë Konflikti të Armatosur*, të miratuar në Hagë në vitin 1954. Kjo u pasua, në vitin 1970, me *Konventën për Masat e Ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Pronësisë së Pasurisë Kulturore në Mënyrë të Paligjshme*. Pastaj, erdhi *Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës* e cila u miratua nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në nëntor të vitit 1972. Parathënia e Konventës paraqet:

- Duke vërejtur se trashëgimia kulturore dhe trashëgimia natyrore gjithmonë e më shumë janë të **kërcënuara me shkatërrim**, jo vetëm nga shkaqet tradicionale të prishjes, por gjithashtu edhe nga **ndryshimet e kushteve sociale dhe ekonomike të cilat e rëndojnë situatën** me dukuri edhe më të frikshme të dëmtimit apo shkatërrimit,
- Marrë parasysh se prishja apo zhdukja e cilitdo send të trashëgimisë kulturore dhe natyrore e përbën një **varfërim të dëmshëm të trashëgimisë për të gjitha kombet e botës**,
- Duke pasur parasysh se për këtë qëllim është e domosdoshme që të miratohen dispozita të reja në formë të ndonjë konvente për ta themeluar **një sistem efektiv të mbrojtjes kolektive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, të organizuar në baza të përhershme dhe në përputhje me metodat bashkëkohore shkencore**,⁵

Dyzet vjet nga miratimi i saj, Konventa e Trashëgimisë Botërore është padyshim njëra nga mjetet më me ndikim dhe është ratifikuar pothuajse nga të gjitha shtetet e botës. Që nga 19 shtatori i vitit 2012, Shtetet Anëtare përfshijnë 190. Mund të përmendet se Shtetet Anëtare në Konventë pajtohen për identifikimin dhe nominimin e pronave në territorin e tyre kombëtar që të merren parasysh për t'u futur në Listën e Trashëgimisë Botërore. Me rastin e nominimit të një

prone të caktuar, shteti i ofron detajet se si një pronë do të mbrohet dhe ofron një plan menaxhimi për mirëmbajtjen e saj, si dhe raportim të rregullt tek Komiteti i Trashëgimisë Botërore në lidhje me gjendjen e pronës.

Kërkesa kryesore për t’u futur në Listën e Trashëgimisë Botërore është se prona e propozuar duhet t’i përmbush kërkesat e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale (VJU). Kriteret përcaktohen nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore, i cili është një organ ndërqeveritar i zgjedhur nga Shtetet Anëtare. Kriteret iu kanë nënshtruar zhvillimit me kalimin e kohës, duke e pasqyruar evolucionin e asaj që konsiderohet trashëgimi dhe rrjedhimisht se si mbrojtja dhe menaxhimi i saj janë të specifikuar.

Në edicionin e vitit 2005, Udhëzimet Operative për Implementimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore e definojnë konceptin e VJU-së: Vlera e Jashtëzakonshme Universale do të thotë rëndësi kulturore dhe/ose natyrore e cila është aq e jashtëzakonshme saqë të kapërcejë kufijtë kombëtarë dhe të jetë e rëndësishme për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme të njerëzimit. Në këtë mënyrë, mbrojtja e përhershme e kësaj trashëgimie është e rëndësishme më të lartë për tërë komunitetin ndërkombëtar. Komiteti përcakton kriteret për emërimin e pronave në Listën e Trashëgimisë Botërore.⁶



Në të njëjtën kohë, Komiteti gjithashtu ka specifikuar se menaxhimi i secilës pronë në Listë duhet të bazohet në Deklaratën e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale (DVJU): *Deklarata e Vlerës së Jashtëzakonshme universale duhet të përmbajë një përmbledhje të përcaktimit të Komitetit se prona ka vlera të jashtëzakonshme universale, duke identifikuar kriteret sipas së cilave prona është emëruar, duke përfshirë vlerësimet e kushteve të integritetit apo autenticitetit, si dhe kërkesat në fuqi për mbrojtje dhe menaxhim. Deklarata e vlerës së jashtëzakonshme universale duhet të jetë bazë për mbrojtjen e ardhshme dhe menaxhimin e pronës.*

Sipas Konventës së Trashëgimisë Botërore, pronat kulturore që nominohen në Listë mund të ndahen në tre kategori: monumentet, grupet e ndërtesave dhe

sitet. Neni 5 i Konventës thotë: *Për të siguruar që janë marrë masa aktive dhe efektive për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e vet, secili Shtet Anëtarë në këtë Konventë do të përpiqet për aq sa është e mundur, dhe aq sa është e përshtatshme për secilin vend: që ta miratojë një politikë të përgjithshme e cila ka për qëllim që t'i japë trashëgimisë kulturore dhe natyrore një funksion në jetën e komunitetit dhe ta integrojë mbrojtjen e asaj trashëgimie në programe gjithëpërfshirëse të planifikimit;*⁷

Ndikimi i Vlerave

- Vlerat kulturore
 - Vlera e identitetit, emocionale (njohja nga publiku)
 - Vlera relative/artistike ose teknike, dëshmi (kërkim i kryer nga profesionistët)
 - Vlera e rrallësisë, administrative
 - (statistika dhe politika të autoriteteve)
- Vlerat bashkëkohore sociale dhe ekonomike
 - Vlera ekonomike, trashëgimia si burim
 - Vlera funksionale, dobishmëria
 - Vlera edukative, turizmi
 - Vlera sociale, vetëdijesimi
 - Vlera politike, regjimi

Kur nominimet e para ishin prezantuar në Listën e Trashëgimisë Botërore, veçse ishte theksuar se prona duhet ta ketë mbrojtjen dhe menaxhimin e duhur. Megjithatë, procesi i vlerësimit shpeshherë i dha vëmendje relativisht të vogël implementimit në praktikë të një kërkesë të tillë. Me të vërtetë, shumë nominime të hershme nuk kishin asnjë lloj sistemi të menaxhimit dhe shpeshherë mbrojtja ishte vetëm në letër. Me kalimin e viteve, sidomos në vitet 1990'ta, Komiteti ishte bërë gjithnjë e më i vetëdijshëm për nevojën e një sistemi të menaxhimit, një plani të përshtatshëm të menaxhimit dhe posaçërisht se këto gjithashtu duhet të implementohen në praktikë.

Në vitet e hershme, fokusi kryesor i Komitetit ishte në atë që ishte përcaktuar si “zonë thelbësore”, më saktë, një zonë e cila ishte futur në Listën e Trashëgimisë Botërore. Në parim, kjo duhej ta kishte një zonë neutrale për mbrojtje shtesë, por kontrolli i zonës neutrale ende nuk konsiderohej prioritet. Pothuajse, vetëm prej vitit 2000 menaxhimi i zonave përreth ka filluar të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Në vitin 2005, ICOMOS-i në Kuvendin e vet të Përgjithshëm në Xi'an (Kinë) miratoi Deklaratën Xi'an për suazat e strukturave të Trashëgimisë. Këtu thuhet: *Suaza e një strukture të trashëgimisë, siti apo zone definohet si një*

*mjedis i afërt apo i shtrirë që bën pjesë, ose kontribuon, në rëndësisë e saj dhe karakterin dallues.*⁸

Grupet e ndërtesave: Sa i përket nocionit të “grupeve të ndërtesave”, me këtë zakonisht iu referohej zonave urbane historike. Me nominimin e kryeqytetit të Brazilit, Brazilia-s, i cili i fut në Listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 1987, Komiteti shfaqti brengosje në lidhje me pasojat e futjes së një qyteti modern dhe precedentin që mund ta paraqet. Rrjedhimisht, një grup pune i definoi udhëzimet për atë që nënkuptohej me nën kategorinë e “grupeve të ndërtesave”. Këto ishin klasifikuar në tri kategori kryesore:


- qytetet të cilat **nuk janë më të banuara**, por të cilat japin dëshmi të pandryshuara arkeologjike për të kaluarën.
- **qytetet historike të cilat janë ende të banuara** dhe të cilat për nga natyra e tyre janë zhvilluar dhe do të vazhdojnë të zhvillohen .
- **qytetet e reja të shekullit të njëzet të cilat** në mënyrë paradoksale kanë diçka të përbashkët me të dy kategoritë e lartpërmendura .⁹

Për më tepër, qytetet e banuara historike mund të shihen si: a) tipike për një periudhë të caktuar dhe pothuajse krejtësisht të ruajtura, b) qytetet të cilat janë zhvilluar përgjatë linjave karakteristike, nganjëherë në mes të rrethinave të jashtëzakonshme natyrore, c) qendrat historike të cilat e mbulojnë zonën e qytetit historik dhe janë të rrethuara nga zhvillimi modern urban dhe d) sektorët e qytetit historik.

Sitet dhe Peizazhet Kulturorë: Në fund të viteve të 1980’ta, për shkak të disa nominimeve, veçanërisht të “Lake District-it” të Anglisë, u bë e nevojshme për t’i

Autenticiteti

Respektoni autenticitetin e siteve të trashëgimisë kulturore, duke kumtuar rëndësinë e strukturës së tyre historike dhe vlerat kulturore, si dhe mbrojtjen e tyre nga ndikimi negativ i infrastrukturës ndërhyrëse interpretuese, presionit të vizitorëve, apo interpretimit të pasaktë dhe të papërshtatshëm.



definuar disa lloje të reja të kategorive të trashëgimisë. E para prej tyre ishte nocioni i Peizazhit Kulturor. Kjo konsiderohej si një zgjerim i kategorisë së **"Siteve"**, të cilat ishin definuar në Konventë, si: *'vepra të njeriut ose punimet e kombinuara të natyrës dhe njeriut dhe zonat që përfshijnë vendet arkeologjike të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja historike, estetike apo antropologjike'*. Rrjedhimisht, Peizazhet Kulturore përfaqësojnë "punimet e kombinuara të natyrës dhe njeriut" të përcaktuara në nenin 1 të Konventës. *'Ato janë ilustrim i evolucionit të shoqërisë njerëzore dhe vendbanimeve gjatë kalimit të kohës, nën ndikimin e kufizimeve fizike dhe/ose mundësive të paraqitura nga mjedisi i tyre natyror dhe nga forcat pasuese sociale, ekonomike dhe kulturore, si të jashtme ashtu edhe të brendshme.'*

Lista e Trashëgimisë së Rrezikuar Botërore (këtej e tutje Lista e Rrezikuar): Që nga fillimi i Konventës së Trashëgimisë Botërore, një vëmendje e veçantë i është dhënë pronave të rrezikuara. Sitet e tilla kanë mundur të futeshin në një listë të veçantë të Trashëgimisë së Rrezikuar Botërore. Justifikimi mund të bazohet në RREZIKUN e KONSTATUAR, sipas së cilit prona ballafaqohet me një 'rrezik të veçantë dhe të 'dëshmuar si i pashmangshëm' p.sh. materialet, struktura, humbja e autenticitetit, ose nga RREZIKU POTENCIAL, sipas së cilit prona ballafaqohet me 'kërcënime të cilat mund të kenë efekte të dëmshme në karakteristikat e saj themelore' p.sh., modifikimi i statusit juridik, mungesa e politikave të konservimit, efektet kërcënuese të planifikimit të qytetit, konfliktet e armatosura, ndryshimi i klimës. Prona e parë që u fut në Listën e Trashëgimisë së Rrezikuar Botërore ishte **Rajoni Natyror dhe Kulturor-Historik i Kotorit**, i cili kishte pësuar nga tërmeti i muajve prill-maj të vitit 1979. Ai u emërua në këtë listë në baza emergjente dhe u fut menjëherë në Listën e Rrezikuar. Kjo rezultoi me ndihmë ndërkombëtare për disa vjet, si dhe me përgatitjen e një Plani të Menaxhimit. Prona përfundimisht u hiq nga Lista e Rrezikuar në vitin 2003. Në vitin 2012 gjenden 38 prona në Listën e Rrezikuar, por në realitet numri mund të jetë shumë më i madh duke pasur parasysh problemet e shumta me të cilat ballafaqohen më shumë se 900 prona të Trashëgimisë Botërore. Lista e Rrezikuar u bë njëra nga nxitjet më të rëndësishme për përfundimin e regjimit të menaxhimit. Gradualisht, Komiteti e ka forcuar këtë kërkesë. Me të vërtetë, tani mungesa e implementimit të planit ashtu siç duhet, konsiderohet si kërcënim potencial dhe mund të rezultojë me futje tjera të trashëgimive në Listën e Rrezikuar.

Autenticiteti dhe Diversiteti: Viti 1990 u bë një pikë kthese në zhvillimin e politikave të Trashëgimisë Botërore. Njëra nga pikat kthyesë më të rëndësishme të kësaj periudhe ishte takimi ndërkombëtar i ekspertëve që u zhvillua në Nara (Japoni) në nëntor të vitit 1994. Ai që rezultoi *Dokumenti Nara mbi autenticitetin* jo vetëm që i kushtonte vëmendje parametrave që duhet marrë parasysh për ta verifikuar autenticitetin, më saktë, vërtetësinë e aspekteve të ndryshme të

pronës, materiale dhe jo-materiale. Dokumenti gjithashtu theksonte nocionin e diversitetit kulturor dhe diversitetin e trashëgimisë:

- Konservimi i trashëgimisë kulturore me të gjitha format e saj dhe periudhat historike është e rrënjësor në vlerat që ndërlidhen me trashëgiminë.
- Aftësia jonë për t’i kuptuar këto vlera varet pjesërisht, në shkallën e asaj se cilat burime të informatave në lidhje me këto vlera mund të merren si të besueshme apo të vërteta.
- Njohuria dhe të kuptuarit e këtyre burimeve të informacionit, në lidhje me karakteristikat origjinale dhe pasuese të trashëgimisë kulturore, si dhe kuptimi i tyre, është një bazë e nevojshme për t’i vlerësuar të gjitha aspektet e autenticitetit.

Me të vërtetë, Konferenca Nara këmbënguli se definicioni i trashëgimisë kulturore është i bazuar në kulturat dhe historinë që e ka zhvilluar atë. Mund të ceket se autenticiteti pasqyrohet me kreativitet të vërtetë, në vërtetësinë e dëshmiave historike, si dhe në kapacitetin e shoqërisë për të gjeneruar vlera të vërteta. Kjo çështja e fundit është padyshim njëra nga më problematikat, duke marrë parasysh çmangëpjen që është gjithmonë në rritje në shoqërinë e globalizuar. Më tej, dokumenti *Nara* vazhdon ta njohë **diversitetin kulturor**, i cili që atëherë merret si njëri nga tiparet kryesore të trashëgimisë që do të mbrohet dhe ruhet. Në fakt, pas Konferencës së *Nara-s*, UNESCO mori iniciativën për ta përgatitur dhe miratuar Deklaratën Universale të Diversitetit Kulturor (në vitin 1998), e pasuar më vonë nga *Konventa për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore* (2005). Këtyre duhet të iu shtohet *Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë së Paprekshme Kulturore* (2003), e cila me siguri i detyrohet Konferencës *Nara*, si dhe përpjekjeve të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s nga Japonia, Koïchiro Matsuura (1999-2009).

Sistemet e Menaxhimit

Plani i menaxhimit: Versioni i vitit 1999 i Udhëzimeve Operative për implementimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore cekte se ‘futja e siteve në listë do të shtyhet derisa dëshmitë të demonstrohen për përkushtimin e plotë nga Qeveria nominuese, brenda mundësive të saj. **Dëshmia do të ishte në formën e legjislacionit përkatës, personelit, financimit dhe planeve të menaxhimit.**’ Është interesante të theksohet se kjo është hera e parë që Komiteti ka insistuar se një pronë e nominuar duhet ta ketë menaxhimin e përcaktuar, si një kërkesë për t’u futur në listë. Gjithashtu ceket se nëse ‘**plani i menaxhimit** mungon apo është joadekuat, ose nuk implementohet plotësisht’, prona mund t’i nënshtrohet futjes në Listën e Rrezikuar.


Çështja e Planit të Menaxhimit ka shkaktuar paksa shqetësim, për shkak se

shumë Shtete nuk e kanë të integruar këtë në legjislacionin përkatës. Për shembull, Italia vetëm në vitin 2006 e ka miratuar një ligj të ri në lidhje me kërkesat e Planit të Menaxhimit për të gjitha pronat e Trashëgimisë Botërore në territorin e saj. Nga 43 prona italiane të Trashëgimisë Botërore vetëm disa prej tyre me të vërtetë e përmbushin këtë kërkesë, veçanërisht përfshirë sitet të cilat janë futur në listë së fundmi. Në vitin 2012 për shembull, Komuna e Venecias është përfshirë në përgatitjen e një Plani të Menaxhimit që pritet të kompletohet në vitin 2013. Në mënyrë që t'i ofrojë mbështetjen e nevojshme përpjekjeve të tilla, Ministria Italiane e Kulturës, MiBAC, ka nxjerrë udhëzime të cilat duhet të ndiqen nga menaxherët. Natyrisht, tani ka udhëzime të shumta të publikuara jo vetëm nga UNESCO por edhe nga autoritete të ndryshme kombëtare. Njëra nga më të hershmet u botua nga ICCROM-i si rezultat i një përpjekjeje të përbashkët me Qendrën e Trashëgimisë Botërore dhe ICOMOS-in, e shkruar nga Sir Bernard M. Feilden dhe J. Jokilehto (1993).¹⁰ Që atëherë ajo është përkthyer në disa gjuhë. Me pak fjalë, duke i përdorur fjalët e Bernard Feilden-it, çështjet kyçe në lidhje me menaxhimin duhet të përfshijnë:


1) Inspektive të rregullta dhe raporte

- ✓ Ditore
 - ✓ Sezonale/vjetore
 - ✓ Pesëvjeçare
- Strategji të rregullt të mirëmbajtjes
 - Komunikim të mirë mes institucioneve dhe akterëve tjerë,
 - Identifikimin e indikatorëve të përshtatshëm për monitorim dhe kontroll.

Identifikimi i burimeve të trashëgimisë: Praktika e gjësë së trashëguar, duke iu referuar kalimit të pronës, ka ekzistuar që nga kohët e lashta. Rregullat kanë ndryshuar midis shoqërive dhe me kalimin e kohës. Për të njohur diçka si trashëgimi, përfshirë vlerat specifike, mund të shihet si një koncept relativisht modern, i cili ka evoluar sidomos kohëve të fundit. Qartë se ka lloje të ndryshme të pronave të identifikuar si trashëgimi, duke iu referuar trashëgimisë natyrore, trashëgimisë kulturore, trashëgimisë industriale,



si dhe trashëgimisë së paprekshme madje edhe trashëgimisë virtuale.




Si pasojë, trashëgimia nuk është një çështje evidente. Kjo varet nga identifikimi dhe njohja e një gjëje si trashëgimi. Në historinë e konservimit, vërehet se ka pasur ndikime të pari nga individët privat e deri tek Qeveritë, që ka rezultuar në legjislacion. Rrjedhimisht, idetë e tilla iu kanë kaluar tutje vendeve tjera dhe më në fund janë njohur nga komuniteti ndërkombëtar, që veçanërisht është zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore. Doktrina ndërkombëtare ka qenë rezultat i grupeve të punës të ekspertëve ndërkombëtar, së pari, pasoi me miratimin e parimeve rezultuese dhe udhëzimeve të komunitetit ndërkombëtar. Në këtë pikë, ndikimet kanë pasur tendencë që të merren prapa nga bashkësia ndërkombëtare në shtetet kombëtare dhe komuniteteve lokale.

Njëra prej ndikimeve të komunitetit të Trashëgimisë Botërore, nëse përdorim këtë shprehje, ka qenë analiza e Listës së Trashëgimisë Botërore, që ka rezultuar me disa seri të kornizave: a) Korniza tipologjike që identifikon llojet e pronave në Listë, b) Korniza kronologjike-gjeografike, që identifikon se cilat periudha historike janë të përfaqësuar siç referohet në rajone të ndryshme kulturore të botës dhe c) Korniza tematike, e cila identifikon temat ose çështjet që mund të konsiderohen si universale dhe relevante me të gjitha shoqëritë njerëzore. Analiza e ICOMOS-it (2005) ka identifikuar gjashtë kategori kryesore, të cilat mund të nën-ndahen në nën-kategori:

- **Shoqatat kulturore:** Bashkëveprimi njerëzor në shoqëri; shoqatat kulturore dhe simbolike, Degët e njohurisë;
- **Shprehje e kreativitetit:** Monumentet; Grupet e ndërtesave; Sitet;

- **Përgjigjet shpirtërore:** Sisteme të ndryshme shpirtërore dhe religjioze;
- **Shfrytëzimi i Burimeve Natyrore:** Bujqësia dhe prodhimi i ushqimit; Mijha dhe nxjerrja e gurëve; Sistemet e prodhimit;
- **Lëvizja e popujve:** Migrimi, Shtegtimi, Skllavëria, Rrugët dhe sistemet e transportit;
- **Zhvillimi i Teknologjive**

Kjo kornizë tematike e krijon referencën bazë për justifikimin e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale për një nominim të propozuar. Rrjedhimisht, do të jetë e nevojshme që në lidhje me temën e zgjedhur ose temat, që të identifikohen të gjitha elementet të cilat e formojnë integritetin social-funksional të pronës në referim me temën/temat,



në mënyrë që së bashku të mund ta justifikojnë nominimin e Trashëgimisë Botërore. Kjo analizë do të sigurojë bazën për identifikimin e kufijve dhe zonave neutrale për pronat.

Sa i përket çështjes së menaxhimit, është e nevojshme që të merret parasysh një territor më i gjerë, sepse nuk është e mundur që të menaxhohet një pronë pa e marrë në konsideratë dhe/ose kontrollimin e forcave të zhvillimit në rrethinë. Sa larg duhet të shtrihet menaxhimi i një prone individuale varet prej rastit të caktuar dhe situatës së veçantë, kornizave administrative dhe ligjore, si dhe aspekteve kritike të pronës brenda lokacionit të vet fizik në lidhje me suazat. Ndërsa temat universale që lidhen me nominimin e Trashëgimisë Botërore mund të jenë të kufizuara vetëm në atë temë apo ato tema të cilat mund të justifikohen sipas kritereve të vendosura nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore. Çështja që menaxhmenti duhet ta merr në konsideratë është një gamë më e gjerë e temave që i referohen më përgjithësisht karakteristikave të rëndësishme të sitty.

Për të qenë koherent dhe sistematik, do të ishte e dobishme ndjekja e një metodologjie që fillon duke identifikuar **karakteristikat e rëndësishme** të sitty, e pasuar nga **politika** për konservim dhe zhvillim të qëndrueshëm, **vizioni** dhe **analiza SWOT** (objektivat afatgjate dhe afatshkurtra, prioritetet dhe planet e veprimit). Rrjedhimisht, do të jetë e nevojshme për t'i identifikuar **rolet dhe përgjegjësitë e akterëve**, të cilët duhet ta formojnë një komision dhe ta drejtojnë procesin e

menaxhimit. E fundit por jo nga rëndësia, është çështja e **monitorimit dhe kontrollit të implementimit**. Në realitet, kjo është detyra e fundit që shpesh herë mbetet e dobët dhe shpie deri tek mos implementimi i qëllimeve të mira.


Komuniteti i Trashëgimisë: Baza për një komunitet është ekonomia. Ekonomia i referohet një sistemi brenda të cilit një komunitet e rregullon menaxhimin e burimeve me kalimin e kohës. Në fakt, fjala rrjedh nga: οἶκος (shtëpi) dhe νέμω (menaxho, shpërndajë). Pra për këtë: οἰκονομία: “menaxhimi i shtëpisë. Ky është një sistem i krijuar nga komuniteti për ta siguruar cilësinë e dëshiruar të jetës. Ai përbëhet nga puna, prodhimi, shpërndarjes së tregtisë dhe konsumit, të bazuar në burimet ekzistuese dhe/ose të krijuara rishtazi. Ekonomia e një komuniteti është një proces kulturor, që përfshin atë që është praktikuar dhe mësuar në mendjet e anëtarëve të komunitetit. Në proces, anëtarët e komunitetit bëjnë zgjedhje që synojnë përmirësimin e cilësisë, identifikimin e çështjeve që do të mbahen dhe të tjerat që do të paraqiten të reja.

Këshilli i Evropës *Konventa Kornizë për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore të Shoqërisë* (Faro 2005) ofron një definicion të gjerë të trashëgimisë kulturore si një reflektim dhe shprehje e vlerave të njerëzve që vazhdimisht evoluojnë, besimet, njohuritë dhe traditat. Këta njerëz mund ta formojnë Komunitetin e Trashëgimisë i cili përbëhet nga “njerëz të cilët vlerësojnë aspekte të veçanta të trashëgimisë kulturore të cilat ata i duan, që brenda kornizës së veprimit publik, t’i mbajnë dhe t’ua përcjellin brezave të ardhshëm”. Në të njëjtë Konventë *Faro*, gjithashtu thuhet se ne duhet ta njohim nevojën ‘për t’i vendosur njerëzit dhe vlerat njerëzore në qendër të një koncepti të zgjeruar dhe ndër-disiplinor të trashëgimisë kulturore’. Është po ky Komunitet i Trashëgimisë ai i cili është përgjegjës për të njohur diçka si trashëgimi. Kjo trashëgimi gjithashtu mund të definohet ndryshe në momente të ndryshme të kohës dhe mund të përbëhet nga monumentet, vendbanimet tradicionale historike, peizazhet kulturore, ose në përgjithësi me peizazhin.

Plani i menaxhimit: Menaxhimi i një territori të caktuar apo vendi të njohur si trashëgimi, varet se si është e definuar cilësia e kësaj trashëgimie. Me të vërtetë, menaxhimi i një monumenti individ do të ishte shumë më ndryshe sesa menaxhimi i një territori të tërë apo peizazhi kulturor. Megjithatë, siç është cekur më sipër, menaxhimi duhet të shihet në një kontekst më të gjerë. Madje edhe atëherë kur kemi të bëjmë me një ndërtesë të vetme historike, kjo duhet të kuptohet si pjesë e një konteksti dhe që ka suazën e vet që kontribuon në rëndësinë e tij, ashtu siç thuhet në Deklaratën Xi’an të ICOMOS-it. Një Plan i Menaxhimit, madje edhe atëherë kur ka të bëjë me burimet e trashëgimisë, duhet të bazohet në kontekstin socio-ekonomik të vendit. Kështu që një Plan i Integruar i Menaxhimit duhet ta përfshijë promovimin kulturor dhe social, si dhe njohurinë, mbrojtjen dhe konservimin e burimeve të trashëgimisë. Plani i Menaxhimit është

rezultat i një procesi, i cili fillon prej identifikimit dhe njohjes së trashëgimisë, zhvillimit të politikave të konservimit dhe një vizioni për menaxhim, që pasohet nga strategjitë dhe planet e veprimit. Pjesa më e rëndësishme e çfarëdo sistemi të menaxhimit është koordinimi i roleve dhe përgjegjësive të akterëve, si dhe monitorimi dhe kontrolli i implementimit. Një plan i menaxhimit mund të shihet si instrument që përdoret nga një Komitet Drejtues i përbërë nga akterët kryesor, i cili duhet të përfshijë përfaqësuesit e Komunitetit.

Dallimi në mes të një peizazhi dhe një peizazhi kulturor është në definicionet e tyre. Sipas Konventës Evropiane të Peizazhit (2000), *“Peizazh” nënkupton një fushë, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilit është rezultat i veprimit dhe bashkëveprimit të faktorëve natyror dhe/ose njerëzor. “Politika e Peizazhit” do të thotë një shprehje e parimeve të përgjithshme nga autoritetet kompetente publike, strategjitë dhe udhëzimet që lejojnë marrjen e masave specifike të cilat synojnë mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazheve.* Ndërsa peizazhi kulturor është, siç u theksua më lart, **ilustrim i evolucionit të shoqërisë njerëzore dhe vendbanimeve me kalimin e kohës**, nën ndikimin e kufizimeve fizike dhe/ose mundësive të paraqitura nga mjedisi i tyre natyror dhe i forcave pasuese sociale, ekonomike dhe kulturore, si të jashtme ashtu edhe të brendshme.



Rrjedhimisht, nëse një peizazh perceptohet në këtë moment, ai mund të mbrohet ose të transformohet nga profesionistët, si arkitektët e peizazhit, varësisht prej rastit. Një peizazh kulturor është si rezultat i evolucionit me kalimin e kohës. Prandaj, ai duhet të hulumtohet nga specialistët, duke përfshirë historianët dhe arkeologët. Sipas Rekomandimit Evropian në lidhje me fushat e peizazheve kulturore (1995), konservimi do të thotë: *aplikimi dinamik i masave të përshtatshme ligjore, ekonomike dhe operative për t'i ruajtur pasuritë specifike nga shkatërrimi apo prishja dhe për ta mbrojtur të ardhmen e tyre.* Pra, çështja është që në mënyrë fundamentale të ruhen dëshmitë e evolucionit historik. Këtyre dy llojeve të 'peizazheve', tani është e nevojshme që t'ua shtojmë edhe një tjetër: Peizazhin Urban Historik.

Peizazhi Urban Historik (PUH) është një reagim ndaj problemeve të menaxhimit për kontrollimin e zhvillimeve, sidomos në rrethinat e zonave të trashëgimisë. Ndërsa ka dalë si rezultat i problemeve me të cilat përballet prona e Trashëgimisë Botërore, koncepti i Peizazhit Urban Historik nuk ishte i paraparë që të jetë i kufizuar vetëm me Trashëgiminë Botërore, por për çdo zonë të trashëgimisë urbane. Pas serive të takimeve të ekspertëve, koncepti u definua me një *Rekomandim* të ri ndërkombëtar për *Peizazhet Urbane Historike*, që u miratua nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në nëntor të vitit 2011. Shtrirja e Rekomandimit është definuar në nenet 5 dhe 6:

Ky rekomandim e adreson nevojën për të integruar dhe formuar më mirë strategji të konservimit të trashëgimisë urbane, përbrenda synimeve më të mëdha të një zhvillimi të përgjithshëm dhe të gjithanshëm, në mënyrë që t'i mbështesë veprimet publike dhe private që synojnë ruajtjen dhe rritjen e cilësisë së mjedisit njerëzor. Rekomandimi sugjeron një qasje të peizazhit për identifikim, konservim dhe menaxhimin e zonave historike përbrenda konteksteve të tyre të gjera urbane, duke pasur parasysh ndër-relacionet e formave të tyre fizike, organizimin dhe lidhjen e tyre hapësinore, karakteristikat e tyre natyrore dhe suazat, si dhe vlerat e tyre sociale, kulturore dhe ekonomike. Kjo qasje i adreson politikën, administrimin dhe brengat e menaxhimit që përfshijnë lloje të ndryshme të akterëve, duke përfshirë akterët lokal, kombëtar, rajonal, ndërkombëtar, publik dhe privat në procesin e zhvillimit urban.

Rekomandimi rrënjësisht është menduar që të jetë një mjet menaxhimi. Qëllimi është që të identifikohet dobësia e suazave ose zonës përreth vendeve të mbrojtura të trashëgimisë dhe të inkurajohet zhvillimi i planifikimit të mirëfilltë dhe i instrumenteve të menaxhimit, në mënyrë që të kontrollohen forcat e zhvillimit dhe ndryshimit. Qëllimi i Rekomandimit është që të sigurojë një bazë për një *qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar për identifikimin, vlerësimin, konservimin dhe menaxhimin e peizazheve urbane historike brenda një kornize gjithëpërfshirëse zhvillimore të qëndrueshme*. Një qasje e Peizazhit Urban Historik mund të aplikohet në shumë raste të ndryshme, sikurse në rastin e qytetit Assisi në Itali, i cili e ka ruajtur mirë kontekstin e vet të peizazhit, por edhe në rastet si në zonën metropolitane të Napolit, e cila përmban disa burime të rëndësishme të trashëgimisë, por që gjithashtu nganjëherë sfidohet nga zhvillimet e pakontrolluara.

Konkluzion

Konventa e Trashëgimisë Botërore rezulton nga shqetësimi për t'i ruajtur dhe mbrojtur burimet e veçanta të trashëgimisë nga shkatërrimi i botës së globalizuar. Gjatë 40 viteve që kanë kaluar që prej miratimit të saj në vitin 1972, kjo Konventë është bërë njëra prej instrumenteve kryesore të UNESCO-s për ngri-

tjen e vetëdijes së burimeve të trashëgimisë, si dhe për krijimin e mendimeve dhe ofrimin e instrumenteve për ruajtjen e saj.

Konventa e Trashëgimisë Botërore është ratifikuar pothuajse nga e gjithë bota. Si rezultat, ajo ka një mbështetje politike kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo në vetvete është një sukses i madh. Si rezultat i këtij sukcesi, Konventa ka gjeneruar një diskutim i cili i ka çuar çështjet që lidhen me trashëgiminë dhe ruajtjen e saj përtej kufijve normal kombëtare apo rajonal. Shqetësimi për trashëgiminë është bërë vërtetë një shqetësim global, si kurrë më parë. Ajo ka krijuar instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare, karta, rekomandime dhe deklarata, si dhe promovimin e kornizave ligjore kombëtare dhe lokale, duke u zgjeruar në konceptin e trashëgimisë, planifikimin relevant dhe mjetet e menaxhimit.

Lista e Trashëgimisë Botërore filloi me monumentet dhe sitet e mirënjohura, të tilla si sitet arkeologjike të Mesdheut, të Lindjes së Mesme dhe Indisë. Nga këto fillime, sistemi i Trashëgimisë Botërore është bërë një përvojë e të mësuarit për të gjitha kombet, duke e zgjeruar nocionin e trashëgimisë (sidomos në raport me kulturën) nga ajo e veçanta deri tek universalja, nga specialja tek ajo e zakonshme, nga monumentet dhe memorialët e famshëm publik deri tek trashëgimia e popullit.

Komiteti i Trashëgimisë Botërore, së bashku me Organet Këshilluese dhe Sekretariatit e UNESCO-s e kanë meritën e promovimit të strategjive të qëndrueshme zhvillimore për planifikimin dhe menaxhimin e zonave të trashëgimisë dhe suazave të tyre.

Me rritjen e Listës së Trashëgimisë Botërore, që numëron 937 prona deri në vitin 2012, natyrisht që edhe problemet dhe sfidat janë rritur. Madhësia e zonave të trashëgimisë është bërë më e madhe, ndonjëherë duke u shtrirë në dhjetëra mijëra hektarë, madje edhe në rast të kulturës, të mos përmendim parqet natyrore. Si pasojë, një numër i madh i njerëzve i është ekspozuar Trashëgimisë Botërore. Kjo sjell në diskutim rëndësinë e edukimit dhe komunikimit. Këto nuk arrihen lehtë dhe shpesh ka konflikte midis interesave të ndryshme. Në të vërtetë, Trashëgimia Botërore tani është pjesë e debatit të përgjithshëm që propozon të arrihet një ekuilibër mes ndryshimit dhe vazhdimësisë.



Definicioni dhe Ruajtja e Peizazhit Urban Historik, nga Jukka Jokilehto

Ky dokument është një reflektim personal mbi nocionin e PUH-it (Peizazhin Urban Historik), i cili e ka origjinën nga një konferencë ndërkombëtare që u mbajt në Vjenë në vitin 2005. Koncepti më pas është diskutuar në një seri të takimeve rajonale dhe ndërkombëtare nën patronazhin e UNESCO-s, duke synuar një rekomandim të ri ndërkombëtar. Dokumenti tenton që t'i identifikojë disa referenca themelore për njohjen e koncepteve dhe definicioneve që mund të jenë të ndërlidhura me nocionin e Peizazhit Urban Historik. Këtu përfshihen rekomandimet ndërkombëtare nga UNESCO dhe kartat e ICOMOS-it, si dhe teoria e restaurimit nga Cesare Brandi. Supozohet se qasja e përgjithshme për PUH-in mund të definohet në kornizën e konservimit dhe restaurimit. Në të njëjtën kohë nuk është propozuar që PUH-i të definohet si një kategori tjetër e trashëgimisë. Ndërsa, posa të pranohet se një territor urban, rural dhe natyror ka cilësi të veçanta, do të nevojitet një qasje sistematike dhe përdorimin e mjeteve të shumta të planifikimit dhe të menaxhimit. Një karakteristikë e rëndësishme e PUH-it është përcaktimi i kushteve të integritetit, marrë në aspektin social-funksional, strukturor-historik dhe vizual. Secila prej këtyre do të merret si referencë për përcaktimin e strategjive të përshtatshme për mbrojtjen dhe konservimin. Sa i përket planifikimit dhe sistemit të menaxhimit, komunikimi dhe menaxhimi i informacionit janë vendimtare, duke përfshirë edhe lidhjet midis niveleve të ndryshme të vendimmarrjes, nga ato lokale në kombëtare dhe madje edhe ndërkombëtare. Dokumenti përfundon duke rikujtuar se njohja e Peizazhit Urban Historik është thellësisht një çështje kulturore, e bazuar në njohuritë e burimeve tona të trashëgimisë dhe vlerësimin kritik të pasurive që lidhen me to, si dhe meritat.

Definicionet Përkatesë

Definicioni i Peizazhit Urban Historik (PUH), e ka origjinën e vet në Memorandumin e Vjenës, që rezultoi nga konferenca ndërkombëtare e Vjenës në vitin 2005.¹ Fillimisht, PUH bazohej në definimin e 'zonave historike' në *Rekomandimin e vitit 1976 të UNESCO-s që kishte të bënte me ruajtjen dhe Rolin bashkëkohor të Zonave Historike*. Unë besoj se dallimet kryesore në krahasim me rekomandimin e vitit 1976, janë në trendët që kanë ndodhur gjatë tri dekadave, me fjalë tjera, **nga statikja** në dinamike dhe **nga e centralizuara** në të **decentralizuarën**. Gjithashtu ekziston edhe një trend sa i përket '**konservimit të integruar**' në një perspektivë të re, e cila tani mund të shihet ndoshta më shumë si një

1 *Memorandumi i Vjenës për "Trashëgiminë Botërore dhe Arkitekturën Bashkëkohore – Menaxhimi i Peizazhit Urban Historik"*, UNESCO, Qendra e Trashëgimisë Botërore 2005 (WHC-05/15.GA/INF.7);

‘zhvillim i Integruar’.

Ndoshta mund të jetë interesante edhe nëse i referohemi konceptit Latin: *urbanum*, me qëllim që të kufizohet vendbanimi urban. Kjo mund të ndihmojë që të shënohet kufiri tradicional në mes të urbanes dhe rurales, i cili tani është duke u bërë paksa i paqartë. Me të vërtetë, vëmendja tani duket të jetë në **zgjerimin** e ndikimit urban në një kontekst shumë më të gjerë të planifikimit/menaxhimit. Prandaj, ne jemi duke folur jo vetëm për ‘urbanen’, por edhe për **urbanen-ruralen-natyrallen**. Mua gjithmonë më ka pëlqyer parimi në rekomandimin e vitit 1976: “Çdo zonë historike dhe rrethinat e saj duhet të konsiderohen me tërësinë e tyre si një total koherent, **bilanci dhe natyra specifike e të cilave varet nga fuzioni i pjesëve, prej të cilave është i përbërë dhe e cila përfshin aktivitetet e njeriut po aq sa ndërtesat, organizimin hapësinor dhe rrethinat**. “Në të njëjtën kohë, zonat historike janë të definuara si “trashëgimi të paluajtshme”. Dhe në kontekstin e Trashëgimisë Botërore, qytetet historike dhe zonat urbane në kushte normale janë të definuara si grupe të ndërtesave. Pyetja mund të shtrohet, nëse ne duhet ende të vazhdojmë të flasim vetëm për “trashëgiminë e paluajtshme dhe ‘grupet e ndërtesave’ në rastin e zonave të mëdha urbane? Në fakt, një Peizazh Urban Historik mundet që logjikisht të definohet si “një sit”.

Një Peizazh Urban Historik mund të ketë shumë elemente, nëse ne duam që t’i thërrasim në këtë mënyrë. Potencialisht, këto elemente do të përfshinin **zonat urbane dhe nën-urbane**, si dhe **mjedisin e ndërlidhur rural dhe natyror**. Mjedisi rural do t’i referohej tokës së kultivuar dhe të ndërtuar për **qëllime të jetës rurale dhe prodhimit**. Sot, një mjedis i tillë rural rrallëherë ekziston në afërsi të qyteteve të mëdha, sepse kjo pjesë është duke u bërë gjithnjë e më shumë e banuar. Megjithatë ajo ende mund të jetë relevante për qytetet më të vogla, të themi Assisi! Elementet gjithashtu përfshijnë **geomorfologjinë e rajonit në fjalë**, i cili jo vetëm që i referohet zonave të definuara vizuale, por edhe për një **vazhdimësi territoriale** që përfshin **hapësirën** mjedisore, duke mos harruar se **gjeologjia dhe materialet** janë pjesë e bazës së peizazhit të ndërtuar. Nëse e shikojmë peizazhin krahas këtyre elementeve, ne mund të cekim se **arkitektura e përditshme** në përgjithësi e merr karakterin e saj nga gjeologjia dhe materialet e zonës. Këto kanë edhe **ndikime vizuale edhe strukturore** në peizazh. **‘Para-ekzistencat’**, më saktë, shtresat e formave të vendbanimeve të mëparshme formojnë një aspekt tjetër që kontribuon në identitetin historik dhe kulturor dhe specifikim. Format e ngulitura të këtyre shtresave shpesh mund të lexohen në modelet e mëvonshme hapësinore të shtrirjes urbane.

Nëse i marrim aspektet më vizuale të peizazheve, ne mund t’iu referohemi për shembull koncepteve japoneze të **‘peizazheve të huazuara’, horizonteve të largëta dhe ‘lidhjes shpirtërore’** me suaza.² Qytetet dhe qytetet kanë suaza, të

2 E ashtuquajtura “Karta e Machinami”, Karta për Konservimin e qyteteve dhe vendbani-

cilat mund të përfshijnë male të largëta (p.sh. Romë, Teheran), ose ato mund të jenë të rrethuara nga kodrat (p.sh. Vjena, Bolonje, Bath), apo mund të ndërtohen në shpate ose në maje të kodrave (Assisi), ose mund të integrohen në fusha të kultivuara të cilat e formojnë identitetin e tyre vizual. Peizazhi urban historik mund t'i përfshijë të gjitha këto elemente ose disa prej tyre.

Të zhvillosh merret që nënkupton: të shpalosësh, të zbulosh, të prodhosh, të shkaktosh rritje.³ Zhvillimi pra mund të ketë kuptime të ndryshme. Nuk do të thotë domosdoshmërisht spekulim që synon për ta ndryshuar ose për ta zëvendësuar me të re. Zhvillimi mund të kuptohet si progres për përmirësimin e cilësisë së vendit dhe duke synuar në përmirësimin e cilësisë së jetës. Me të vërtetë, zhvillimi mund të kuptohet si zbulues i potencialit (kulturore, social, ekonomik) dhe të paraqitësh diçka që vazhdon t'i mbaj cilësitë dhe rëndësinë e saj. Ne mund ta integrojmë zhvillimin me qëndrueshmërinë kulturore dhe mjedisore.

Të zhvillosh mund të kuptohet si realizim i potencialit kulturor dhe mjedisor të një vendi ose një peizazhi, PUH. Çdo zhvillim do të bazohet në menaxhimin e burimeve. Kjo nuk i referohet domosdoshmërisht financave (edhe pse shpeshherë është mase të nevojshme), por të gjitha llojeve të burimeve, duke përfshirë ato njerëzore në përgjithësi dhe ato profesionale në veçanti. Një pjesë e burimeve është materiali ekzistues i ndërtimit dhe trashëgimia e mjedisit, të cilat nuk duhet të dëmtohen ose shkatërrohen me justifikimin e zhvillimit të pakujdesshëm.

Sigurisht, nëpërmjet analizës së karakteristikave dhe cilësive të një PUH-i të caktuar, mund të zbulohet se ka pasur edhe **ndryshime negative dhe zhvillime të dëmshme**. Kështu që planifikimi dhe menaxhimi i PUH-it gjithashtu duhet të përfshijë edhe masat korrigjuese që synojnë ta rrisin potencialin e cilësive të vendit. Çështjet që duhet të merren parasysh përfshijnë ndërtimin e rrugëve, linjat e energjisë elektrike, sistemet e ujitjes, etj. Këto zakonisht duhet të planifikohen në mënyrë të duhur, por mund të ketë gabime në relacionet e tyre me suazat e mjedisit, e cila është dashur të jetë e mundshme që të korrigjohet. Njëra nga problemet mund të jetë se infrastrukturën e tilla jo domosdoshmërisht vendosën në nivel lokal, por brenda kornizës rajonale apo kombëtare. Unë kam cekur se disa nga politikat evropiane ekonomike, komerciale dhe industriale apo

meve historike në Japan (e miratuar nga Komiteti Japonez i ICOMOS-it në vitin 2000) i jep definicionet në vijim: "*Machinami*, zakonisht përkthehet si 'Qytet Historik', është një fjalë japoneze që përfshin në nuancë të esencës historike, në të dy faktorët e vet, atë të prekjshëm dhe të paprekshëm, aspektet e saja fizike dhe shpirtërore, që do të krijohej nga një 'lidhje e shpirttrave'. Ajo gjithashtu përmban një ton për krijimin e një linje, dorë për dorë, e cila aplikohet edhe për njerëzit edhe për ndërtesat. *Shuuraku*, fjala japoneze për 'vendbanimin' shpeshherë përkthehet si fshat. Në këtë kartë gjithashtu përmban një ide për mjedisin rrethues natyror dhe kulturor të komunitetit."

3 Shorter Oxford English Dictionary, Oxford, 1975

strategjitë mund të jenë kundër rekomandimeve dhe konventave të Këshillit të Evropës në lidhje me konservimin e burimeve të trashëgimisë. Nuk duket të ketë ndonjë mekanizëm monitorimi në lidhje me këtë.

Konventa Evropiane e Peizazhit i përcakton kushtet e mëposhtme, të cilat gjithashtu mund të jenë të dobishme në rastin e PUH-it. Kjo veçanërisht ka të bëjë me çështjet e planifikimit dhe menaxhimit. Me të vërtetë, pasi të definohet PUH-i mund të jetë e nevojshme jo vetëm që të mbrohet, por edhe për të ndër-marrë masa korrigjuese si ‘restaurimin’ e horizonteve të largëta ose relacioneve hapësinore:

- d. “Mbrojtja e Peizazhit” nënkupton veprimet për t’i konservuar dhe ruajtur karakteristikat e rëndësishme apo tiparet karakteristike të një peizazhi, të justifikuar nga vlera e tij trashëgimore që rrjedh nga konfigurimi i tij natyror dhe/ose nga aktiviteti njerëzor;
- e. “Menaxhimi i Peizazhit” do të thotë veprim, nga një perspektivë e zhvillimit të qëndrueshëm, për të siguruar mirëmbajtje të rregullt të një peizazhi, në mënyrë që të merren dhe të harmonizohen ndryshimet të cilat rrjedhin nga proceset sociale, ekonomike dhe mjedisore;
- f. “Planifikimi i Peizazhit” do të thotë veprim i fuqishëm proaktiv për të përmirësuar, restauruar ose krijuar peizazhe.⁴

Lidhur me identifikimin e PUH-it

Ne duhet të përpiqemi që t’i qasemi PUH-it jo vetëm në dy (**PLAN**) dimensione, por në tri (**HAPËSIRË**) madje edhe në katër (**KOHË**) dimensione. PUH-i mund të përfshijë zona të mbrojtura, por PUH-i normalisht nuk do të përmbante një zonë të vetme të mbrojtur. Prandaj, jo domosdoshmërisht është e nevojshme që të fillohet me vizatimin e kufirit. Më tepër, do të ishte e nevojshme që së pari të identifikohen karakteristikat dhe cilësitë e rëndësishme të vendit. Karakteristikat e tilla të peizazhit mundën për shembull që të definohen në horizontet e largëta. Për të garantuar se horizontet e tilla mbeten të hapura mund të jetë e nevojshme kufizimi i lartësive të ndërtimeve në mënyrë që të mos pengohen ato, ose si alternative t’i deklarojnë zonat e tilla si ‘*të pa-ndërtueshme*’.

Cilësitë hapësinore të një peizazhi urban, apo të pamjes së qytetit, nuk do të perceptohen në të njëjtën kohë, por më tepër si një sekuencë e hapësirave. Cilësitë e tilla mund të qasen në nivelin mikro, sa i përket hapësirës së ndërtuar (**pamja e qytetit**),⁵ siç përjetohet gjatë ecjes ose ngasjes së ngadaltë të makinës nëpër

4 Konventa Evropiane e Peizazhit, 2000, neni 1,d-f

5 Nocioni i ‘peizazhi i qytetit’ së pari ishte analizuar nga Gordon Cullen në vitin 1950’ta (shih: G. Cullen, *Concise Townscape*, Reed Educational and Professional Publishing Ltd, Oxford 1961)

zonat urbane, si dhe në nivelin makro përbrenda vazhdimësisë së peizazhit. Me të vërtetë, në nivelin makro ne nuk duhet të mendojmë se PUH-i përfundon në këtë anë të kodrës, por ai mund të vazhdojë edhe mbrapa duke ofruar seri të reja të cilësive hapësinore, si dhe surprizat dhe dramën që rezultojnë nga ngasja e makinës përmes peizazhit. PUH-i nuk duhet të përjetohet vetëm nga një pikëpamje, por më tepër duhet të definohet në lidhje me panoramat e shumta dhe pikëpamjet hapësinore brenda rajonit në fjalë dhe pikëpamjet në suaza - madje edhe atyre të largëta - në formën e peizazheve të huazuara.

Sa i përket kufizimeve, është e nevojshme që ta shqyrtojmë konceptin e Peizazhit Urban HISTORIK. Unë e kuptoj që një peizazh urban për të qenë historik duhet të merret si rezultat i një procesi gradual, me kalimin e kohës. Të jetë 'historik' nuk do të thotë se i tërë vendi duhet të mbrohet si trashëgimi kombëtare. Ai lehtë mund t'iu referohet peizazheve të përditshme lokale. Në fakt, pyetja është shtruar për rolin e turizmit në definicionin/njohjen e PUH-it. Pikëpamja ime është se turizmi është në proces të ndryshimit dhe ka një numër në rritje të njerëzve të cilët nuk duan të shkojnë me turmën, por më me dëshirë që t'i kontaktojnë popullatat lokale dhe të mësojnë nga jeta normale. Në fakt, ka raste si në Kyoto në Japoni, ku popullata lokale me dashje ka marrë iniciativën për t'ia filluar përmirësimin të mjedisit të tyre urban, përmirësimin e dizajnit të përparmeve të dyqanit dhe duke i hequr qafe blloqet e mëdha të shëmtuara të ndërtimit. PUH-i së pari do t'i shërbente popullsisë lokale. Prandaj, do të ishte thelbësore për të siguruar mekanizma që lejojnë fuqizimin e tyre dhe përfshirje të informuar.

Duke e hedhur një vështrim në historinë e vendbanimeve, ne mund të shohim se deri në shekullin e 17 madje edhe 18, qytetet dhe qytezat kanë qenë të fortifikuara. Megjithatë, duke filluar nga këtu, fillon të rritet banimi i tokave që gjenden jashtë mureve të qytetit. Me Revolucionin Industrial, ky banim bëhet një model i rritjes dhe në shumë raste muret e qytetit edhe janë prishur. Në Vjenë, muret barok janë zëvendësuar me Ringstrasse të shekullit 19, e cila në vetvete bëhet një arritje e rëndësishme arkitektonike (tani pjesë e TB).⁶ Zona e lashtë e muruar e qytetit, si ajo e Vjenës, do të ishte e rrethuar nga zhvillimet periferike, të cilat në shumë raste nuk ishin të njëtrajtshme, por përfshinte rritje në fshatra dhe qendrat e afërta rurale, të cilat gradualisht u bënë pjesë e zonës urbane. Në fakt, në kundërshtim me deklaratat e shumë kartave ndërkombëtare, zonat urbane historike më shpesh janë **heterogjene** sesa të harmonizuara dhe të njëtrajtshme. Me të vërtetë, diversitetet e tilla sociale dhe kulturore mund të

6 Qendra Historike e Vjenës u fut në Listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 2001, me rekomandim specifik për të mos ndërtuar ndërtesa të larta, të cilat do t'ia pengonin integritetin vizual. Projekti në vazhdim për zhvillime të larta në zonën e Wien Mitte ndaloi dhe një konferencë ndërkombëtare u mbajt në Vjenë në vitin 2005, për ta diskutuar paraqitjen e ndërtesave moderne në kontekstin historik.

bëhen pasuri në zhvillimin e ri.

Si rezultat, qendrat e lashta duke përfshirë qytetet dhe fshatrat e muruara shpeshherë e mbajnë të paktën një pjesë të teksturës së tyre historike (para shekullit të 19) të cilat janë specifike e sitit. Ndërsa, zonat përreth kanë tendencë që t'i reflektojnë trendet e planifikimit urban dhe arkitektonik të shekullit të 19 dhe 20, të cilat janë gjithnjë e më shumë të ngjashme me të gjitha pjesët e botës, duke reflektuar trendet globale. Megjithatë, sot doktrinës ndërkombëtare i është dhënë njohje jo vetëm për ndërtesat dhe zonat e vjetra, por edhe për arkitekturën më të fundit dhe materialin ndërtimor. Pra, ne nuk mund të themi se diçka që është e kohëve të fundit nuk vlen. Me të vërtetë, rekomandimi në lidhje me nocionin e PUH-it nuk është vetëm për pronat e Trashëgimisë Botërore, edhe pse Komiteti i Trashëgimisë Botërore tanimë e ka njohur rëndësinë e trashëgimisë që është ndërtuar së fundmi. Megjithatë, është e nevojshme që të hartohen udhëzime për vlerësimin dhe njohjen e zonave të qasura me fushëveprimin e definimit të PUH-it. Udhëzimet e tilla duhet të jenë të zbatueshme në çdo zonë urbane historike dhe në raste të veçanta zonat e tilla mund të kualifikohen madje edhe për njohje në TB.

Referencat doktrine?

Duket se do të na duhet që të kthehemi prapa tek definicioni i restaurimit nga Cesare Brandi: **Restaurimi përbëhet nga momenti metodologjik në të cilin vepra e artit njihet në gjendjen e vet fizike edhe në natyrën e vet të dyfishtë estetike dhe historike, në këndvështrimin e transmetimit të vet në të ardhmen.**⁷

Megjithatë, ne nuk jemi duke u përpjekur për ta definuar peizazhin urban historik si “vepër arti”. Por, sigurisht që është një produkt i aktiviteteve kreative njerëzore (pak a shumë). Prandaj, ne mund të mësojmë nga qasja e Brandi-t për definimin e një produkti të veçantë të njerëzimit, kësaj here i quajtur PUH. Ne kemi nevojë që ta krijojmë një qasje historiko-kritike e cila duhet t'i merr parasysh cilësitë estetike-vizuale të një vendi (mikro-makro), si dhe procesin i cili gradualisht e ka prodhuar rezultatin (historia). Ne duhet ta marrim parasysh vlerën e gjykimeve e cila ka mundur të evoluojë me kalimin e kohës dhe pastaj ta bazojmë vlerësimin tonë në identifikimin dhe vlerësimin e kriterëve të cilat janë përdorur në ndërtimin e zonave në fjalë. Në kohët më të fundit, këto kritere zakonisht mund të gjenden në planet themelore urbane, ndërsa në shekujt e mëparshëm ato është dashur që të zbulohen përmes një analize të teksturës urbane dhe dëshmive relevante dokumentare nëpër arkiva. Kthim prapa në teorinë e restaurimit, Brandi konkludon se: *Vetëm materiali i veprës së artit restaurohet.*⁸ Në kontekstin urban, kjo qartë se i referohet teksturës fizike. Në anën

7 C. Brandi, *Teoria del restauro*, Edizioni di Storia e Letteratura, Roma 1963, p. 34

8 C. Brandi, op.cit. p. 35

tjetër, kjo nuk i përjashton përpjekjet për ta mbrojtur trashëgiminë e paprekshme kulturore, vazhdimësinë sociale-kulturore në komunitet.

Sa i përket definimit të zonave urbane historike, ne mund t'ia fillojmë duke kujtuar se Bernardo Secchi në leksionin e tij *Lezione Prima di Urbanistica* e krahason një qytet me një kopsht.⁹ Pra, çfarë është një kopsht historik: Karta e Firences¹⁰ e vitit 1982 e ICOMOS-it e definon si në vijim:

Art. 4. Përbërja arkitektonike e kopshtit historik përfshin: planin e vet dhe topografinë e vet. Bimësinë e vet, duke përfshirë speciet e veta, proporcionet, skemat e ngjyrave, hapësirën dhe lartësitë përkatëse. Karakteristikat e saj strukturore dhe dekorative. Ujin e vet, të rrjedhshëm ose të palëvizshëm, duke reflektuar qiellin.- -

Art. 9. Ruajtja e kopshteve historike varet nga identifikimi i tyre dhe renditja. Ato kërkojnë disa lloje të veprimit, më saktë, mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimit. Në raste të caktuara, rindërtimi mund të rekomandohet. Autenticiteti i një kopshti historik varet po aq shumë nga dizajni dhe përmasat e pjesëve të tij të ndryshme, sa edhe për karakteristikat e tij dekorative dhe në zgjedhjen e bimëve apo materialeve të adoptuara inorganike për secilin prej pjesëve të tij.

Në lidhje me karakterin dhe njohjen e zonave historike të jetesës, ne mund ta kujtojmë *Carta de Petrópolis* të vitit 1987 nga ICOMOS-i,¹¹ e cila thotë:

Qëllimi kryesor i ruajtjes është mirëmbajtja dhe përmirësimi i modeleve të referimit të cilat janë të nevojshme për shprehjen dhe konsolidimin e shtetësisë. Është përmes pikëpamjes së ndarjes politike qytetare të hapësirës urbane që ruajtja mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Në të njëjtin vit, Karta a ICOMOS-it për Qytete Historike¹² shfaq:

- 1) Për të qenë maksimalisht efektiv, konservimi i qyteteve historike dhe zonave tjera urbane historike, në çdo nivel duhet të jetë pjesë integrale e politikave koherente të zhvillimit ekonomik dhe social dhe të planifikimit urban dhe rajonal.
- 2) Cilësitë që duhet të ruhen përfshijnë karakterin historik të qytetit apo zonës urbane dhe të gjitha ato elemente materiale dhe shpirtërore që shprehin këtë karakter, sidomos:
 - a) modelet urbane siç përcaktohen nga parcelat dhe rrugët;

9 Bernardo Secchi, *Prima lezione di urbanistica*, Edizioni Laterza, 2004

10 ICOMOS, *Karta e Firences për Parqet Historike*, e miratuar nga ICOMOS-i në dhjetor të vitit 1982

11 *Carta de Petrópolis* ishte hartuar gjatë seminarit të parë brazilian për ruajtjen dhe rivalizimin e e Qendrave Historike, në Petrópolis në vitin 1987

12 ICOMOS, *Karta për Ruajtjen e Qyteteve Historike dhe Zonave Urbane "Karta e Uashingtonit"*, 1987, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në Uashington D.C në tetor të vitit 1987

- b) marrëdhëniet midis ndërtesave dhe hapësirave të gjelbra dhe të hapura;
- c) pamja formale, interieri dhe eksterieri i ndërtesave siç definohet nga shkalla, madhësia, stili, ndërtimi, materialet dhe dekorimi;
- d) Marrëdhënia në mes të zonës urbane të qytetit apo dhe vendosjen e saj përreth, si asaj natyrore ashtu edhe asaj të bërë nga njeriu; dhe
- e) funksionet e ndryshme që qyteti apo zona urbane i ka fituar me kalimin e kohës.

Çfarëdo dëmi ndaj këtyre cilësive mund ta rrezikojë autenticitetin dhe/ose integritetin e qytetit historik apo zonës urbane.

Qasjet në PUH

Cilësitë e mësipërme vazhdojnë të jenë referenca të vlefshme në lidhje me njohjen dhe mbrojtjen e Peizazheve Urbane Historike. Një hap tutje i cili tani është i nevojshëm është të eksplorohej se si të qaset procesi i ruajtjes dhe konservimit të peizazheve urbane historike. Udhëzimet e Trajnimit të vitit 1993 të ICOMOS-it¹³ definojnë **‘konservimin’**: *Objektivi i konservimit është që të zgjatet jeta e trashëgimisë kulturore dhe nëse është e mundur që të sqarohen mesazhet artistike dhe historike pa e humbur autenticitetin dhe domethënien. Konservimi është një aktivitet kulturor, artistik, teknik dhe artizanal i bazuar në studimet humaniste dhe shkencore dhe kërkimit sistematik. Konservimi duhet ta respektojë kontekstin kulturor.* Në gjuhën ndërkombëtare angleze, konservimi në përgjithësi merret për ta treguar qasjen e përgjithshme ndaj ruajtjes së cilësive dhe vlerave të ndërlidhura me burimet historike, qofshin ato ndërtesa individuale apo zona të mëdha. Natyrisht, e njëjta gjë do të mund të përdorej edhe për lloje specifike të trajtimeve, si për konservimin e sipërfaqeve arkitekturore.

Sa i përket konceptit të “restaurimit”, Karta e Venedikut e vitit 1964 e definoi: *Procesi i restaurimit është një operacion shumë i specializuar. Qëllimi i tij është që ta ruajë dhe ta zbulojë vlerën estetike dhe historike të monumentit dhe është i bazuar në respektin e materialit origjinal dhe dokumentet autentike. (neni 9) Teoria e Brandit për Restaurimin, e cila u botua vetëm një vit më parë e definoi restaurimin: Restaurimi duhet ta ketë për qëllim që të rikrijojë unitetin potencial (‘UNITA potenziale’) të veprës së artit, përderisa kjo është e mundur pa kryer falsifikim artistik ose historik dhe pa fshirë çdo gjurmë të kohës nëpër të cilat ka kaluar vepra e artit.*¹⁴ Përsëri, restaurimi mund të ketë konotacione të ndryshme;

13 ICOMOS, Udhëzimet për Arsimim dhe Trajnim për Konservimin e Monumenteve, ansambleve dhe Siteve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e ICOMOS-it në Colombo, Sri Lanka, në vitin 1993

14 C. Brandi, op. cit., p. 36: ‘Il restauro deve mirare al ristabilimento della unità potenziale dell’opera d’arte, purché ciò sia possibile senza commettere un falso artistico o un falso storico, e senza cancellare ogni traccia del passaggio dell’opera d’arte nel tempo.’

një nga to është operacioni i specializuar siç u cek më lart. Konotacioni tjetër mund të lidhet me kulturën moderne të konservimit, me fjalë tjera, njohjen e vendeve historike si trashëgimi dhe ndërmarrjen e proceseve për mbrojtjen dhe konservimin e tyre. Karta Italiane e Restaurimit e vitit 1972,¹⁵ e cila është shkruar në bashkëpunim me Brandi-n, ku në lidhje me zonat urbane historike thekson: Karakteri historik i referohet interesit të cilin e përfaqësojnë vendbanimet tilla si dëshmi të civilizimeve të kaluara dhe si dokumente të kulturës urbane, madje edhe në mënyrë të pavarur nga meritat e brendshme artistike apo formale apo aspekti i tyre i veçantë mjedisor, i cilat mund ta përmirësojnë më tej apo t'ia rrisin vlerën e vet, duke pasur parasysh se jo vetëm arkitektura por edhe tekstura urbane, në vetvete, ka rëndësi dhe vlerë.


Edhe pse PUH-i nuk është domosdoshmërisht një Vepër Arti dhe ka shumë diferencë në implementimin e qasjeve, në krahasim me ndërtesat individuale apo ansamblet e vogla, ekziston diçka e përbashkët. Çështja kryesore ka të bëjë me përkujdesjen e rezultateve të krijimtarisë njerëzore. Ndonjëherë bëhet fjalë për një kryevepër të një kontributi krijues; në raste tjera ne mund të merremi me vendbanime të përditshme modeste tradicionale dhe me rrethinat e tyre rurale. Sidoqoftë, në përputhje me teorinë e restaurimit, identifikimi i një Peizazhi Urban Historik duhet të kuptohet si një rezultat i njohjes së cilësive specifike sociale-kulturore dhe vlerat që ndërliidhen me mjedisin e ndërtuar brenda suazave të veta, duke i arsyetuar masat e mbrojtjes. Ashtu si teoria e restaurimit, teoria e PUH-it duhet të ofrojë parime të cilat mund të udhëzojnë një qasje historike-kritike për identifikimin dhe njohjen e karakteristikave të specifikuar në mjedis, të ndërliidhura me shtresat e rëndësishme dhe vlerat, të cilat mund të propozohen për t'u ruajtur, restauruar dhe/ose zbuluar.

Korniza strategjike

Teoria e restaurimit i referohet procesit kritik me anë së cilës njihet rëndësia e një vepre të artit. Posa të definohet, vepra e artit mund të perceptohet si **unità potenziale**. Ky nocion nganjëherë përkthehet si '*uniteti potencial*', e cila megjithatë nuk e shpreh domethënien e '*unità*' e kuptimit të vet për të 'qëndruar së bashku', 'krijimi i një bashkimi'. Kjo do të thotë se cilësia artistike i referohet një tërësie artistike, e cila është më e madhe sesa totali i shumës së pjesëve të saj. Ajo është tërësia që e mbart domethënien e cila potencialisht mund të ndërliidhet me pjesët e perceptuara individuale krahas tërësisë së tyre. Duke pasur para-

15 Carta Italiana del Restauro, 1972, Circolare n. 117 del 6 aprile 1972, Ministero della Pubblica Istruzione, allegato d: 'Il carattere storico va riferito all'interesse che detti insediamenti presentano quali testimonianze di civiltà del passato e quali documenti di cultura urbana, anche indipendentemente dall'intrinseco pregio artistico o formale o dal loro particolare aspetto ambientale, che ne possono arricchire o esaltare ulteriormente il valore, in quanto non solo l'architettura, ma anche la struttura urbanistica possiede, di per se stessa, significato e valore.'

sysh se pjesë të ndryshme të një Peizazhi Urban Historik janë ndërtuar në një kontekst specifik, domosdoshmërisht ekziston një lidhje me atë që ka qenë aty më parë. Ose, të paktën, do të duhej të ekzistojë një lidhje e tillë. Fatkeqësisht, zhvillimet e fundit urbane kanë pasur prirje që ta injorojnë këtë çështje, por ajo është njëra më me interes për PUH-in edhe në diversitetin e vet të brendshëm.



Ideja e *unità potenziale* mund të shihet në identifikimin e **integritetit** të një Peizazhi Urban Historik. Gjendja e integritetit të një vendi mund t’i referohet identifikimit të elementeve dhe karakteristikave të cilat janë të rëndësishme për tërë PUH-in dhe ku elementet duhet të shihen si pjesë e tërësisë. Së dyti, integriteti i referohet gjendjes së konservimit dhe gjendjes vizuale të zonës përkatëse. Rrjedhimisht, çështja e integritetit mund të definohet në lidhje me:

- a) marrëdhëniet funksionale dhe simbolike që lidhin elemente të ndryshme, të cilat janë krijuar ose janë rritur si rezultat i forcave të prodhimit, zhvillimi ekonomik, shoqëror dhe kulturor i vendit (**integriteti social dhe funksional**);
- b) gjendjen e konservimit të elementeve individuale të vendit, të cilat mund t’i referohen gjendjes historike-tipologjike-morfologjike të teksturës dhe suazave të saj (**integritetit strukturor dhe historik**);
- c) imazhit vizual që rezulton nga proceset e ndërtimit dhe transformimit me kalimin e kohës (**integriteti vizual**, apo uniteti potencial, duke përdorur termin e Brand-it).

Strategjitë që ndërlihen me Integritetin Funksional: Është thënë më parë se historia e ndërton qytetin.¹⁶ Megjithatë, kjo do të ishte më e saktë nëse i referohet proceseve ekonomike, sociale dhe kulturore të cilat i krijojnë forcat e zhvillimit. Me të vërtetë, për ta kuptuar rëndësinë e një Peizazhi Urban Historik është e nevojshme që të kuptohen arsyet për themelimin e një vendi dhe forcave që kanë bërë nxitjen e zhvillimit të tij të mëtutjeshëm. Arsyet mund të jenë të ndërlihdura me ekonomikitetin, si tregtia dhe industria, ose për arsye kulturore, shpirtërore apo të tjera. Mënyra se si një vend zhvillohet është kryesisht e varur nga mjedisi që e formon vendndodhjen e tij, përfshirë gjeologjinë dhe materialet në

16 Arthur Korn, *Historia e Ndërton Qytetin*, Lund Humphries, Londër, viti 1955

dispozicion, se a është lokacioni në rrafshinë apo në rajonin malor, si dhe lidhja e tij me rrugët potenciale të komunikimit. Forcat e zhvillimit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës duke rezultuar me ndryshime në përdorimin e tokës dhe me rrjete të reja të komunikimit. Ndryshimet e tilla mund të mblidhen duke rezultuar në një stratigrafi të modeleve të shfrytëzimit të tokës të cilat mund të njihen si pjesë e historisë dhe arkeologjisë së vendit.

Në bazë të analizave të tilla mund të identifikohet masa e ndikimeve që qendrat e prodhimit kanë ose e kanë pasur gjatë kohës dhe marrëdhëniet reciproke të elementeve të ndryshme, qofshin si rezultat i dizajnit të qëllimshëm apo rritjes graduale. Zakonisht proceset janë të shoqëruara nga transformimi gradual i mjedisit në bashkëveprim me natyrën, gjithashtu duke kontribuar në integritetin e përgjithshëm vizual të vendit. Për më tepër, në varësi të llojit dhe karakterin e vendit, nuk mund të shtresave të ndryshme të rëndësisë që lidhen me të, duke përfshirë referencat simbolike, shpirtërore ose mitologjike me pikat kryesore individuale, plani i lokacionit (p.sh. gjeomanci).¹⁷

Strategjitë që lidhen me Integritetin Struktural: Jeta është e ndërlidhur me ndryshim. Një komunitet që jeton krijon dhe/ose i nënshtrohet proceseve të vazhdueshme, të cilat mund të rezultojnë me transformimin gradual të peizazhit urban dhe marrëdhëniet së saj me vendndodhjen. Këtu mund të ketë situata të ndryshme:

- a) Me kalimin e kohës, komuniteti mund ta ketë **arritur një ekuilibër**, duke konsoliduar marrëdhëniet e ndryshme dhe ta ketë një përdorim optimal të shfrytëzimit të hapësirës në dispozicion. Si rezultat, derisa prodhimi mund të vazhdojë, kjo nuk do të rezultojë domosdoshmërisht në rritje fizike të zonave të banuara.
- b) Në komunitetet e tjera, **proceset e rritjes mund të vazhdojnë**, duke rezultuar me komunitete edhe më të mëdha dhe madje edhe në metropole, ku disa komunitete vijnë së bashku në një ansambël administrativ. Carta de Petropolis e Brazilit ka paraqitur: *“Brenda kësaj hapësire të gjerë, të pasuruar me vlerat e origjinës së fundit apo të largët dhe që vazhdimisht është duke kaluar nëpër një proces dinamik të transformimeve të njëpasnjëshme, hapësirat e reja urbane mund të konsiderohen si dëshmi mjedisore në fazat e tyre formuese.”*
- c) Një rast i tretë mund të formohet nga komunitetet, ku **gjendja ekonomike është në rënie** dhe popullata mund ta lë vendin, i cili braktiset

17 Nacioni i 'gjeomancisë' i referohet një fjale greke që tregon një metodë hyjnore e cila i interpreton shenjat në tokë ose modelet e formuara nga dheu, gurët apo rëra e hedhur. (see: Wikipedia) Koncepti i gjeomancisë ishte i rëndësishëm në Kinën antike, me rastin e identifikimit të vendeve të përshtatshme për ndërtim në mjedis. Kjo mund të jetë një çështje që gjithashtu të merret parasysh definimi i PUH-it.

gradualisht. Varësisht prej rëndësisë së secilit rast, strategjitë mund ta favorizojnë ruajtjen e gjendjes ekzistuese si dëshmi e proceseve të kaluara, ose mund të ketë interesa për t’i ringjallur qendrat e tilla duke i integruar ato me energji të re.

Politikat dhe strategjitë për ruajtjen dhe zhvillimin e integruar të një Peizazhi Urban Historik do të varet nga vlerësimi i situatës siç u tha më lart. Sidoqoftë, është e nevojshme që të verifikohet kompatibiliteti i përdorimit dhe përputhshmëria e strukturave ekzistuese me modelet historikisht të konsoliduara, si dhe gjendja e konservimit e elementeve të rëndësishme dhe karakteristikave. Si rezultat i vlerësimeve të tilla, është e mundur që të identifikohen politikat dhe strategjitë e duhura të cilat synojnë ruajtjen e tipareve ekzistuese dhe më në fund riparimi i elementeve pjesërisht të humbura në mënyrë që të rriten cilësitë e PUH-it. Në të njëjtën kohë, gjithashtu është e nevojshme që të krijohet një sistem i menaxhimit dhe monitorimit, në mënyrë që të parashikohet dhe drejtohet ndonjë transformim i mundshëm në harmoni me cilësitë e vendit.

Strategjitë që kanë të bëjnë me Integritetin Vizual: Rekomandimi¹⁸ i UNESCO-s i vitit 1962 thekson se: **ruajtja e bukurisë dhe karakterit të peizazheve dhe siteve merret që nënkupton ruajtjen dhe ku është e mundur restaurimin** e aspektit të peizazheve natyrore, rurale dhe urbane, si dhe siteve, qofshin natyrore ose të bëra nga njeriu, të cilat kanë një interes kulturor ose estetik apo formojnë rrethana tipike natyrore.

Konventa Evropiane mbi Peizazhet (2000)¹⁹ e jep definicionin e mëposhtëm: **“Peizazh” nënkupton një zonë, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilit është rezultati i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë.** Si rrjedhojë, vlerësimi vizual apo estetik është i një rëndësie themelore për **perceptimin e peizazhit**. Në parim, çdo zonë mund të definohet si peizazh nëse njihet si i tillë nga një komunitet.

Sa i përket Peizazhit Urban Historik, këtu kemi të bëjmë me peizazh urban brennda suazave të veta mjedisore, që rezultojnë nga proceset e rritjes graduale dhe që perceptohet dhe njihet për rëndësinë e vet kulturore. Prandaj, PUH-i nuk duhet të vlerësohet vetëm për bukurinë e vet estetike, e cila edhe ashtu nuk është e lehtë për t’u vlerësuar, por më tepër si një rezultat i proceseve shoqërore, kulturore dhe ekonomike që ia kanë dhënë atij formën aktuale. Prandaj, estetika duhet të bazohet në vlerësimin kritik të cilësive dhe karakteristikave të cilat historikisht e kanë definuar PUH-in dhe për të cilat është njohur nga komuniteti.

Qasjet ndaj politikave të ruajtjes së integritetit vizual të PUH-it do të varen nga

18 UNESCO Rekomandimi në lidhje me Ruajtjen e Bukurisë dhe Karakterit të Peizazheve dhe Siteve, viti 1962, neni 1

19 Konventa Evropiane e Peizazhit, e miratuar në takimin e 718 të Ministrave të Komitetit të Këshillit të Evropës, në vitin 2000, neni 1, a

identifikimi dhe njohja e rëndësisë së elementeve individuale, si një pjesë e tërë peizazhit. Në lidhje me karakterizimin e dinamikës së zonës në fjalë, ne i kemi identifikuar tri raste:

- a) PUH-i vazhdon të jetojë dhe të zhvillohet, por e ka **arritur një ekuilibër** sa i përket marrëdhënieve të tij me vendndodhjen. Mund të ketë potencial për ndryshime të vogla në teksturën ekzistuese dhe shfrytëzimin e tokës.
- b) PUH-i vazhdon procesin e rritjes dhe **potencialisht zgjerohet**. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë ndryshime strukturore në teksturën ekzistuese dhe shfrytëzimin e tokës, duke përfshirë zënie të mundshme të më shumë tokës nëpër zonat përreth;
- c) PUH-i është duke iu ekspozuar **rënies ekonomike** duke rezultuar me më pak aktivitete dhe humbje të mundshme të popullsisë. Kjo mund të nënkuptojë se ka më pak burime në dispozicion për mirëmbajtjen dhe kujdesin e teksturës historike dhe tokave të kultivuara.

Marrë parasysh se PUH-i është domosdoshmërisht pjesë e një konteksti më të gjerë social-ekonomik, nevojat e planifikimit dhe menaxhimit duhet ta marrin këtë parasysh. Është veçanërisht e rëndësishme që të merret parasysh globalizimi i cili është gjithmonë në rritje dhe nivelet e ndryshme të vendimmarrjes, ku autoritetet lokale dhe komuniteti shpesh duhet të jetojnë me strategji të cilat janë marrë diku tjetër.

Veglat e Planifikimit dhe Menaxhimit

Peizazhi Urban historik do të thotë një qasje për identifikimin dhe njohjen e cilësive specifike, karakteristikave dhe marrëdhënieve të rëndësishme në territorin e ndërtuar dhe atë natyral, e që me kalimin e kohës ka rezultuar nga proceset dhe është i ndërlidhur me shtresa të shumëfishta të rëndësishme. Ruajtja dhe Zhvillimi i Integruar i nënkupton proceset e planifikimit dhe menaxhimit, ndërsa monitorimi dhe kontrolli nënkupton forcat dhe normat e ndryshimit në mënyrë që t'i mbajë dhe/ose rigjenerojë dhe t'i përmirësojë cilësitë e PUH-it.

Planifikimi dhe menaxhimi i Peizazheve Urbane Historike domosdoshmërisht do të përfshijë akterë dhe autoritete të shumta të cilat gjenden në nivele të ndryshme të hierarkisë. Prandaj, njëra nga çështjet kryesore në menaxhim do të jetë **komunikimi**. Kjo duhet të jetë mirë e integruar në sistemin e menaxhimit dhe planet, në mënyrë që të jetë efektive. Për dallim nga situata e viteve të 1970'ta, kur u hartua Rekomandimi i UNESCO-s në lidhje me zonat historike pat pamjaftueshmëri të autoritetit të centralizuar. Me të vërtetë, roli i iniciativave nga ana e **sektorit privat** është rritur në shumë vende. Në të njëjtën kohë, **vendimet kombëtare** në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe ndërtimin e sistemeve të komunikimit dhe infrastrukturës mund të kenë ndikim serioz në komunitetet

individuale, të cilëve iu jepet shumë pak mundësi për të thënë diçka për procesin, ose janë të informuar shumë vonë. **Rrjedhimisht, menaxhimi i informacionit dhe një sistem efektiv i monitorimit i proceseve të vendimmarrjes që shtrihet në të gjitha nivelet, janë vendimtare.**

Peizazhet Urbane Historike shpesh i referohen territoreve relativisht të mëdha, përfshirë ndërlidhjet madje edhe me karakteristikat e largëta. Rrjedhimisht, marrë parasysh kompleksitetin në fjalë, do të ketë nevojë për një numër të ndryshëm të instrumenteve të planifikimit dhe menaxhimit. Qartë, zgjedhja do të duhet të vendoset sipas rastit të caktuar, duke marrë parasysh fushëveprimin e punës. PUH-i mund të përmbajë ndërtesa të mbrojtura historike, zona urbane apo rurale të konservimit, si dhe mjedise të mbrojtura natyrore. Gjithashtu mund të ketë edhe horizonte të rëndësishme dhe panorama të cilat iu referohen zonave përtej kompetencës administrative të një komuniteti. Për shembull, në rastin e Chandigarh, një peizazh i rëndësishëm malor i njohur nga Le Corbusier është jashtë juridiksionit të shtetit që e përmban qytetin. Për më tepër, shpesh herë ekzistojnë plane themelore urbanistike, si dhe planet urbane të konservimit, planet për menaxhimin e vizitorëve etj. **Esenciale** është se të gjitha këto plane dhe sistemet e **ndërlidhura me menaxhimin** të jenë të **referuar tërthorazi. Në veçanti, do të jetë e nevojshme që të monitorohet se nuk ka propozime që potencialisht do të binin** në konflikt me parimet dhe strategjitë e shprehura në **PUH.**

Përcaktimi dhe implementimi i PUH-it do të ishte kryesisht i bazuar në planifikimin ekzistues dhe/ose në një të ri, si dhe instrumentet e menaxhimit, varësisht prej rastit. PUH-i nuk do të ishte vetëm një plan tjetër themelor, por më shumë do të duhet të ofrojë një referencë të përgjithshme të politikave për ruajtje dhe politika për zhvillim të integruar dhe strategji. Ka shumë analiza të cilat janë të nevojshme si pjesë e procesit të njohjes së PUH-it. Këto mund të ndërmerren duke përdorur instrumentet ekzistuese të planifikimit/menaxhimit. Ngjashëm, implementimi i masave të ruajtjes, planifikimi i përdorimit të tokës dhe menaxhimi do të mund të kryheshin brenda kornizave të instrumenteve ekzistuese. Njohja e PUH-it me siguri do të kërkonte disa informata shtesë dhe masa menaxhuese, të cilat do të duhej të rregulloheshin dhe rezultatet të integroheshin në instrumentet përkatëse. **Si rrjedhim, ne mund të konsiderojmë se PUH-i, posa të njihet, do të bëhet një kornizë e përgjithshme e menaxhimit. Ajo do të zbatohet përmes veglave të ndryshme të cilat janë të nevojshme për kontroll dhe zhvillimin e mjedisit të ndërtuar dhe natyror, por duke i pasur parasysh dhe integrimin e parimeve dhe udhëzimeve të zhvilluara në lidhje me PUH-in.**

Vlen ende të përsëritet definicioni i konservimit në Udhëzimet e Trajnimit të ICO-MOS-it të vitit 1993: **'tani i njohur si pushues përbrenda fushës së** përgjithshme të zhvillimit mjedisor dhe kulturor. **Strategjitë e qëndrueshme të menaxhi-**

mit, të cilat e respektojnë trashëgiminë kulturore kanë nevojë për integrimin e qëndrimeve të konservimit me objektivat bashkëkohore ekonomike dhe sociale, duke përfshirë edhe turizmin.' Rrënjësisht, edukimi dhe sensibilizimi për konservimin e trashëgimisë duhet të fillojë në shkolla dhe të vazhdojë në universitete e tutje, siç theksohet në Udhëzimet e ICOMOS-it. Ka pasur një tendencë në vitet e fundit për ta theksuar rolin e komunitetit lokal, i cili është i rëndësishëm, madje edhe thelbësor. Megjithatë, kjo nuk duhet të rezultojë me përjashtimin e profesionistëve. Konservimi i trashëgimisë kërkon një qasje shumë-disiplinore e cila përfshin shumë profesione, si dhe pronarët e pronave dhe vendimmarrësit. Duke pasur parasysh se UNESCO tani është duke propozuar për ta integruar kulturën si njërin nga shtyllat e politikave të Kombeve të Bashkuara, është madje edhe më e rëndësishme që iniciativat e tilla të merren në nivel kombëtar dhe lokal. Politikat e tilla edukative dhe trajnuese duhet ta marrin parasysh integrimin e vetëdijesimit të nevojshëm, si një kërkesë në strukturat e karrierës së profesionistëve dhe në emërimin e zyrtarëve përgjegjës për menaxhim dhe zhvillim të mjedisit të ndërtuar dhe atij natyror.

Njohja e Peizazhit Urban Historik është një çështje kulturore. Vlerat e ndërlidhura janë pjesërisht kulturore dhe sociale, pjesërisht ekonomike dhe politike. Çështja kryesore ka të bëjë me gjetjen e një gjuhe të përbashkët midis këtyre qëndrimeve që shpesh bien në konflikt dhe të ndërtohet një qasje që i njeh jo vetëm cilësitë e mjedisit ku jetojmë, por që gjithashtu është në gjendje për gjykime dhe kritika të ekuilibruara në lidhje me përmirësimin dhe zhvillimin e tij. Personalisht unë gjithmonë kam qenë kritik ndaj definimit 'konservimi është i barabartë me menaxhimin e ndryshimit'. Është e qartë se ndryshimi është i përfshirë. Ne kemi të bëjmë me entitete të gjalla. Ne kemi nevojë për progres. Ne kemi nevojë që të përmirësohemi. Prandaj, ne kemi nevojë për njohuri në lidhje me burimet e trashëgimisë tonë dhe kemi nevojë për gjykimin kritik bazuar në vlerësimin e balancuar të pasurive dhe meritat e vendimeve në lidhje me integrimin e qasjes së PUH-it në proceset e vendimmarrjes.



Dimensioni i paprekshëm në trashëgiminë kulturore

Disa reflektime për interpretimet moderne dhe tradicionale, nga Jukka Jokilehto

Konceptit të 'kulturës' i janë dhënë shumë definicione. Në shekullin e nëntëm-bëdhjetë, ajo ishte definuar nga Edward Burnett Tylor në vëllimin e tij "Primitive Culture" (1871) si: "tërësi komplekse e cila përfshin njohurinë, besimin, artin, moralet, ligjin, traditat dhe aftësitë e shprehita tjera të fituara nga njeriu si një anëtar i shoqërisë". Sipas tij, kultura duhet të studiohet jo vetëm në arritjet artistike dhe shpirtërore të civilizimeve, por në arritjet teknologjike dhe morale të njeriut të bëra nëpër tërë fazat e zhvillimit të tij. Ai gjithashtu ceku se zakonet dhe besimet e lashta duket se kanë jetuar në botën moderne në një njëfarë 'mbijetese'. Kultura është parë si një cilësi e veçantë e njeriut; termi 'simbolizmi' është propozuar si një emër për aftësinë unike mendore të njerëzve, e përbërë nga emërimi i gjërave dhe ngjarjeve me kuptime të caktuara të cilat nuk mund të kapen vetëm me shqisja.

Qëllimi i hershëm i antropologëve ishte që të identifikohen disa trende universale ose tema që do të mund të shiheshin si një infrastrukturë themelore sociale, ku qasje të ndryshme mund t'i caktohen një vendi. Kjo qasje gjithashtu është shoqëruar edhe me teorinë evolucionare, si të Darwin-it. Me një kuptim më të thellë të karakterit dhe natyrës së kulturave të ndryshme, ka pasur një trend në rritje për t'i çmuar dhe gjykuar elementet e një kulture të veçantë në marrëdhënien e tyre me këtë kulturë si tërësi. Për më tepër kjo qasje, nuk e klasifikon një kulturë më superiore apo inferiore sesa një tjetër. Është bërë e zakonore që të njihet specifika dhe diversiteti i kulturave të ndryshme, të gjetura në një zone topografike apo karakteristike për të. Kulturat specifike janë përcaktuar si *sisteme socio-kulturore*, që do të thotë: «Kultura që posedohet nga një grup i veçantë dhe autonom (shoqëria) i qenieve njerëzore, si nga një fis ose një komb modern" (EB). Elementet kulturore mund të kalojnë lirshëm nga një sistem në tjetrin, por ka kufij në mes të sistemeve të ndryshme që e bëjnë atë të mundshëm për t'i studiuar ato në një kohë të caktuar ose në një periudhë të caktuar.

Nocioni i trashëgimisë kulturore është një vend modern, dhe aty ekzistojnë definicione të ndryshme ndërkombëtare të saj. Në *Draft Planin e vet Afatmesëm të vitit 1990-1995* (25 C/4, 1989, f.57), UNESCO e ka definuar atë: "Trashëgimia kulturore mund të definohet si një korpus i tërë i shenjave materiale - ose artistike, ose simbolike – të dorëzuara nga e kaluara për secilën kulturë dhe prandaj

tërë njerëzimit. Si një pjesë përbërëse e afirmimit dhe pasurimin e identiteteve kulturore, si një trashëgimi që i përket tërë njerëzimit, trashëgimia kulturore i jep çdo vendi karakteristikat e tij të njohura dhe është një depo e përvojës njerëzore. Ruajtja dhe prezantimi i trashëgimisë kulturore janë pra një –gurë– themel i secilës politike kulturore.”

Derisa ky definicion më tepër e reflekton një qasje ‘materiale’ ndaj trashëgimisë kulturore. Ekzistojnë disa dokumente të cilat gjithashtu fokusohen në folklor dhe aspektet e paprekshme të trashëgimisë. *Rekomandimi i UNESCO-s për Ruajtjen e Kulturës Tradicionale dhe Folklorit* e vitit (1989) e sheh folklorin apo kulturën tradicionale dhe popullore si “tërësi të krijimeve të bazuara në traditat e një komuniteti kulturor, i shprehur nga një grup ose individë dhe që njihet si refleksion i pritjeve të një Komuniteti deri tani, pas që ato pasqyrojnë identitetin e saj kulturor dhe social; standardet dhe vlerat e saj transmetohen gojarisht, me anë të imitimit ose me mjete tjera. Format e saj janë, midis tjerash, gjuha, letërsia, muzika, vallja, lojërat, mitologjia, ritualet, zakonet, artizanalet, arkitektura dhe artet tjera”.

Karta e ICOMOS-it e Zelandës së Re për Konservimin e Vendeve me Vlerë të Trashëgimisë Kulturore e vitit (1992) e thekson rëndësinë e vendeve që e ofrojnë kontekstin e identitetit të komunitetit dhe që formojnë një dëshmi të dukshme të vazhdimësisë midis së kaluarës, së tashmes dhe të ardhmes. Njohuri e caktuar e vlerave të trashëgimisë i është besuar mbrojtësve të zgjedhur. Në të njëjtën kohë, karta pohon se “normat indigjene të konservimit janë fluide dhe e marrin parasysh vazhdimësinë e jetës dhe nevojat e së tanishmes, si dhe përgjegjësitë e mbrojtësve dhe ndërlidhja me ata që kanë shkuar përpara».

Draft Konventa e UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë së Paprekshme Kulturore (korrik 2003) e jep definicionin e mëposhtëm: “Trashëgimia e Paprekshme Kulturore nënkupton praktikën, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, aftësitë - si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore të lidhura me to – të cilat komunitetet, grupet dhe në disa raste, individët e njohin si pjesë e trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi e paprekshme kulturore, që dorëzohet nga brezi në brez, vazhdimisht është rikrijuar nga komunitetet dhe grupet në përgjigje të mjedisit të tyre, bashkëveprimit të tyre me natyrën dhe historinë e tyre dhe u jep atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, si rrjedhim duke promovuar respekt për diversitetin kulturor dhe krijimtari të njerëzore.”

Çmagjepsja e Perëndimit

Definicionet e mësipërme i tregojnë dy qasje të ndryshme për trashëgiminë kulturore. Ndërsa tani është rritur vëmendja ndaj dimensionit të trashëgimisë së paprekshme, ku bota perëndimore pothuajse është ende e varur nga qasjet pozitiviste dhe materialiste të trashëguara nga e kaluara. Duke rezultuar nga

zhvillimet në mendimin shkencor që nga racionalizmi i Lashtë Grek e deri në mendimin Evropian të shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë, shoqëria e globalizuar aktuale ende mbështetet në perceptimin mekanik të botës. Në veçanti, Pozitivizmi i shekullit të XIX theksoi se të gjitha njohuritë në lidhje me realen janë të bazuar në të dhëna 'pozitive' të përvojës. Jashtë kësaj, është dashur të jetë vetëm logjikë e pastër dhe matematikë e pastër. Pozitivistët refuzuan spekulimet në lidhje me "natyrën e realitetit që shkon përtej çdo prove të mundshme e që mundet ose të mbështesë ose të kundërshtojnë " pretendime të tilla të mrekullueshme të dijes" (EB). Megjithatë duhet të theksohet, se shumë shkencëtarë të mëdhenj e kanë kuptuar se nuk ka asnjë rrugë të drejtë logjike, me anë së cilës mund të lëvizësh nga të dhënat e observimit dhe të arrihet në teori shkencore.

Në fushën e konservimit, qasja materiale është reflektuar në tendencën për ta injoruar ose thjeshtuar teorinë e konservimit. Debati për çështjet e tilla shpesh herë mungon madje edhe në trajnimet e konservimit. Në fillim të shekullit të njëzet, theksi është vendosur mbi 'restaurimin shkencor', bazuar në të dhënat empirike dhe eksperimentet laboratorike, që sigurisht se janë të nevojshme. Ngjashëm, 'parimet' e konservimit janë përdorur për t'i përmbledhur disa përvoja themelore në një formë të lehtë për t'u mësuar, ndërsa është harruar se ka nevojë për një proces më koherent të të menduarit. Pyetjet që iu shtrohen shkencëtarëve duhet domosdoshmërisht të bazohen në një qasje kritike, humaniste dhe në të kuptuarit e rëndësisë relative kulturore dhe kuptimin e burimeve të trashëgimisë. Debati rreth draft konventës për trashëgiminë e përpjekshme i ka dhënë aktualitetit të ri një debati të tillë.

Tomas S. Kuhn (*Struktura e Revolucioneve Shkencore*, 1962/1970), veçse ka eksploruar natyrën e punës shkencore dhe kuptimin e paradigmave që ishin definuar në lidhje me perceptimin mbizotërues. Në fakt, Kuhn theksoi rolin e një kuptim kritik, kulturor në definicionin që janë eksploruar nga shkencëtarët. Në të njëjtën kohë, shumica e dokumenteve ndërkombëtare dhe rekomandimeve janë përqendruar në trashëgiminë kulturore materiale dhe atë të prekshme. Karta e Venedikut e vitit 1964 flet rreth monumenteve dhe siteve, ndërsa Konventa e Trashëgimisë Botërore e vitit 1972 i referohet: monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe siteve. Megjithatë, gjatë dy dekadave të fundit ka pasur tendencë për ta zgjeruar definicionin e trashëgimisë kulturore. Komiteti i Trashëgimisë Botërore e ka prezantuar konceptin e "peizazhit kulturor" dhe shumë site të cilat janë futur në listë më parë në bazë të cilësive të tyre natyrore janë ri-dorëzuar për njohjen e aspekteve të tyre kulturore, si Tongoriro në Zelandën e Re dhe Uluru në Australi. Për këtë arsye ndoshta nuk është çudi pse UNESCO e ka ndërmarrë procesin për ta miratuar Konventën e re për trashëgiminë e përpjekshme në fillim të mijëvjeçarit të ri. Kjo gjithashtu përkon me periudhën kur Drejtori i

Përgjithshëm i UNESCO-s vjen nga Japonia, ku nocioni i ‘thesarit të gjallë kulturor’ veçse është njohur shumë kohë më parë në legjislacionin kombëtar.

Ekspertët e përfshirë në përgatitjen e konventës së re mbi trashëgiminë e paprekshme e kanë theksuar rëndësinë e ndërveprimit midis dimensioneve të prekshme dhe të paprekshme të trashëgimisë kulturore, si dhe për nevojën për ta njohur natyrën e gjallë dhe evoluuese të trashëgimisë së paprekshme kulturore. Ky reflektim domosdoshmërisht do ta prekë vijën kufitare midis Konventës së re dhe Konventës ekzistuese të Trashëgimisë Botërore. Në çfarë rasti një burim i caktuar i trashëgimisë bien brenda juridiksionit të njëjës konventë apo tjetrës?

Hyjnorja dhe shpirtërorja në shoqërinë tradicionale

Ka pyetje të ndryshme të cilat gjithmonë janë menduar nga qeniet njerëzore. Këto përfshijnë çështjes si jeta dhe vdekja. Pyetjet e tilla nuk janë vetëm ‘teorike’, por ato në fakt e kanë kushtëzuar mënyrën e jetës në komunitete të ndryshme, ato kanë qenë të integruara në sistemet socio-kulturore dhe janë reflektuar në përdorimin e tokës dhe në projektimin dhe ndërtimin e vendbanimeve, objektet dhe veglave.

Në botën tradicionale, dikotomia e të **shenjtës kundrejt profanes** e veçon një marrëdhënie të veçantë midis zonave të ndryshme: botëve të kufizuara dhe atyre të përbashkëta. Fjala latine, *sacer* (fillim, i kufizuar) e tregon botën e shenjtë, e cila ka korrelacion me gjuhë të ndryshme, p.sh. *hagios* në greke, *Tapu* në polineziane, *raram* në arabishte, si dhe ‘taboo’ në anglishte. Ajo është e ndërlidhur me fjalën *numen* (‘Zot, fuqi misterioze’), *Brahman* në *sanskritisht*, *mana* në Melanesiane. Gjendja e pastër (e shenjtja), prodhon shëndet, energji, fat dhe pasuri; gjendja e papastër (e përbashkëta), është e karakterizuar me dobësi, sëmundje dhe vdekje. Koncepti i ‘shenjtë’ pra shpreh kuptimin dhe burimin e jetës dhe realitetin e tij të përjetshëm.

Në Romën e lashtë, *sacer* tregonte një zonë e cila ishte e kufizuar dhe e paqasshme për personat jo-anëtarë. Të shenjtë ishin tempujt ose në përgjithësi vendet e kultit dhe vendet e adhurimit të hyjnore. Fushat e tilla mundën të kenë ose jo ndërtime. Shumë kultura kanë ndërtuar objekte të rëndësishme, tempuj apo faltore, të cilat qëndrojnë më lart se pjesa tjetër e vendbanimit njerëzor duke u bërë një ekspozim i krijimtarisë njerëzore dhe një dhurim ndaj hyjnore. Tempujt e tillë apo faltoret e mishërojnë kuptimin e shenjtë të vendit dhe e reflektojnë rëndësinë në paraqitjen e tyre të përgjithshme dhe format e detajeve, qoftë e futur në shkëmb apo e ndërtuar mbi tokë. Në kulturat tjera, mediumi, më saktë, materiali, nuk është konsideruar si thelbësor dhe ndërtimet mund të jenë modeste ose të përkohshme. Në raste të tjera, prapë, nuk ka ndërtime fare. Për shembull, vendet tradicionale Laponiane të kultit kanë mundur të jenë të përbëra nga ndonjë gur, pemë apo burim uji, e cila është lidhur me

një shpirt dhe të cilës Lapët dhuronin për fat të mirë në gjueti ose peshkim. Shpeshherë, krijimet e veçanta natyrore si ujëvarat, vullkanet, apo vendet tjera gjeologjikisht mbresëlënëse i kanë frymëzuar njerëzit që të ndërlihdin cilësi të veçanta shpirtërore apo hyjnore me zona të tilla, siç është rasti i shumë vendeve të Trashëgimisë Botërore.

E shenjta është e ndërlidhur me idenë e të **bërit sakrificë**, e cila rrjedh nga fjala latine *'sacrificium'* (*sacer + facere*, e shenjtë + bëj). Motivët për sakrificë apo dhurimet kanë qenë të shumta. Një formë ka qenë dhurim falënderimi. Kjo ka mundur të bëhet në dhurimin e fryteve të para në shoqëritë bujqësore për hyjnitë e të korrave. Në parim, të korrat mund të konsiderohen të shenjta deri në momentin e sakrificës, e cila 'e zhvesh nga shenjtërimi' atë duke e vënë atë në dispozicion për konsum të përbashkët. Dhurimi i frutave gjithashtu shërben për t'i plotësuar potencat e shenjta të tokës për të siguruar rigjenerimin e të mbjellave. Me rastin e flijimit të gjakut, gjaku i viktimës mund ta lejojë shpirtin e vegetacionit që të rilind dhe të rimbushet. Llojet e tjera të sakrificës mund të bëhen për ta siguruar praninë mirëdashëse të hyjnisë për një ndërtim të ri, për shpirtitrat e të vdekurve me qëllim që të rritet fuqia e të vdekurve në jetën e përtejme, ose për ta forcuar lidhjen midis adhuruesit dhe fuqisë së shenjtë nëpërmjet ushqimeve të shenjta. (EB)

Disa religjione kanë qenë të ndërlidhura me sakrificë, ndërsa disa të tjera jo. Për shembull, në religjionin Hindu bëjnë sakrifica, ndërsa budistët nuk bëjnë. Në rastin e religjionit Zoroastrian, çfarëdo sakrifice e gjakut ka qenë e ndaluar. Në kohët e hershme, zoroastrianët adhuronin jashtë dyerve në një altar zjarri, më vonë tempuj të veçantë të zjarrit u ndërtuan për këtë qëllim. **Zjarri dhe uji** kaherë konsideroheshin si elemente të rëndësishme. Zjarri ka vepruar si një lajmëtar, duke e shndërruar dhuratën në një formë që mund të transferohej tek perënditë. Uji ishte simbol i pjellorisë dhe jetës. Shenjtorja kryesore Zoroastriane, Takht-e Soleyman, në veri të Iranit, është e vendosur në rajonin vullkanik me pusët arteziane, kështu duke i pasur të pranishme të dyja elementet: zjarrin dhe ujit. Rrjedhimisht, vendi e ka një tempull zjarri dhe një tempull për Anahita-n, perëndeshën e tokës dhe pjellshmërisë, të shoqëruar me ujë. I gjithë vendi mund të konsiderohet si një peizazh i shenjtë me ndërlidhje të rëndësishme mitologjike dhe simbolike.

Mbretërimi i shenjtë e ka origjinën e vet në kohët parahistorike. Ky është një koncept fetar dhe politik me të cilin një sundimtar shihet si një personifikim, manifestim, ndërmjetës, ose agjent i të shenjtës apo i shenjtë. Në botën tradicionale, feja ishte e lidhur me tërë ekzistencën e komunitetit. Ishte detyrë e mbretit apo udhëheqësit për ta bërë sakrificën në emër të komunitetit. Të gjitha mbretëritë gjithashtu ishin të lidhura disi me pushtete fetare ose institucione fetare dhe në një farë mënyre të shenjtë. Në Egjiptin e lashtë, faraoni i përfaqëso-

nte disa perëndi. Në Perandorinë Romake, perandori u ndërlidhte me hyjni, por aty u shfaq edhe kulti i perandorit si një proces politik. Territori i një mbretërie kryesisht ishte i lidhur me jetën, sigurinë dhe realitetin; jashtë ishte kaos dhe vdekje.

Hyjnorja gjithashtu është ndërlidhur **me tingujt dhe fjalën**. Fjalët e Perëndisë, mesazhet hyjnore, ishin mësuar përmendësh dhe transferoheshin nga brezi në brez përmes një procesi, i cili kërkonte inicimin, mësimin dhe kalimin e testeve të ndryshme. Me kalimin e kohës, një njohuri e tillë hyjnore u kanonizua duke marrë forma fikse dhe duke formuar një konspekt të teksteve të shenjta. Në kishën e krishterë ky u bë ritual fetar. Fillimisht, një njohuri e tillë e shenjtë nënkuptonte që të flitej me zë të lartë. Edhe pasi që shkrimi u zhvillua dhe tekstet e tilla do të mund të transferoheshin në një formë të shkruar, qëllimi themelor ende ishte për t’i lexuar me zë të lartë. Në shumicën e feve, ritualet kanë qenë të shoqëruara me muzikë e cila vetë është e shenjtë dhe e paprekshme. Në fakt, shkrimi e ka pasur një rol të veçantë në bërjen e mesazheve të padukshme të perëndive të dukshme për të vdekshmit (Herrenschmidt, 1996). Kjo i dha shkrimit dhe leximit veçanërisht një rol të rëndësishëm në mes të hyjnore dhe të paprekshmes. Në këtë kontekst, ne po ashtu mund ta përmendim nevojën për interpretimin e teksteve të shenjta pa gabime. Prandaj, në shekullin e gjashtë para erës sonë, mbretërit Persian zhvilluan një sistem të shkrimit në bazë të shkrimit në trajtë pyke të Mesopotamisë të lashtë, por duke e specifikuar çdo tingull me një shenjë të veçantë, në mënyrë që të shmangej çfarëdo keqinterpretimi.

Dimensioni i paprekshëm në veprën e artit

Veçse në shekullin e nëntëmbëdhjetë, antropologu, Edward Burnett Tylor e ka vërejtur se si zakonet dhe besimet nga e kaluara e largët, primitive duket se ka vazhduar të mbetet prezente edhe në botën moderne. Në lidhje me këtë, ai e paraqiti konceptin e mbijetesës. Clarisse Herrenschmidt, siç u përmend më sipër, ka studiuar rëndësinë e një dimensioni hyjnor në tekstin e shkruar; shenjat e shkruara bëhen një lajmëtar i prekshëm për t’i transferuar mendimet e paprekshme apo idetë në një formë të prekshme. Natyrisht, interpretimi i teksteve është njëra nga subjektet më të favorizuara të filozofisë aktuale.

Duke dhënë një pasqyrë tjetër në këtë pyetje, George Steiner (*Prezencat Reale*, 1989/1991), analizon praninë e krijimtarisë hyjnore dhe njerëzore në art, muzikë dhe letërsi. Ai i bën dallimet midis originalitetit dhe risinë. Kjo e fundit është e lidhur me gazetarinë ku qëllimi është për të sjellë lajme dhe aktualitete. Ndërsa e para, sipas etimologjisë së vet, i referohet një kthim në origjina dhe fillime. Ajo tregon për ‘zanafillën’ dhe për ‘fillimin’. Ai cek se: “Në relacion ekzakt me origjinalitetin e tyre, me forcën e inovacionit shpirtëror-formal, shpikjet estetike janë” arkaike “. Ato e mbajnë në vete pulsën e burimit të largët. ... Mbi të gjitha tjerat,

gjuha është gjenerator dhe lajmëtari i tashmes dhe i nesërme (f. 27) Steiner-i thekson se shpirti hyjnor është gjithmonë i pranishëm në çdo akt kreativ dhe automjeti në gjuhë është kryesisht legjendë (f. 218). Ai thekson se artet janë të rrënjosura në një substancë, qoftë në trup të njeriut, guri apo pigment, por ato nuk ndalen këtu. Në fund të fundit, për Steiner-in, pyetjet rreth esencës në poezi, muzikë apo art janë pyetje teologjike (f. 227).


Filozofi gjerman, Walter Benjamin, duke bërë ekzaminimin e “Vepra e Artit në Epokën e Riprodhimit Mekanik”, përmend se “edhe riprodhimit më të përsosur të një vepre të artit i mungon një element: prania e tij në kohë dhe hapësirë, ekzistenca e tij unike në vendin ku ai ndodhet” (Kap. I, f. 222). Benjamini i referohet autenticitetit të një gjëje si ‘esenca e tërë asaj që është e transmetueshme prej fillimit të vet, duke ia nisur nga kohëzgjatja e vet substanciale e deri në dëshminë e vet dhe historinë që e ka përjetuar. ... dhe ajo që me të vërtetë rrezikohet kur dëshmia historike është e prekur është autoriteti i objektit’ (Kap. II, f. 223). Ai i referohet këtij dimensionit të paprekshëm të veprës së artit me termin “aura”. Aura e veprës së artit e jep atë me cilësinë e vet dhe historinë e vet, duke e bërë atë të veçantë dhe unike. Benjamini i referohet origjinave të asaj që ne sot i konsiderojmë vepër arti në kontekstin e kultit, ku veprat ishin në shërbim të ndonjë rituali.

Një tjetër filozof gjerman, Martin Heidegger, gjithashtu e diskuton origjinën e veprës së artit (1935), duke e përshkruar procesin krijues që e nxjerr një punë të tillë. Ky proces është krejtësisht i bazuar në paraqitjen e së vërtetës, e cila është shprehur në specifikën dhe uniken e punës së artit. Komponentët e veprës së artit jepen në elementet e ‘tokës’ dhe ‘botës’. Njëra i referohet aspektit material, ndërsa tjetra aspektit shpirtëror të saj të paprekshëm, duke qenë të dyja elementet thelbësore për një punë të vërtetë të artit. Për Heidegger-in një vepër arti mund të krahasohet me poezi e cila na kthen prapa në konceptin e tekstit dhe në komponentin hyjnor siç u diskutua nga Steiner ose në nocionin e “auras” të prezantuar nga Benjamini.

Në librin *Shtatë Llambat e Arkitekturës* (1849), John Ruskin iu referohet fjalëve të Biblës dhe ideja se llamba e urtësisë hyjnore duhet ta drejtojë jetën tonë dhe procesin tonë krijues. Në një vepër të arkitekturës një udhëzim i tillë është shprehur në sakrificën që do të bëhet nga ndërtesat, në vërtetësinë të cilën vepra e shpreh dhe në fuqinë me anë të cilës një vepër autentike e shpreh bukurinë dhe jetën. Arkitektura e vërtetë e ka komponentin e kujtesës, e cila kontribuon në madhësinë e saj. Së fundmi, Ruskin e thekson të kuptuarit e rremë të idesë së ‘lirisë’, në vend se të jesh i bindur dhe vigjilent për atë që është trashëguar nga e shenja dhe hyjnorja në të kaluarën.

INVENTORIES

MAPS AND REMOTE SENSING Geographic Information System - GIS



Kapitulli 2

Dokumentimi dhe Hetimi

Parimet Udhëzuese, Mjetet dhe Teknikat për Dokumentim, nga Rand Eppich

Dokumentimi për Trashëgimi Kulturore - Kuptimi dhe komunikimi janë thelbësore në konservimin e trashëgimisë kulturore.

Si ia fillon dikush që ta kuptojë një vend historik? – A është historia, rëndësia, rrethinat dhe forcat që kanë ndikim në të? Çfarë mund të bëjë dikush për ta ruajtur një vend të tillë? Pastaj si të regjistrohet dhe t'iu komunikohet të tjerëve? - Publikut, profesionistëve, financuesve dhe gjeneratave të ardhshme?

Dokumentimi - edhe si folje edhe si emër. Është akt i regjistrimit i këtyre gjërave, si produkt rezultues. Kjo është një metodë për ta bërë një regjistrim të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë ata që janë të përfshirë në konservim dhe për ata që monumenti është i rëndësishëm. Ky është një definicion i gjerë gjithëpërfshirës, por i njëjti i cili përshkruan temën që aplikohet nëpër të gjitha disiplinat e konservimit – filluar nga historiani, arkitekti, urbanisti dhe mësuesi. Jo të gjithë ata që i adresojnë vendet historike e njohin këtë pjesë të punës së tyre si dokumentim, por prapëseprapë ky material është i rëndësishëm. Shënimet e tyre, observimet, vizatimet apo skicat, punët kërkimore, specifikimet teknike dhe imazhet - madje edhe konkluzionet e tyre dhe proceset e punës janë 'modele' që përfaqësojnë vende historike dhe me këtë rast dokumentimin.

Ky artikull do t'ia fillojë me këtë definicion të gjerë për t'iu përgjigjur pyetjeve të shtruara në fillim. Pastaj do ta përshkruajë se si dokumentimi 'zë vend' në procesin e konservimit, të pasuar nga disa Parime Udhëzuese dhe me përzgjedhjen e një metodologjie para se ta fokusojmë temën në disa prej teknikave, veglave dhe teknologjisë në dispozicion. Ai është shkruar për t'i udhëzuar kurset e trajnimit në Kosovë për konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe është përdorur si filozofi në kurse. Ai është bazuar në veprat e mëparshme të shkruara, si dhe në përvojën personale të autorit. Fushëveprimi i këtij artikulli është gjithashtu i gjerë saqë nuk ka hapësirë të mjaftueshme për t'i përshkruar të gjitha aspektet apo shembujt në lidhje me kursin katër-ditor ose të plotësohet tërë materiali i nevojshëm.

PROCESI I KONSERVIMIT

Kur të ndodh ballafaqimi me një monument apo sit, veçanërisht me një të tillë i cili është kompleks, menaxheri ose arkitekti përgjegjës duhet ta pyes veten apo atë - ku t’ia fillojmë? Shumë vende janë tejet të komplikuar dhe me probleme shumëdimensionale, kështu që kjo detyrë mund të jetë ngulfatëse. Këto mund të përmbliidhen nga disa hapa të definuar ndaras, të cilët janë të integruar në Procesin e Konservimit²⁰.

Në përgjithësi Procesi i Konservimit është një cikël i dizajnuar që ta trajtojë konservimin e një vendi të trashëgimisë dhe për ta siguruar jetëgjatësinë e tij, së pari nëpërmjet të kuptuarit të vendit të trashëgimisë, vlerësimit të rëndësisë së tij, projektimit dhe kryerjes së ndonjë ndërhyrjeje e që më në fund pasohet nga vlerësimi dhe mirëmbajtja. Ka shumë versione të ndryshme të këtij procesi, por ideja e përgjithshme është e njëjtë - një proces ciklik i dizajnuar për të siguruar procedurë të përshtatshme të konservimit dhe për të siguruar qëndrueshmëri. Rrallëherë ky cikël vihet në mënyrë të suksesshme në funksion dhe zbrazëtitrat shfaqen, kështu duke çuar në një përkeqësim dhe në një përpjekje për ta ri-fil-luar procesin e konservimit - nganjëherë pas shumë viteve. Për t’ia filluar që ta kuptoni se si dokumentimi mund të ndihmojë, është e nevojshme që ta përcjellim rishikimin e këtij procesi, duke pas në mëndje temën e dokumentimit.

HAPI 1 – Kuptimi i vendit të trashëgimisë. Kjo zakonisht ia fillon me kërkime për ta kuptuar sitin, vlerësimet e mëparshme dhe punët tjera, si dhe çështjet paraprake dhe identifikimi i akterëve. Çfarë është bërë më parë? A ekzistojnë të dhëna? Kush kujdeset për vendin? Kështu që, hapi i parë përfshin mbledhjen e të gjithë dokumentacionit të mëparshëm. Krijimi i një bibliografie është thelbësore jo vetëm për vendin e trashëgimisë, por edhe për kontekstin e tij, historinë dhe veprimet e mëparshme. Gjithashtu është e rëndësishme që në këtë bibliografi të përfshihen materialet dhe çështjet e tjera të gjendjes të cilat mund të jenë të pranishme apo të dyshuara. Gjithashtu është e rëndësishme që kjo bibliografi të shihet si një dokument i gjallë që mund t’i shtohen gjëra, t’i hiqen dhe të formohet nëpërmjet hapave të mëposhtëm. Shumë shpesh bibliografia injorohet apo më keq veprohet në pajtueshmëri me të, vetëm për t’u injoruar më vonë. Ky mund të duket si një proces i shtrenjtë në veçanti për ata që e financojnë konservimin, pasi që koha mund të kalojë pa u dukur se po kryhen punë substanciale. Nëse një arkitekt nuk është ngushtë i njohur me sitin, ashtu siç po bëhet gjithnjë e më shumë e zakonshme në botën e globalizuar, ata duhet t’ia fillojnë me krijimin e një bibliografie, intervistave dhe njohjeve të terrenit. Prandaj hapi tjetër është shumë i rëndësishëm dhe mund të shihet si një “përkim” me hapin

²⁰ Kate Clark – Konservimi i Komunikuar i Trashëgimisë Angleze 2003 – megjithatë, ka shumë modele të tilla

e parë. Intervistat janë më pak të fokusuara në krijimin e bibliografisë. Shumë shpesh mund të zbulohen informacione shumë të vlefshme vetëm duke folur me njerëzit dhe të regjistrimit të njohurive të tyre që kanë për vendin. Kjo përfshin kujdestarët, si dhe arkitektët e qytetit, madje edhe shitësit e afërm të dyqaneve.

Së fundmi, njohja e terrenit duhet të përfshihet. Zakonisht ky është momenti ku shumica e profesionistëve fillojnë t'i injorojnë dy elementet e sipërpërme-ndura. Kjo është një 'pamje' e përgjithshme e sitit - është e rëndësishme që të theksohet se autori nuk e sheh këtë si një inspektim. Inspektimi nënkupton një qasje më të thellë, zvarritje nën ndërtesë dhe në tavan. Kjo shpeshherë mund ta kapërcejë atë reagimin ngulfatës të fillimit: Ku t'ia filloj? Kjo vizitë e parë përfshin shënimet paraprake, skicat dhe fotografitë dhe çfarë është më me rëndësi një plan për ta kryer një inspektim më vonë. Çfarë nevojitet do të hetohet më vonë dhe më në detale.

Nëpërmjet sondazhit të këtyre tri elementeve – bibliografisë - Intervistave dhe njohjes së terrenit mund t'ia fillojë konservimi, përkatësisht dokumentimi. Kur ato pajtohen me njëra-tjetrën, përgjithësisht mund të supozohet se është reale – ndërsa kur ekziston një mospërputhje e madhe, atëherë çështja duhet të hetohet më thellësisht.

Krijimi i një bibliografie dhe intervistat mund të duken si një fillim i ngadalshëm por të domosdoshme, në mënyrë që të mos përsëritet puna, të mos bëhen gabime dhe të kuptohet monumenti. Ky është përdorimi i parë i dokumentimit dhe të kuptuarit - si një proces dhe produkt për ta kuptuar vendin e trashëgimisë.

HAPI 2 - Vlerësoni vendin e trashëgimisë dhe rëndësinë e tij. Zakonisht është pikërisht në këtë hap kur ia fillon definicioni 'tradicional' i dokumentimit. Kjo përfshin sitin dhe sondazhet topografike, fotografimin dokumentues për procedim më të vonshëm dhe një studim më të thellë. Ky hap përfshin krijimin e planeve, seksioneve, ngritjeve, mostrimit të materialit, modeleve 3 dimensionale etj. Të gjitha këto detyra dhe produkte janë të dizajnuara për ta krijuar një pasqyrë dhe për të krijuar produkte në të cilat mund të 'varet'. vlerësimi i kushteve dhe i faktorëve të prishjes. Bazuar në nevojat e sitit, rëndësisë, financimit dhe niveleve tjera të variabileve të dokumentimit - një arsye tjetër për këtë dokumentim është vlerësimi i rëndësisë së vendit të trashëgimisë.

Të kuptuarit e rëndësisë (në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar) së një siti, i udhëzon të gjitha proceset dhe punën e mëtejshme. Nëse një vend i trashëgimisë është me vlerë të rëndësishme lokale, kjo mund t'i drejtojë financimet dhe shpenzimet. Vlerësimi përdor materialin (ose dokumentacionin) që është mbledhur në hapin e parë për të ofruar dëshmi mbështetëse lidhje me rëndësinë.

Këta dy hapat e parë ofrojnë një sasi të konsiderueshme të materialit për komunikim. Vizatimet dhe materialet e zbuluara më herët dhe përshkrimet nga intervistat mund të përdoren për të komunikuar me akterët, anëtarët e publikut dhe më të rëndësishmit klientët apo financuesit. Ai gjithashtu siguron dëshmi të shumta në mbështetjen e vendimeve fillestare, me anë të formës së listave të prioritetit. Ai gjithashtu është i rëndësishëm për ta dokumentuar komunikimin. Kjo mund të ju duket si punë shtesë, por regjistrimi i interesit të njerëzve të cilin ata e kanë në procesin e konservimit dhe leximi nga ta i materialeve të ofruara në hapin e parë, është një ofrues i rëndësishëm i dëshmimeve. Dhe që është më e rëndësishmja, janë dëshmi për t’ua dëshmuar financuesve rëndësinë që të tjerët e kanë në ruajtjen e monumentit. Derisa kjo më së shpeshti realizohet me anë të fotografisë, ai nuk mund të theksohet mjaftueshëm për ta bërë regjistrimin, në numër, apo caktimin e sasisë së interesit që njerëzit e marrin me anë të komunikimit. Ky mund të jetë numri i klikimeve në faqen e internetit, vizita në punime të hapura të konservimit.

Një tjetër formë e komunikimit është në mes të profesionistëve. Rrallëherë gjatë këtyre ditëve ndodh që një arkitekt i vetëm të angazhohet që të punojë në një vend historik nga A deri në ZH. Ai ose ajo duhet të punojë si pjesë e një ekipi të profesionistëve dhe kështu edhe duke komunikuar me këtë ekip. Shpeshherë një ekip i tillë është shumë-disiplinor dhe gjithnjë e më shpesh edhe shumëkombësh. Ky komunikim gjithashtu rrjedh lart - dokumentacioni mbliidhet nga ekipit dhe përdoret për të komunikuar me vendimmarrësin - ose liderin, ose atyre që janë në kontroll të financimit. Udhëheqësi përgjegjës gjithashtu përdor dokumentacionin për të komunikuar me këshilltarët, specialistëve dhe këshilltarëve të jashtëm.

HAPI 3 - Menaxhimi / Trajtimi i Konservimit

Ky hap është aty ku gjendet veprimi - dokumentacioni që ishte krijuar në hapat e parë shfrytëzohet si një mjet për konservim. Arkitekti ose konservuesi duhet të veprojë sipas vendimeve dhe ta bëjë regjistrimin vendimeve të tyre. Në shumë raste, ky është momenti ku shumë profesionistë besojnë se dokumentimi bëhet më pak i nevojshëm. Kjo mund të jetë shumë larg nga e vërteta pasi që dokumentimi duhet të kryhet edhe në këtë hap. Dokumentimi duhet të vazhdojë dhe ta regjistrojë projektin e konservimit në proces, si dhe elementet e zbuluara gjatë punimeve. Projektet e konservimit janë detyra komplekse dhe shpeshherë edhe planet më të mira e ndryshojnë drejtimin gjatë ekzekutimit, për nevojën e dokumentimit të ndryshimeve dhe zbulimeve. Këto përfshijnë ndryshimet në zgjedhje materiale, elemente që gjenden prapa mureve dhe nën themele etj. Dokumentimi gjatë këtij hapi është gjithashtu i rëndësishëm pasi që projektet e konservimit janë procese të gjata dhe shpeshherë personeli ndryshon dhe puna duhet të dorëzohet në mënyrë të informuar.

HAPI 4 - Monitorimi dhe Vlerësimi

Pasi që të kryhet një projekt ai duhet të vlerësohet, jo vetëm për qëllime të përmbushjes së kontratës, por edhe për të siguruar se janë arritur qëllimet e konservimit. Në këtë hap dokumentimi gjithashtu duhet të vazhdojë - për ta vlerësuar ndërhyrjen e konservimit dhe për të siguruar performancë të mirë të konservimit. Shumë herë dokumentimi i kryer në fillim të këtij procesi duhet të krahasohet me dokumentimin në këtë hap. Pjesët finale të këtij hapi të cilat do ta përfundojnë këtë cikël është grumbullimi i tërë dokumentacionit, organizimin e tij dhe duke e krijuar një arkiv. Kjo është për të siguruar që kur cikli t'ia fillojë përsëri, do të ketë të dhëna të mjaftueshme për raundin e ardhshëm të konservimit.

PARIMET UDHËZUESE

Në mënyrë që të përcillet Procesi i Konservimit duhet të ekzistojnë disa parime të cilat udhëheqin dokumentimin dhe ta integrojnë atë në Procesin e Konservimit. Këto Parime Udhëzuese duhet të përdoret në gërshetim me procesin e përshkruar më herët dhe të ndihmohen vendimmarrësit, arkitektët dhe konservatorët që ta zgjedhin nivelin e regjistrimit, metodat dhe në fund, veglat për dokumentim. Derisa ky artikull është vetëm një hyrje e shkurtër, këto parime mund të përmbliidhen më së miri si seri të deklaratave të pasuara nga çështjet esenciale²¹. Seritë e parimeve që udhëzojnë dokumentimin janë:

- Trashëgimia kulturore është një nevojë themelore njerëzore;
- Dokumentacioni është i rëndësishëm për ta komunikuar dhe kuptuar këtë nevojë;
- Strategjitë për krijimin e këtij dokumentacioni janë të nevojshme;
- Informacioni i siguruar është i dobishëm për praktikën e konservimit;
- Përmbajtja e të dhënave: kërkesat e të dhënave duhet të përcaktohen;
- Nivelet e regjistrimit duhet të zgjidhen dhe të përcaktuara;
- Nevojat për të shkurtër/të mesme/të gjatë proceseve të dokumentacionit afat janë të nevojshme.

Duke i ndjekur këto deklaratat themelore, Parimet Udhëzuese mund të përshkruhen më tej si një seri e pyetjeve të njohura si **“pesë pyetjet”** Pse?, Kush?, Çfarë?, Ku? dhe Kur? Kur të vendoset për një strategji ose tentohet që kjo strategji të komunikohet, përgjigjja e këtyre pyetjeve e siguron një kornizë udhëzuese.

21 E adaptuar nga Robin Letellier / Rand Eppich, Parimet Udhëzuese viti 2006, Instituti i Konservimit Getty

Pse? Kjo është njëra nga pyetjet më të thjeshta dhe mund të përgjigjur me atë se dokumentimi është një mjet i dobishëm për zgjidhjen e problemeve të konservimit - ai ofron dëshmi për t’i mbështetur vendimet - madje edhe kur janë marrë ato gabimisht. Por përgjigja më e paqartë është se regjistrimi si një akt, është një proces i fitimit të njohurive, ndërsa e mundëson një kuptim më të thellë të vendit të trashëgimisë dhe kontekstin e tij, si dhe problemet. Kjo gjithashtu shpie në informacion më të mirë dhe informacioni më i mirë shpie tek vendime më të mira të konservimit.

Kush? Përgjigja më e thjeshtë për këtë pyetje janë profesionistët të ngarkuar me detyrën e konservimit. Po aq të rëndësishëm janë vendimmarrësit dhe ata të cilët kanë kontroll mbi buxhetin. Ata shpeshherë përballen me një numër vendimesh, që gjithmonë peshojnë më shumë sesa burimet e tyre të kufizuara - prandaj ata gjithmonë duhet të binden për një projekt të konservimit. Dokumentacioni jep dëshmi për konservimin. Përveç këtyre dy grupeve të rëndësishme, përgjigjet shtesë për pyetjen Kush përfshijnë akterët, menaxherët e sitit, komunitetin lokal, rajonal dhe global – si dhe më esencialin komunitetin turistik.

Çfarë? Derisa kjo pyetje mund të ju duket e thjeshtë, ajo është njëra nga përgjigjet më komplekse në këtë seri. Kjo më së miri mund të konsiderohet duke iu përgjigjur nevojave të konservimit dhe përmes një serie të niveleve. Disa nevoja të konservimit përfshijnë:

- Vlerësim preliminarë dhe i shpejtë në kohërat e fatkeqësive
- Punime të konservimit
- Inventarët
- Menaxhim i vazhdueshëm
- Planet e mbrojtjes
- Menaxhim i rrezikut
- Kërkim dhe hetime
- Monitorim dhe mirëmbajtje afatgjate
- Komunikimi dhe përhapja

Me aq shumë nevoja të ndryshme të konservimit, ato mund të mendohen si tri nivele të regjistrimit: A, B dhe C.

Niveli A është më i thjeshti dhe është një regjistrim paraprak me saktësi të ulët dhe i përshtatshëm për kohët e fatkeqësisë, vlerësim të shpejtë ose si një deri tek një regjistrim më i thellë. Ky nivel mund të përfshijë skica, fotografi dhe incizime të zërit, vegla të shpejta, me kosto të ulët, lehtë për t’i përdorur, lehtë t’i ndarë me të tjerët dhe lehtë për t’i zotëruar, mundësi për t’i proceduar dhe për t’i nxjerrë informacionet më vonë. Pajimet minimale për dokumentim mund të përfshijnë një aparat fotografik, laps dhe letër dhe një tabletë.

Niveli B është një regjistrim paraprak ose një regjistrim dhe dokumentim mesatar. Ai kërkon më shumë kohë, mjete të shumta, jo aq i lehtë për t'u përdorur, specialisti mund të jetë i nevojshëm, nevojiten më shumë trajnime. Ky nivel do të përfshijë imazhe të shumta, distancë-matës laserik dhe një kompjuter portativ (laptop) dhe softuerë të sofistikuar.

Niveli C janë regjistrime të detajuara të saktësisë së lartë. Ky nivel është shumë kohë-konsumues, i shtrenjtë, duke e marrë një pjesë të madhe të buxhetit të konservimit dhe shfrytëzon mjete të specializuara dhe ekspertë. Pritet që ky dokumentim të jetë për vende mjaft të rëndësishme historike, të cilat janë me interes të madh për ata që janë të përfshirë. Ky nivel është shumë i saktë dhe shërben si e dhënë për të ardhmen. Ky mund të përfshijë skanerë laserik, perceptues nga distanca dhe sistemet informative gjeografike.

Këto tri nivele duhet të jenë të balancuara me nevojat për konservim, qëllimin e regjistrimit, saktësinë e dokumentacionit dhe me përdorimin e rezultateve finale. Përdorimi i këtyre tri niveleve gjithmonë ndihmon që të komunikoni me të tjerët që punojnë ose paguajnë për një projekt, rezultatet e pritura, buxhetin dhe kohën e nevojshme.

Ku? Përgjigja e thjeshtë është vetë në vendin e Trashëgimisë; megjithatë kjo shpeshherë mund ta përfshijë një pamje më të gjerë, si dhe nivelin material mikroskopik. Ajo gjithashtu mund ta përfshijë vetëm një pjesë të vendit të trashëgimisë që është identifikuar më parë si në rrezikun më të madh. Shpeshherë shumë vende janë të ndërlidhura përmes historisë, gjeografisë apo materialeve. Pra, ndoshta në një moment do të jetë e nevojshme që të kryhet dokumentimi larg nga vendi specifik i trashëgimisë në fokus.

Kur? Gjithmonë është përgjigja e thjeshtë, e cila është e shoqëruar me një definicion të gjerë të dokumentimit, por kjo rrallëherë është e realizueshme. Udhëzimi më i mirë sa i përket pyetjes: Kur? më shumë në fillim të projektit në mënyrë që ta kuptojmë dhe vlerësojmë vendin e trashëgimisë. Por nuk duhet të harrohet se dokumentimi duhet të vazhdojë gjatë ndërhyrjes së konservimit dhe madje të shtrihet edhe në hapat e fundit, duke përfshirë vlerësimin dhe monitorimin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse një projekt i konservimit shtrihet për periudha të gjata kohore. Përmes këtij dokumentacioni është e mundur që të vlerësohet suksesi i ndërhyrjes dhe monitorimi për t'i përcaktuar nëse është përmbyshur.

Të mbajturit mend e pesë pyetjeve që i përmendëm më lart është e rëndësishme kur të fillohet një projekt dhe përdoren si Parime Udhëzuese. Megjithatë ekziston edhe një PYETJE shtesë... e cila vjen në fund dhe kjo është Si? Përgjigja për këtë pyetje të rëndësishme është përshkruar në seksionin e mëposhtëm, përmes përdorimit të mjeteve, teknikave dhe teknologjive.

VEGLAT, TEKNIKAT DHE TEKNOLOGJITË

Shumëllojshmëria e gjerë e veglave në dispozicion të cilat mund të aplikohen në një vend të trashëgimisë mund të jenë po aq ngulfatëse sa kompleksiteti i vetë vendit të trashëgimisë. Kjo është duke u bërë më komplekse, pasi që rrezja e veprimtimit të teknologjive vazhdon të avancohet. Veglat e tilla shpeshherë ndodh që të mos jenë në domenin e një arkitekti të zakonshëm të konservimit. Në shumë raste ekzistojnë raste të polarizimit të zgjedhjes së këtyre mjeteve. Profesionistët e konservimit ose i duan shumë mundësitë e veglave dhe premtimet e tyre, ose në masë të refuzojnë këto mjete të reja me qëndrimin e ‘ato nuk kanë qenë të nevojshme përpara’. Në të dyja rastet është qasja e gabuar. Në fillim një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të konservimit ishte konsumuar nga dokumentimi – që shpie tek pyetja se pse jemi duke dokumentuar? Për qëllime të veta apo për t’i avancuar veglat? Përgjigja e mëvonshme është po aq devijuar që shpie në refuzimin e veglave dhe duke mos i përjetuar avantazhet që teknologjia e re ka për të ofruar.

Megjithatë, së bashku me procesin e Konservimit dhe Parimet Udhëzuese profesionisti mund ta bëjë një zgjedhje të informuar për vegla, për t’i aplikuar për çështjen e tyre të veçantë të konservimit.

Ndërsa një përshkrim i plotë i secilës vegël është përtej fushëveprimit të këtij artikulli të shkurtër, një përpjekje do të bëhet për kategorizimin e veglave në kategoritë themelore, duke ia filluar nga veglat më të thjeshta dhe më të lira e deri tek veglat më komplekse dhe më të shtrenjta. Jo çdo vegël apo dhe se si ato mund të përdoren mund të mbulohet këtu, pasi që kjo do të rezultonte me një libër, por ekzistojnë burime të shumta në internet falas që i shërbejnë këtij funksioni²².

Sistemet e thjeshta të matjes - Këto sisteme kanë qenë prezente për mijëra vjet dhe përfshijnë matje të thjeshta me shirit, letër dhe laps. Këto duhet të jenë në ‘veglat’ themelore e të gjithë atyre që punojnë në vende të trashëgimisë. Kjo mund të përfshijë matësin e nivelit të ujit, kompase, metër-shirit dhe vizatime ekzistuese dhe harta. Megjithatë, kjo çantë e veglave mund të plotësohet me teknologjitë e reja, por që janë edhe të lira. Njëra prej këtyre teknologjive të lira është distancë-matësi laserik - një pajisje e thjeshtë e cila mat deri në 40 metra, duke dërguar një impuls të dritës dhe duke e regjistruar reflektimin dhe shpejtësinë e dritës për ta përcaktuar distancën.

Fotoaparati - ky duhet të përfshihet në veglat themelore dhe ekziston një parim i mirënjohur ku thuhet “Fotografoje atë që nuk mund ta vizatosh dhe vizatoje

22 http://www.getty.edu/conservation/publications_resources/pdf_publications/recordim.html

atë që nuk mundesh ta fotografosh²³ Ky gjithashtu duhet të jetë pjesë e veglave të profesionistëve dhe të jeni të gatshëm që në mënyrë të shpejt ta regjistroni monumentin. Avancimet gjatë 20 viteve të fundit në fotografimin digjital kanë bërë që ky mjet tani të jetë i domosdoshëm...megjithatë shpeshherë kjo vjen me një çmim të paparashikuar. Mijëra imazhe duhet të menaxhohen dhe të klasifikohen.

Fotografimi i modifikuar ose i përpunuar – fotografia e ndrequr. Shumica e profesionistëve mbështeten në parametrat automatike të kamerave të tyre, vetëm drejtoje aparatin dhe bëje një foto. Me këtë rast duke e përdorur vetëm një pjesë të vogël të potencialit të fotoapararit të tyre. Ata gjithashtu mbështetet në softuerë të thjeshtë të përpunimit dhe as nuk i kombinojnë imazhet e tyre digjitale me mjetet tjera. Me disa procedura të thjeshta shumë më tepër informacione mund të nxjerre me ato mjete të cilat shumica e profesionistëve veçse i kanë në dispozicion. E para është fotografia e ndrequr - ky është një proces i fotografimit të një zone të "rrafshët" apo fasadën e një ndërtese dhe duke e kombinuar këtë imazh deri në pesë matjeve (minimum) përbrenda softuerit. Ky imazh pastaj ndreqet dhe mund të shkallëzohet.

Sondazhi apo topografia - po fillon të bëhet sferë e profesionistit apo specialistit dhe përfshin përdorimin e pajisjeve "total stacion" apo teodoliteve²⁴. Këto janë vegla profesionale të sondazhit të cilat matin distanca dhe kënde horizontale dhe vertikale për ta matur një seri të pikave në një hapësirë 3dimensionale. Këto pika pastaj mund të lidhen së bashku për ta formuar një vizatim ose model të një vendi të trashëgimisë. Këto e bëjnë këtë nëpërmjet kombinimit shumë të saktë të matjeve horizontale dhe vertikale dhe një distancë-matës laserik dhe trigonometria llogaritet brenda një kompjuteri të vogël. Lokacioni i këtij instrumenti është i njohur si pikë stacioni dhe çdo pikë që mund të shihet brenda përafërsisht një kilometri (varësi prej pajisjes) mund të matet. Problemi është kur duhet të bëhen matjet të cilat nuk mund të shihen. Me këtë rast, instrumenti duhet të zhvendoset në një pikë të re stacionuese, duke krijuar një rrjet të stacioneve, së bashku kjo është e njohur si e tërthortë.

Foto-grametri - kjo teknikë (aktualisht duke përdorur programe kompjuterike) është kombinim i fotografisë dhe matjeve 3D zakonisht të bëra me një teodolit. Këto mund të jenë një çift i imazheve ose një seri e imazheve të vetme të njohura si foto-grametria me linja konvergjente. Kjo teknikë e krijon një model 3D të një vendi të trashëgimisë i cili mund të përdoret për shumë qëllime - prej vizatimeve për konservim e deri te publiku apo akterët. Kjo është një shpjegim i thjeshtë i këtij procesi kompleks dhe zakonisht i përket fushë së një eksperti apo specialisti,

23 Antonio Almagro – prezantime të ndryshme

24 <http://www.topconpositioning.com/products/levels-and-theodolites/theodolites>

megjithatë është e rëndësishme që arkitekti ose konservuesi ta dinë këtë pasi shpesh kanë nevojë për t’i blerë shërbimet e ndonjë specialisti.

Skanerët laserik – e kanë konceptin e ngjashëm me teodolitin, por ata regjistrojnë miliona matje për sekondë, kështu duke krijuar miliona pika 3D në hapësirë. Kjo është e njohur si reja e pikës. Kjo e krijon një imazh tre dimensional të vendit të trashëgimisë. Ekzistojnë teknika të ndryshme për t’i lidhur këto pika - nga krijimi i një modeli tre dimensional poligonal deri tek vizatimet tradicionale dy dimensionale, apo edhe duke e përdorur renë e ‘papërpunuar’ të pikës. Zakonisht këto instrumente janë të kombinuara me fotoaparate në mënyrë që modelet ta kenë një cilësi foto-realiste. Ata gjithashtu janë shumë të shtrenjtë diku mbi 40,000€, kështu që vetëm projektet më të mëdha të konservimit mund t’i përdorin ata.

Sistemi Global i Pozicionimit (GPS), perceptues nga distanca (imazhet satelitore) dhe sistemet gjeografike të informacionit, janë mjete që zakonisht përdoren kur vendet e konservimit janë në shkallë territoriale - inventarët, site shumë të mëdha apo qendra të qytetit. Edhe ky subjekt është përtej fushëveprimit të këtij artikullit të shkurtër, por duhet të përmendet pasi që subjekt u përmend shkurtimisht gjatë kursit.

Teknikat integruese - është e rëndësishme të theksohet se asnjë vegël që u përmend shkurtimisht më herët nuk mund të përdoret si e vetme. Të gjitha veglat duhet të integrohen dhe të përdoren së bashku duke i kombinuar avantazhet dhe disavantazhet e tyre, në mënyrë që të përmbushen nevojat e dokumentimit. Sikurse fotoaparati që nuk mund të përdoret i vetëm dhe duhet të përdoret në gërshetim me disa matje të thjeshta, përfshirë skicimin, ndërsa edhe skaneri laserik apo pajisja GPS nuk mund të përdoret e vetëm dhe duhet të integrohet me teknika tjera. Ashtu si për të gjitha mjetet të cilat shkurtimisht u përshkruan, ekzistojnë burime të shumta të cilat i përshkruajnë ato në detaje. Ju lutem referojuni bibliografisë në vijim për më shumë detaje, në faqen e internetit: <http://gcibibs.getty.edu/asp/>. Gjithashtu është përtej fushëveprimit të këtij artikulli që të përshkruhen instrumentet e tjera të dobishme si pajisja për bërjen e imazhit me rreze infra të kuqe, analizat mikroskopike ose laboratorike, etj. Megjithatë këto vegla dhe teknika konsiderohen edhe dokumentim pasi që ato kontribuojnë që një vend i trashëgimisë të kuptohet më mirë.

PËRFUNDIM

Si konkluzion, dokumentimi është çdo regjistrim që e krijon një ‘model’ abstrakt i cili ndihmon në konservimin e një vendi historik - është edhe një folje edhe një emër. Edhe pse ky definicion është shumë i gjerë, ai është shumë i rëndësishëm pasi që ai mund të jetë një mjet i dobishëm për t’ia filluar dhe drejtuar kon-

servimin. Të gjithë hapat në Procesin e Konservimit përmbajnë disa elemente të dokumentimit - nga të kuptuarit e vendeve historike, deri tek vlerësimi i gjendjes së saj dhe rëndësisë, menaxhimin dhe trajtimin e konservimit dhe në fund monitorimi dhe vlerësimi. Në çdo hap një projekt i caktuar dokumentohet dhe krijohen dëshmi për t'i informuar vendimet.

Procesi i Konservimit, së bashku me Parimet Udhëzuese gjithashtu udhëzojnë se çfarë dokumentimi duhet të bëhet. Parimet Udhëzuese mund të mendohen si pyetjetje të pyetjeve të ngritura më herët në këtë artikull - ose të pesë pyetjeve. - Pse? Kush? Çfarë? Ku? Kur? Pra duke e përdorur numrin 5 ato mund të mbahen mend më lehtë dhe të përdoren për t'ua komunikuar dokumentacionin edhe të tjerëve.

Më në fund vjen pyetja e fundit - Si? Ky është momenti kur veglat, teknika dhe teknologjia paraqiten. Përgjigja në këtë pyetje mund të mendohet si një shkallë filluar nga veglat më të thjeshta, me kosto të ulët e deri tek veglat më komplekse dhe të shtrenjta dhe teknikat. Gjithashtu mund të jetë e dobishme të mendohet për tri nivelet e regjistrimit A, B, C ku secila prej tyre ka nevojë për punë, ekspertizë dhe shpenzime. Ky artikull i shkurtër është i pamjaftueshëm për t'i përshkruar të gjitha veglat, teknikat dhe teknologjitë në dispozicion për ata që punojnë në konservimin e vendeve të trashëgimisë, megjithatë është bërë një përpjekje për t'i përmendur shkurtimisht veglat më të qasshme dhe më të përballueshme financiarisht, në kombinim me parimet dhe një proces të caktuar.

Kjo ishte metoda për programin e trajnimit dhe kampin e konservimit në Kosovë... dhe si ky artikull, programi i trajnimit u mbajt vetëm gjatë një periudhe tre apo katër ditore. Edhe kësaj here ishte e pamjaftueshme që pjesëmarrësve t'ju tregohet çdo vegël në dispozicion, por atyre iu është dhënë një vështrim i përgjithshëm duke i përdorur të tria këto metoda. Gjatë arsimimit të tyre të vazhdueshëm, ata tani kanë bazën që vetë të hetojnë më tej dhe lidhjen për të bërë pyetje shtesë.

Duke i përdorur të tria këto metoda - Procesi i Konservimit, Parimet Udhëzuese dhe njohurinë për këto Vegla, Teknikat dhe Teknologjitë, mund të dizajnohet dhe implementohet një program i suksesshëm i dokumentimit - një program që mund të ndihmojë dhe informojë për konservim të mirë.

RE-ORG



<http://www.re-org.info> Collections Unit

Dokumentacioni për zhvillimin e Planit të Konservimit, nga Alessandro Pergoli Campanelli

Si të hetohen materialet dhe teknikat për restaurim?

Analiza e dëmtimit të strukturave të muratorisë

Studimi dhe konservimi i trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike ndahet në tri faza: e para është inspektimi, e dyta është analiza kritike dhe historike, e fundit është projekti i restaurimit. Faza e parë është shumë e rëndësishme dhe përbëhet nga inspektimi i drejtpërdrejtë i strukturave ekzistuese. Ai e përbën hapin e parë drejt njohjes së gjendjes arkitektonike e cila do të studiohet në karakteristikat e veta leksikore dhe në stratigrafinë komplekse. Një aspekt i rëndësishëm që duhet të ekzaminohet në thellësi për t'i kuptuar arkitekturat është studimi dhe analizi i muratorive, duke i klasifikuar shtresimet komplekse në një seri tabelash në mënyrë që të sigurohet kronologjia e saj. Analiza fillon me identifikimin e materialit që realisht e përbën muratorinë. Përfaqësimet specifike grafike priten në leximin strukturor dhe në përshkrimet e përgjithshme sistematike të të çarave të pranishme, të ilustruara me vëmendje për kuptueshmëri grafike. Është e rëndësishme që përfaqësimet grafike të bëhen me kujdes të veçantë në normalizimin e përfaqësimit me konventat përkatëse, të cilat janë kodifikuar në leksikonin *Normal*. Në bazë të sondazhit arkitektonik dhe përmes inspektimeve (monitorimeve dhe testimeve) tipologjitë dhe çrregullimet e ndryshme të cilat identifikohen në sipërfaqen e muratorisë të inspektohen dhe të raportohen grafikisht.

Studimi specifik i strukturave të muratorisë së pari duhet të adresojë: ndërtesa duhet të hetohet, pavarësisht mosdashjes së saj për të na dhënë informacione (shpeshherë elementet strukturore janë të fshehura nga syri, shkak i shtresës së sipërme), edhe në aspektet e ndërtimit, ndërsa më pak nga ndërtimi origjinal, të dyja i nënshtrohen ndryshimeve, si rezultat i rregullimeve të njëpasnjëshme funksionale të ciklit të jetës dhe madje edhe më vonë (ka të bëjë me sitet arkeologjike), me rezultatet e ngjarjeve dramatike (p.sh. tërmetet) për çfarëdo mangësie indigjene.

Për ruajtjen, konservimin dhe restaurimin e ndërtesave historike, zakonisht pyetje të shpeshta shfaqen për strukturën e brendshme. Në përgjithësi, kjo strukturë është shumë komplekse dhe shpeshherë e shtresuar në vite të ndryshme. Informacioni është i nevojshëm në gjeometri (madhësia, zbrazëtirat, trashësia), pozita e të shtuarave (spirancat, kunjat, shufrat e drurit dhe të metalit, tubat) dhe rreth llojit dhe madhësisë së dëmeve ekzistuese.

Në të kaluarën, observimi i drejtpërdrejtë i ndërtimit ishte i bazuar kryesisht në njohjen e relacioneve gjeometrike dhe elementeve konstruktive dhe në manifestimet e përjetimeve. Megjithatë, sikur edhe në shëndetësi, ku shpeshherë përdoret një gamë e gjerë e analizave klinike edhe në ndërtesa mund të bëhen lloje të ndryshme të testeve, shpesh të marra nga fusha tjera shkencore dhe të përshtatura për nevojat e veçanta të muratorisë historike. Testet mund të ndahet në “monitorimin”, “testet jo-destruktive” (TjD) dhe “testet paksa destruktive” (TpD). Secili aplikim i metodave të përzgjedhura i ka limitet e veta. Asnjë metodë e vetme testuese nuk është e zbatueshme për të gjitha kushtet apo të gjitha llojet e ndërtimit: nganjëherë disa metoda të kombinuara me testimin e zgjedhur destruktiv janë të nevojshme për ta vlerësuar një problem.

Monitorimi Instrumental:

Diagnoza e gjendjes së dëmtimit në ndërtesa historike mund të kryhet vetëm nëse është në dispozicion një njohuri e thellë për materialet dhe strukturat. Inspektimi vizual, studimi gjeometrik dhe sondazhi i modelit të plasaritjes, sondazhi i sipërfaqes së prishur, të gjitha këto janë të nevojshme për t’i kuptuar dëmet dhe shkaktarët e tyre dhe për ta kryer një interpretim të parë të këtij fenomeni. Në vijim janë paraqitur metodat kryesore të hetimit dhe monitorimit të muratorisë.

Observimi Vizual

Kjo është mënyra më e përdorur dhe më efektive për vlerësimin jo-destruktiv. Observimi zakonisht kryhet në mënyrë vizuale, në formë të inspektimeve, ose nëpërmjet përdorimit të përditshëm dhe ekspozimit. Këto vlerësime të vazhdueshme vizuale të një strukture janë jetike për mirëmbajtjen parandaluese. Mirëmbajtja parandaluese vazhdimisht e riparon një strukturë, kështu duke e zgjatur jetën e saj dhe ndoshta edhe duke parandaluar grumbullimin e problemeve, që në të ardhmen do të kërkonin riparime të mëdha dhe të shtrenjta. Një formë tjetër e observimit të thjeshtë si vlerësim jo-destruktiv është përdorimi i tingujve. Mënyra se si tingulli udhëton përmes një materiali mund ta jap një pikëpamje për kushtet e brendshme. Tingujt përdoren në mur për t’i lokalizuar celulat me llaç dhe ato të zbrazura (shkoqje, plasaritje, ndarje). Tingulli kërkon një ndjenjë të mprehtë të dëgjimit për t’i dalluar celulat me llaç dhe ato pa llaç. Kështu që nëse një vesh është i trajnuar mirë, tingulli mund të jetë shumë i saktë.

Sondazhi optik i precizitetit

Me përdorimin e një teodoliti si sistem të pozicionimit do të përcaktohej çfarëdo vithisje apo zhvendosje e ndërtimit, duke e monitoruar pozicionin e pikave të

përzgjedhura si të rëndësishme në një periudhë të caktuar kohore. Me përdorimin e objektivave të veçantë, instrumenti na ofron saktësi prej mikronëve (± 1 mm). Për ta lehtësuar leximin dhe interpretimin e të dhënave ato përkthehen në grafik për ta treguar evolucionin e këtij fenomeni.

Testi i lagështisë

Ekzistojnë lloje të ndryshme të matësve për testimin e lagështisë: një sensor i përçueshmërisë që tregon lagështinë 'relative' në sipërfaqe; një sensor jopërçues që tregon lagështinë 'relative' deri në 4 cm prej sipërfaqes, apo një sensor mikrovalë i cili tregon lagështinë 'relative' deri në 4 cm nga sipërfaqja. Vendosni gjilpërat lehtësisht nëpër sipërfaqen e mureve duke i vendosur si në formë të një rrjeti dhe shënoni leximet. Bëni vizatimet me gradë për ta kuptuar shkallën e problemit. Duke bashkuar pikën me të njëjtën vlerë është e mundur që të bëhet një diagram për përcaktimin e lagështisë në këto sipërfaqe. Merrni leximet nga një zonë e paprekur nga e njëjta dhomë për ta parë se cili lexim është 'normal' për atë ndërtesë në atë kohë të vitit. Sondazhi me rreze infra-të-kuqe, me anë të pistoletës për mure me rreze infra-të-kuqe të temperaturës (drejtoje dhe shtype) ose me matës termik-vakumi, ku ata funksionojnë duke e ndjerë efektin ftohës në një filament të nxehtë të gazrave në sistemin vakum. Vendosni matësit në sipërfaqe në formën më të përshtatshme, ose në vrimat më të vogla në trashësinë e muratorisë për ta matur temperaturën.

Matësi mekanik dhe elektrik i tendosjes

Monitorimi i ndryshimeve në gjerësinë e plasaritjes ndihmon në përcaktimin e shkaktit të plasaritjes dhe pastaj të vendoset se çfarë pune riparuese duhet të specifikohet. Një tregues i thjeshtë i kalibruar "*Tell Tale*" mund të tregojë lëvizjet eventuale horizontale ose vertikale përgjatë plasaritjes në një sipërfaqe të rrafshët. Llojet e thjeshta mekanike përdoren shpesh në inxhinierinë civile për t'i matur lëvizjet e objekteve, bazamentet dhe strukturat tjera. Në shembullin e ilustruar, dy gjysmat e pajisjes bashkëngjiten fort për muri në të dyja anët e kundërta të plasaritjes. Linjat e kuqe të referencës janë në gjysmën transparente dhe rrjeti është në gjysmën e patejdukshme me ngjyrë të bardhë. Edhe lëvizja vertikale edhe horizontale mund të monitorohet me kalimin e kohës.

Gjithashtu është edhe matësi elektrik i tendosjes. Ai përbëhet nga një tel i hollë metalik (ose rrjet) i cili vendoset shumë fortë në mbështetjen e muratorisë. Filamentet janë përçues që pas deformimeve të sipërfaqes, në të cilën ata janë të ngjitur, duke u zgjatur dhe shkurtuar së bashku me të, e modifikojnë seksionin e vet si dhe rezistencën ndaj kalimit të rrymës elektrike. Duke i matur këto ndryshime nëpërmjet qarqeve të duhura, është e mundur që të përcaktohet shkalla e deformimit të shkaktuar. Në këtë mënyrë, është e mundur që të matet gjendja

e ndryshimit të tensionit në trup, në të cilin instrumenti ishte çiftëzuar fort me ngjitës të shpejtë.

Matësi i pjerrësisë së murit

Ky matës përdoret për t’i monitoruar ndryshimet e rrezikshme të pjerrësive të ndërtesave. Pajisja është formuar nga një bazë mbështetëse horizontale me një krah fleksibil mbi të cilin është i montuar një nivel sferik. Ndërsa, nevojitet një sipërfaqe horizontale e madhësisë së mjaftueshme për ta vendosur dhe riaktivizuar instrumentin. Mund të mbahen në opera, për matje të vazhdueshme, ose të vendoset në pajisje të veçanta për t’u montuar. Monitorimi i pjerrësisë dhe rreshtqitjeve të tokës për t’i detektuar zonat e lëvizjes dhe për ta kuptuar nëse lëvizja është konstante, duke përshpejtuar, apo duke reaguuar ndaj masave të riparimit. Monitorimin e diafragmës së mureve për ta verifikuar se devijimi është brenda kufijve të sigurisë dhe se ndërtesat nuk janë prekur nga lëvizjet e tokës. Monitorimin se strukturat nuk janë dëmtuar nga lëvizjet e tokës. Gjithashtu mund të përdoren për matjen e rotacionit të elementeve strukturore, përmes kontrollit të ndryshimit në kënd.

Sistemi vetë-nivelues

Ai përdoret për ta kontrolluar horizontalen dhe vertikalen e rrafshëve. Ai është sferik dhe ju ndihmon që ta përcaktoni pjerrësinë e një sipërfaqeje me një referencë horizontale të rrafshët, sipas parimit të fizikës një fluskë ajri kur gjendet në një lëng (eter ose alkool) gjithmonë është e pozicionuar duke e treguar zenitin.

Plumbçi (i drejt ose i përmbysur)

Lavjerrësi i përmbysur, i përbërë nga një rezervuar të ujit, një balast, një pluskues, tel dhe një spirancë, veçanërisht tregon për kontrollin e rotacioneve të një strukture në lidhje të një pike të thellë e cila është e fiksuar në tokë, në të cilën është e vendosur spiranca. Posa të përgatitet për matje, ai do të jetë i mjaftueshëm për ta arritur pjesën e shfaqur të panelit të instrumentit.

Matësi i pjerrësisë në tub vertikal

Ai përbëhet nga dy binarë drejtkëndor të futur në integralin e një tubi me vrimë vertikale të përshkuar në tokë. Instrumenti matës futet në intervale të paracaktuara dhe e bën matjen e një thellësie të caktuar, ku matet devijimi nga konfigurimi i parë. Instrumenti është në gjendje që ta përcaktojë, duke matur variacionin këndor të një vije (pothuajse vertikale) duke e marrë si referencë zhvendosjen relative në të dyja drejtimet horizontale. Është e mundur që ta monitorojë çfarëdo lëvizjeje të sistemit të bazamentit të një ndërtese.

Piezometri

Piezometrat përdoren për t'i monitoruar nivelet piezometrike të ujit. Ai mund të jetë shumë i rëndësishëm në studimin e stabilitetit të një ndërtese historike, sepse duke e matur presionin në tokë me depërtueshmërinë e lartë dhe të mesme, ne mund ta lejojmë kontrollin e evolucionit të ujërave nëntokësore dhe relacioneve të tij dhe pranisë së vithisjeve të ndryshme në sistemin e bazamentit. Piezometri në tub vertikal është lloji më i thjeshtë prej llojeve të piezometrave. Ai përbëhet nga një cep me filtër i cili bashkohet me një tub vertikal të ndërtesës. Uji rrjedh nga toka përreth për në tubin vertikal. Leximet sigurohen nga një tregues i nivelit të ujit.

Matësi i deformimit

Ai është i projektuar për ta matur ose monitoruar zgjerimin ose tkurrjet midis dy pikave. Ne mund ta përdorim për matjen e lëvizjeve relative përreth mos-vazhdimësisë së muratorisë.

Ekziston edhe një lloj tjetër i testeve për karakterizimin e muratorisë historike: Testimet jo Destructive (TjD) *In situ*. Ky është një grup i gjerë i teknikave të analizës që përdoren në shkencë dhe industri për t'i vlerësuar vetitë e një materiali, komponenti apo sistemi, pa shkaktuar dëme fare. Përveç përmirësimit të metodave radiologjike dhe akustike, shumë metoda dhe sensorë të tjerë të TjD janë duke u zhvilluar, hetuar dhe aplikuar. Arsyeja pse testimet jo-destruktive quhen kështu është se ato nuk e dëmtojnë teksturën historike. Nëse teknikat jo-destruktive nuk janë të mjaftueshme për ta zgjidhur një çështje të rëndësishme, mund të hapen "dritare" të vogla në teksturën e sipërfaqes, në vende të caktuara, për të parë nën sipërfaqe. Restaurimi mund të bëhet në trashëgiminë e ndërtuar historiko-arkitektonike duke pasur njohuritë më të mira të kualifikimit arkitektonik, tipologjik dhe mekanik të monumenteve. Në mënyrë që efekti destruktiv të jetë minimal, janë të nevojshme studime paraprake diagnostike për intervenime, pasi që një gjë e tillë është e mundur. Përdorimi i teknikave diagnostike jo destruktive dhe jo-ndërhyrëse ka shumë avantazhe për kryerjen e aktiviteteve në ndërtesat para-ekzistuese, në aspektin e qëndrueshmërisë; për më tepër, është një nevojë që ka të bëjë me konservimin me rastin e veprimit mbi trashëgiminë historiko-arkitekturore. Testet më të përdorura janë:

Inspektimet tingullore dhe ultratingullore

Testimi tingullor dhe ultratingullor funksion në mënyrë të ngjashme me radarin, përveç se përdor valët e tingullit në vend të rrezatimit. Përhapja e valëve të tingullit nëpërmjet materialeve të ngurta ndryshon me rastin e kalimit nëpër zbrazëtira dhe pangjashmëri të materialit. Pajisjet për kryerjen e testeve të tin-


gullit përbëhen nga çekiçi i impulsit, i cili përdoret për t'i iniciuar valët e presionit dhe një akselerator-matës piezoelektrik për t'i matur vibracionet e murit që rezultojnë nga përhapja e valëve. Testet e tingullit përdoren gjerësisht për t'i inspektuar materialet të cilat paraqesin karakteristika të ulëta të përhapjes, materiale jo-kompakte dhe heterogjene.

Nëse kryhen në seksionet e njëjta të murit para dhe pas një ndërhyrjes së konsolidimit (p.sh. injektimet e llaçit), ato e mundësojnë vlerësimin e ndryshimit në konsistencë para dhe pas riparimeve, më saktë, ato mund të përdoren për ta kontrolluar efektivitetin e ndërhyrjes. Kompleksiteti i analizës nënkupton kosto të lartë por ta kompensuar nga mungesa e çrregullimit. Përdorimi i TJD dhe TpD plotësuese si sondazhet, inspektimet e drejtpërdrejta, hetimet me fibroskop, etj, janë të nevojshme.

Termografia

Imazhet termike ose termografët janë në fakt paraqitje vizuale të sasisë së energjisë infra të kuqe (IK) që emetohet, transmetohet dhe reflektohet nga një objekt. Termografia statike (pasive) është e bazuar në matjet e temperaturës me përdorimin e rrezatimit të objekteve të hetuara. Termografia dinamike (aktive) është një metodë ku energjia dërgohet në një objekt në mënyrë dinamike (periodike ose me një të gjuajtur). Energjia e lartë e llambave IK mund të përdoret si burim i energjisë. Duke e ditur temperaturën, shpërndarjen e faktorit të rrezatimit, ajo mund të përdoret për karakterizimin e sipërfaqeve të objekteve. Nxehtësia depërton nëpër trupin e hetuar dhe shpërndarja e temperaturës së sipërfaqes fuqimisht varet nga vetitë termike të shtresave të brendshme. Defektet në materialet e ngurta (çarjet) mundën lehtë të modelohen duke përdorur rekuizita të ndryshme lokale termike në trupin e hetuar. Kërkon praninë e energjisë rrezatuese që buron nga trupi nën ekzaminim si ngrohja dhe në disa raste, një para-nxehje e mureve që do të analizohen (ndjeshmëria e pajisjeve të brezit të fundit ua mundëson që ta kufizoni shumë këtë eventualitet). Kostoja e kufizuar, mungesa e çrregullimit dhe lehtësia relative e implementimit e lejon një adoptim të vazhduar edhe nëse rezultati është vetëm kryesisht cilësor. Një burim i nxehtësisë i jep materialit të inspektuar një ngacmim termik. Pasi që zhvillimi i temperaturës në sipërfaqe të regjistrohët për një periudhë të caktuar kohore me një kamerë infra të kuqe, ndërsa një analizë matematikore aplikohët mbi të dhënat e fituara. Atëherë, nëse të dhënat e përpunuara shfaqen si një imazh, atëherë ky imazh do të na jep informacione rreth strukturës së brendshme të materialit ose rreth defekteve të mundshme në të. Që prej viteve të 70'ta, termografia është aplikuar me sukses për konservimin e monumenteve. Fillimisht, ajo përdorej për piktura dhe monumente arkitektonike, kryesisht për vlerësimin e parametrave të mikroklimave përfshirë lagështinë e mureve. Imazhet infra të kuqe japin një pasqyrë për kushtet e brendshme të një materiali. Imazhet infra

të kuqe përdoren në testimet jo-destruktive duke i matur diferencat në kapacitetin e nxehtësisë. Imazhet infra të kuqe mund të bëhen në mënyrë pasive duke i kapur imazhet menjëherë pasi që ato ta thithin rrezatimin diellor në mëngjes, ose menjëherë pasi që ato të jenë të hijezuara në mbrëmje. Gjithashtu është e mundur edhe ftohja apo nxehja e njëres anë të murit. Burimet termale mund të përfshijnë diellin (energjinë solare) ose një burim artificial të nxehtësisë, si një nxehëse ose llambë e nxehjes. Kushtet optimale për testimin e IRT ndodhin kur ekziston një kombinim i të dyjave, si testimi i një ndërtesë me ajër të kondicionuar në verë në një ditë të nxehtë me diell. Në këtë shembull, sipërfaqet e jashtme të murit janë të ekspozuara ndaj energjisë diellore dhe zhvillojnë temperatura të larta të jashtme, ndërsa sipërfaqet e brendshme të murit janë të ekspozuara ndaj temperaturave të ulëta shkakut i ajrit të kondicionuar. Imazhi termograf kështu do t'i shfaqte celulat boshe si të nxehta (pasi që ato e emetojnë energjinë termike) dhe celulat e ngurta të mbushura me llaç si të ftohta (pasi që energjia transferohet përmes murit).



GPR (radari kontrollues tokësor)

Hetimet me radar janë të bazuara në përhapjen e impulseve të shkurtra elektromagnetike të cilat transmetohen në materialin e ndërtesës duke përdorur një antenë dy polare. Impulset reflektohen në ndërfaqet midis materialeve me veti të ndryshme jopërçuese, më saktë, sipërfaqja dhe ana e pasme e mureve, ndarjet, boshllëqet, shtesat metalike etj. Kur antenat e transmetimit dhe të pranimit, të cilat shpeshherë gjenden në të njëjtën strehim, që lëvizin anash mbi sipërfaqen e objektit nën hetim, gjenerohen radargramët (me shkallë intensiteti të ngjyrës gri shfaqen mbi pozicionin e antenës dhe kohës së udhëtimit të impulsit). Për ta shuar ose rritur reflektimin nga shufrat metalike, më saktë spirancat metalike ose kolonat, duhet të merret parasysh polarizimi i fushës së rrezatuar elektromagnetike. Rrafshi i polarizimit i një vale elektromagnetike definohet nga drejtimi në të cilin vektori i fushës elektrike është i radhitur gjatë kalimit të valës. Inspektimi është i bazuar në lirimim e pulseve dhe në pranimin e sinjalit të kthyer; rrjedhja e energjisë elektromagnetike ndryshohet nga objektet në të cilat haset (pak a shumë të përshkueshme, ose që reflektojnë sinjalin) dhe analizat e jehonave kthyese, të kthyer nga një imazh grafik (radargrami) të seksionit të sheshtë të mediumit të rrezatuar, ua mundëson që ta karakterizoni, të paktën përafërsisht. Kërkoni për elemente të fshehura strukturore (veçanërisht të efektshme në eksplorimin arkeologjik, gjithashtu mund të përdoret në studimin e teksturës së muratorisë dhe bazamenteve masive). Identifikimin e teksturës së muratorisë, pajisjeve metalike, defekteve dhe dëmtimeve të fshehura. Për hetimin e strukturës së brendshme komplekse të ndërtesave historike, aplikimi i radarëve është rritur gjatë dhjetë viteve të fundit. Megjithëse muratoria historike në përgjithësi është shumë pak homogjene dhe megjithëse në disa raste ndodh absorbim i lartë për shkak të lagështisë së rritur, radari me sukses është aplikuar për të siguruar informacione për gjeometrinë, pozitën e përfshirjeve dhe për llojin dhe madhësinë e dëmeve ekzistuese.

Vështirësitë në interpretimin e të dhënave, nganjëherë të shkaktuara nga çrregullimet e sinjalit elektromagnetik, nganjëherë për shkak të vështirësisë së njohjes së elementeve ndërtimore në procedimin grafik. Ai ka nevojë që ta bëjë paracaktimin e nivelit të inspektimit dhe distancën që duhet të kalibrohet me emetimin e sinjalit. Radari përdoret për ta gjetur vendndodhjen e shufrës së çeliktë përbrenda murit. Njësitë e radarit përdorin një impuls të rrezatimit të emetuar në një material dhe koha e kthimit të tij dhe forca për ta matur distancën me variacionet e përçueshmërisë dielektrike. Fuqia dhe koha e kthimit varen nga madhësia e diferencës së përçueshmërisë dielektrike dhe thellësia e anomalisë. Rezultatet e radarit janë më të komplikuar për tu lexuar dhe kërkojnë që lexuesi të jetë i trajnuar, nëse synohet që ato të përdoren si duhet.

Tomografia

Përveç matjes së drejtpërdrejtë (përmes trashësisë së murit) dhe indirekte (në të njëjtën faqe të murit) të shpejtësisë së valëve të zërit midis dy pikave, është e mundur që të thellohen analizat duke kryer tomografitë e zërit.

Në këtë lloj testimi, masat e shpejtësisë së impulseve të zërit janë të kombinuara përgjatë shtigjeve të ndryshme të rrezatimit, në një seksion të tërthortë të muratorisë dhe pastaj përpunohen, në mënyrë që të përcaktohen vlerat mesatare të shpejtësisë për çdo pjesë të murit. Gjithashtu është e mundur që të kryhen tomografi të amplitudës të seksioneve të murit. Me anë të tomografive të zërit është e mundur që të detektohet morfologjia e brendshme e elementeve strukture. Ato e mundësojnë identifikimin e shtresave të mundshme të seksioneve (fletë të shumëfishta të karakterizuara me përbërje të ndryshme), praninë e boshllëqeve, prishjet dhe anomalitë e përgjithshme në dendësi. Nëse kryhet në të njëjtin seksion të murit para dhe pas ndërhyrjes së konsolidimit (p.sh. injektimi i llaçit), ato e lejojnë vlerësimin e diferencës në konsistencë para dhe pas riparimeve, më saktë, mund të përdoren për ta kontrolluar efektivitetin e ndërhyrjes. Një kufizim për aplikim të gjerë të metodës në një ndërtesë të vetme rrjedh nga fakti se testet e zërit ende marrin shumë kohë. Në studimet e rasteve të vërteta, është e këshillueshme që të aplikohen testet e tjera jo-destruktive apo paksa destruktive, për t'i verifikuar rezultatet cilësore të testeve të zërit. Për shkak të frekuencë së ulët të përdorur, rezolucioni i metodës është i kufizuar dhe nuk ishte e mundur që të detektohet në detaje morfologjia e zonave të testuara. Megjithatë, tomografitë e zërit dhanë një përshkrim të përgjithshëm të zonave me shpejtësi të ulët dhe detektuan praninë e seksioneve të shumta në muratori. Seksioni i hetuar i muratorisë është i ndarë në piksele katrore dhe rindërtimi tomografik e jep një vlerë mesatare të shpejtësisë së zërit për secilin pjesë të këtij muri. Dimensioni i vrimës është rreth 20 cm dhe varet nga frekuenca e valëve përhapëse të presionit. Prandaj, frekuenca e valëve, ka ndikim në saktësinë e metodës dhe duhet të kontrollohet menjëherë, në mënyrë që të përmirësohet rezolucioni i testeve. Tomografitë e zërit të aplikuara para dhe pas injektimeve të llaçit ishin në gjendje që ta detektojnë ndryshimin në qëndrueshmërinë e muratorisë. Efekti i injektimeve të llaçit, sa i përket homogjenizimit të kushteve të murit është zbuluar qartë.

Matësi i Mbulesës

Një matës i mbulesës është një instrument për gjetjen e shufrave të metalta dhe për ta matur saktë trashësinë e mbulesës së betonit. Detektorët e shufrave të metalta janë pajisjet më pak të sofistikuara të cilat mund të lokalizojnë vetëm objektet metalike të cilat gjenden në sipërfaqe. Për shkak të dizajnit kosto-efektiv,

metoda e puls-induksionit është njëra nga zgjidhjet më të përdorura. Detektorët modern të shufrave të metalta përdorin aranzhime të ndryshme të spiraleve për t’i gjeneruar disa fusha magnetike. Procedimi i avancuar i sinjalit e mbështet lokalizimin e tërë strukturës metalike. Kjo metodë nuk ndikohet fare nga materialet jo-përçuese, si betoni muri, tullat, etj. Ajo kryhet para përdorimit të turjelës për t’iu shmangur shufrës së metaltë. Disavantazhi i saj është se ka një sasi të kufizuar të detektimit dhe hapësira minimale e shufrave varet nga thellësitë e mbulesës.

Testi Ngarkues

Kjo metodë testuese mbulon procedurat e dizajnuara për vlerësimin e kapacitetit statik të një segmenti tipik të një membrane të strukturuar sipas kushteve të simuluar të ngarkimit, si dhe për ta përcaktuar ngurtësinë e ndërtimit dhe lidhjeve të tij. Ngarkesa mund të arrihet me material të peshës së njohur (për shembull me thasë të çimentos ose kontenierë të ujit), ose duke siguruar një veprim për kontrast me struktura të ngurtësisë së përshtatshme. I marrë kryesisht në fazën e testimit të strukturave, ajo shpeshherë në mënyrë eksperimentale përdoret për ta përcaktuar kapacitetin mbajtës të strukturave ekzistuese dhe nuk përcaktohet ndryshe me anë të aftësisë së tyre strukturore. Në testimin e punës së kryer kryesisht ndodh që të ndikohen strukturat horizontale, qofshin të reja ose të konsoliduara, si dhe strukturat e themeleve, shpesh të një përcaktimi të pasigurt. Përhapja e gjerë dhe mungesa e konsiderueshme e trazimit në strukturën finale nuk do ta lejojë që përdorimi të jetë i kufizuar, në mënyrë që të zvogëlohet kostoja në minimum, strukturat e rrezikut më të madh apo më të rëndësishme. Pajisjet e nevojshme nuk janë të ndaluara, por është më e vulltshme që të posedohet një përvojë e caktuar në përdorimin e tyre. Këto aftësi dhe përvoja janë të një rëndësie të veçantë në rastet e rrezikut dhe veçoritë e strukturës.

Teknikat paksa destruktive të aplikuara në karakterizimin mekanik të muratorisë historike

Testimet paksa - destruktive janë një grup i gjerë i teknikave të analizës që përdoren në projektin e konservimit për t’i vlerësuar vetitë e një materiali, komponenti, apo ndonjë sistemi duke shkaktuar shumë pak dëm (vrimat, testet etj.) Teknikat testuese paksa destruktive quhen ashtu pasi që nuk e dëmtojnë teksturën historike, por vetëm e shkaktojnë një humbje të vogël të materialeve origjinale. Nëse teknikat jo-destruktive nuk janë të mjaftueshme për ta zgjidhur një çështje të rëndësishme, mund të hapen “dritare” të vogla në pika të parëndësishme të sipërfaqes së ndërtesës. Metodatat më të përdorura të hetimeve janë:

Boreskopi dhe Endoskopi

Futeni në një vrimë (gjithashtu edhe $8 \div 10$ mm). Në muratori ky instrument përbëhet nga një lente e kombinuar me një prizëm të eksplorimit (një kamerë që transmeton imazhe). Kjo e mundëson një pamje përbrenda dëmtimit, plasaritjes, vrimës dhe ndarjes, duke e mundësuar një kontroll të drejtpërdrejtë vizual të pjesëve që ndryshe janë të paarrishme. Rezultatet nuk mund të përgjithësohen nëse nuk janë paralele me sondazhet tjera (për shembull me sondazhet apo tomogramet ultratingullore) në të cilin rast ato bëhen elemente sqaruese të kalibrimit. Në boreskop imazhi transmetohet në syze, e cila është e vendosur në fundin e pasmë, me një sistem të prizmave dhe lentave të cilat janë të pozicionuara brenda mburojës së ngurtë të pajisjes. Një endoskop modern do të thotë të shikosh përbrenda tij, ndërsa ai zakonisht përdoret për qëllime mjekësore me që rast përdor fibra optike (një fibër optike është një fije elastike transparente e bërë nga një xham i pastër jo shumë më i trashë sesa një fije floku. Ai funksionon si një valë-udhëzues ose një tub i dritës që transmeton dritën në mes të dy skajeve të fibrave) dhe ju mund ta shihni imazhin në një monitor. Edhe me një sistem të zëvendësimit të lentave është e mundur që të përdoret një gamë të gjerë të objektivave që ua mundësojnë që të zgjeroheni në fusha vizuale, ballore dhe anësore me hapje variable.

Sondimi

Ai përdoret për shpimin e vrimave në mur $8 \div 15$ cm për nxjerrjen e mostrave. Nxjerrja moderne e bërthamës nuk bën vibracione ose perkusione të dëmshme për murin. Identifikimi i përbërjes së murit (konsistenca dhe cilësia e llaçit dhe të gjithë përbërësve tjerë) nëpërmjet analizës vizuale dhe testeve laboratorike. Heqja lë gjurmë të dukshme dhe një degradim nuk ishte i pranueshëm në rastin e muratorisë që ishte dëmtuar rëndë me pak rezistencë. Mostrat janë mesatarisht përfaqësuese për llaçet dhe konglomeratet, të cilat shumë të parëndësishme për muret me blloqe të vogla.

Prizat e Rrafshëta

Testi kryhet duke e futur një prizë të hollë të rrafshët në vendin e shtresës së llaçit, i cili është prerë. Një prizë e hollë e rrafshët vendoset brenda vendit të prerë dhe presioni gradualisht rritet për ta kthyer distancën e matur para se të prehet. Zhvendosja e shkaktuar nga prerja dhe ato më pas të detyruara nga priza e hollë e rrafshët maten me një gjatësi-matës, përpara dhe pas prerjes së vendit dhe gjatë testeve. Ajo mund të përdoret për ta përcaktuar vlerën lokale të kompresionit dhe gjithashtu për ta studiuar sjelljen e presionit-tendosjes së muratorisë (karakteristikat e saj deformuese). Pasi të kompletohet testi, priza e hollë e rrafshët mund të hiqet shumë lehtë dhe llaçi të rikthehet në gjendjen e

tij origjinale. Për shkak të jo-homogjenitetit të muratorisë, besueshmëria e testit varet nga numri i prerjeve. Duke qenë një operacion mjaft shkatërrues, vetëm një apo dy mostra mund të mostrohen dhe testi në aspektin statistikor mund të jetë i pasigurt, në rast të një muri shumë të dobët. Një problem tjetër është se ajo është shumë e shtrenjtë. Testimi me prizë të hollë të rrafshët është një mënyrë për ta vlerësuar gjendjen e presionit në muratorinë *in-situ*. Nyejt e llaçit në një ndërtesë lokale prehen dhe rimbushen. Dy metodat e testimit janë: matja përgjatë prerjes për ta vlerësuar presionin veprues në mes të dy prerjeve për ta vlerësuar deformimin apo totalin e elasticitetit të mureve. Para prerjes së murit, merren dimensionet origjinale midis pikave të gjerësisë. Pasi të bëhen prerjet, prizat e holla të rrafshëta janë vendosën në prerje, ndërsa leximet midis pikave të gjerësisë bëhen në presione të ndryshme. Nga këto të dhëna ju mund ta llogaritni presionin që ishte i pranishëm në mur para se të bëheshin prerjet, si dhe totali i elasticitetit të murit. Pasi të sigurohen të dhënat për të dyja testet, prerjet mbyllën me llaç.

Dilatometri

Baza e testit përbëhet nga futja e sonde cilindrike në një vrimë, që ka një membranë të jashtme që zgjerohet dhe që mat, në intervale të zgjedhura ose në mënyrë gjysmë të vazhdueshme në vendet e afërta të testit, zhvendosjen radiale të vrimës derisa bëhet zgjerimi i sondës nën një presion të njohur radial. Ky test përfshin përcaktimin e deformimit in situ të gurëve nga matjet e zgjerimit radial të një seksioni të vrimës nën një presion të njohur uniform radial të aplikuar me anë të një sonde cilindrike të dilatometrit. Rezultatet e testeve cilindrike të dilatometrit mund të përdoren për t'i përcaktuar rekuizitat e deformimit. Ky test e ka një kufizim të rëndësishëm: të dhënat duhet të jenë të sakta dhe vlefshmëria lokale mund të zgjatet vetëm me një numër të konsiderueshëm të vlerësimeve dhe duke i krahasuar me testet e tjera të zgjatura (për shembull, analizat ultratingullore, termografike etj.)

Testi i nxjerrjes

Ai kryhet me mjete të përshtatshme, nga nxjerrja e gjilpërës së çeliktë të ankoruar në mur me materiale forcuese, duke e matur forcën e nevojitur; forca duhet të vendoset krahas karakteristikave të rezistencës, varësisht nga forma e mossuksesit dhe madhësisë së komponentëve. Ajo përdoret për identifikimin e rezistencës së ankorimeve dhe karakteristikën e tendosjes ndaj tërheqjes dhe prerjes. Ky është një test ndërhyrës jo aq domethënës në rastin e materialeve jo-homogjene si të muratorisë. Mund të jetë i dobishëm për verifikimin e aftësisë ankoruese të ndonjë pajisjeje për të hyrë në mur dhe aftësinë e llaçit të përdorur për sigurimin e pajisjes.

Shpimi me energji të kontrolluar

Ky test konsiston me shpimin e vrimave me turjela të cilat mund ta përcaktojnë energjinë e nevojshme për shpim dhe e merr informacion në mënyrë indirekte tek karakteristikat mekanike të llaçit dhe muratorisë. Ai përdoret për përcaktimin e karakteristikave të forcës së llaçit dhe komponentëve të murit. Me trazim të kufizuar, testi jep karakterizime treguese për cilësinë e materialit të muratorisë, por mund të përsëritet me një shpërndarje diskrete në ndërtesën e analizuar.

Bibliografia

Abbaneo S., Berra M., Binda L. (1996) Pulse velocity test to qualify existing masonry walls: usefulness of waveform analyses, Proc. 3rd Conference: Nondestructive evaluation of civil structures and materials; Boulder, Colorado, September 1996; pp. 81-95.

Berra M., Binda L., Anti L., Faticcioni A. (1992), Non destructive evaluation of the efficacy of masonry strengthening by grouting techniques, Proc. International workshop: Effectiveness of injection techniques for retrofitting of stone and brick masonry walls in seismic areas, Polytechnic of Milan, March 1992; pp. 63-70.

Bongiovanni G., Celebi M., Clemente P., (1990), The Flaminio obelisk in Rome: vibrational characteristics as part of preservation efforts, Earthquake Engineering and Structural Dynamics, Vol. 19, pp.107-118.

Forde M.C., Birjandi K.F. & Batchelor A.J. (1985), Fault detection in stone masonry bridges by non-destructive testing, Proc. 2nd International Conference Structural Faults & Repair, Engineering Technics Press, Edinburgh, pp. 373-379.

Epperson G.S., Abrams D.P. (1989) "Non destructive evaluation of masonry buildings", Advanced Construction Technology Center, Doc. N. 89-26-03, Urbana Illinois, October 1989;

Riva G., Bettio C., Modena C. (1997), The use of sonic wave technique for estimating the efficiency of masonry consolidation by injection, Proc. 11th International Brick/Block Masonry Conference, Shangai, China, October 1997, pp. 28-39.

Schuller M., Berra M., Faticcioni A., Atkinson R., Binda L. (1994), Use of tomography for diagnosis and control of masonry repairs, Proc. 10th International Brick/Block Masonry Conference, Calgary, Canada, July 1994, pp. 438-447.

Maierhofer, Ch. (2001), Radar investigation of masonry structures, NDT&E International, Vol. 34, No. 9, 139-147.

Modena C. (1997), Criteria for cautious repair of historic buildings, Evaluation and Strengthening of Existing Masonry Structures, L. Binda & C. Modena Ed., RILEM, pp 25-42.

Suprenant B. and Schuller M. (1995), Non-destructive evaluation and testing of masonry structures, TMS Publication, 1995.

Valle S., Zanzi L., Binda L., Saisi A., Lenzi G. (1998), Tomography for NDT applied to masonry structures: Sonic and/or EM methods in «Arch bridges», Balkema, Rotterdam, pp. 243-252.

Kapitulli 3

Menaxhimi i Muzeut

Prezantimi i Menaxhimit të Muzeut nga Barbara Ravnik

Sipas statutit të ICOM-it të miratuar në Konferencën e Përgjithshme të 21 në Vjenë, Austri, në vitin 2007: Një muze është një institucion permanent jo-fitimprurës, në shërbim të shoqërisë dhe të zhvillimit të saj, i hapur për publikun, i cili merr, konservon, hulumton, transmeton dhe e ekspozon trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme të njerëzimit dhe mjedisit të tij, për qëllime edukative, studimi dhe kënaqësie.

Muzetë e kanë përgjegjësinë primare për ta mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme kulturore. Administrimi i tyre ka nevojë për ta definuar një plan të menaxhimit i cili përfshin njeriun, burimet fizike dhe financiare të nevojshme për atë qëllim.

ROLET E MENAXHMENTIT NË MUZE

Me qëllim që të ndihmohet përmbushja e misionit, mandati, synimet dhe objektivat, ai duhet të jetë ekspert në kryerjen e pesë roleve në vijim:

- të inspirojë në lidhje misionin e muzeut;
- të kumtojë mandatin e muzeve;
- të udhëheq drejt synimeve të muzeut;
- të kontrollojë përmbushjen e objektivave;
- të vlerësojë përmbushjen e funksioneve të muzeut dhe rezultateve

Kërkesat themelore për planifikimin e një plani real të veprimit për menaxhimin e një muzeu janë për ta definuar:

- misionin, parimet edukative dhe standardet;
- statusin ligjor dhe pasqyrën financiare;
- organizimi i brendshëm dhe kompetencat;
- menaxhimi i koleksioneve;
- nevojat e sigurimit;
- interpretimi dhe plani i komunikimit;
- marrëdhëniet publike;
- marrëdhënia me territorin.

Qëllimi i Menaxhmentit në muze është që t'i ndihmojnë vendimet që çojnë në


arritjen e misionit të muzeut, në përbushjen e mandatit të tij dhe në realizimin e synimeve dhe objektivave të tij për të gjitha funksionet e tij¹¹.



The triangle of museum functions suggests organisation of staff into three divisions: one concerned with the museum’s assets, another with its activities, and the third with administration. The names of these divisions vary, but the most commonly used are:

- collections
- programmes
- administration

Typical Three-Divisions Organization



Shtjellimi i Planit Strategjik

Niveli më i përgjithshëm i planifikimit, hartohet me qëllim të organizimit të të gjitha aspekteve të aktiviteteve të një muzeu në një drejtim të koordinuar të qartësuar si synime të cilat duhet të arrihen në periudhën e planifikimit. Ai identifikon misionin, mandatin dhe objektivat dhe synimet aktuale të detajuara për secilin divizion të muzeut, së bashku me një plan financiar, përfshirë një buxhet dhe objektivat për mbledhjen e fondeve.

Metodat e Menaxhmentit

Metoda e menaxhmentit	Relevante me	Referimi i kohës	Hartuar nga:	Miratimi nga:
Planet	Misionin, synimet dhe objektivat	Ardhshmja	Drejtori dhe menaxhmenti	Administruesit e besuar
Politikat		E tashmja dhe e ardhshmja	Drejtori dhe menaxhmenti	Administruesit e besuar
Procedurat		E menjëhershme dhe e tashme	Stafi	Drejtori
Raportet		E kaluara e fundit dhe të tashmes	Stafi	Menaxherët dhe Drejtori

Planifikimi afatgjatë është një rol i ndarë nga bordi dhe menaxhmenti. Planet strategjike duhet të përgatiten nga një komision i menaxhmentit dhe administruesit e besuar të udhëhequr nga drejtori. Plani strategjik zakonisht përgatitet për një periudhë 3-5 vjeçare dhe si rregull korrespondon me mandatin e drejtorit.

PLANI THEMELOR

Është afatgjatë (zakonisht rreth 20 vite) dhe është një plan më i detajuar sesa palni strategjik. Ai fokusohet në burimet e muzeut, kërkesat e hapësirës, objektet, personelin, financimin dhe mjetet për t'i përbushur ato. Duhet të përfshijë:

- plan institucional
- analizë të koleksionit
- strategji të komunikimit
- analizë të tregut
- plan të programit publik
- plan të stafit

- plan të ndërtesave
- strategji të financimit
- Pjesëmarrja, të hyrat dhe parashikimet e shpenzimeve
- parashikime të shpenzimeve kapitale
- afati i implementimit

Menaxhimi financiar

Muzetë mund të buxhetojnë për fonde dhe qëllime të ndryshme:


- buxhetin operativ: të hyrat vjetore dhe shpenzimet për përkujdesjen e koleksionit të muzeut, programit të aktiviteteve publike dhe funksionimin e sitit dhe të ndërtesës;
- fondet e blerjes: sasia e mbajtur për blerjen e objekteve për koleksion, apo për shpenzimet që lidhen me blerje;
- fondet e dhuruara: zakonisht para të dhuruara të cilat ose investohen në operativë ose (në rastin e fondeve të pakufizuara), apo për qëllime specifike të tilla si për blerje, ekspozita, seri leksionesh, publikime (në rastin e fondeve të kufizuara);
- buxheti kapital: një shumë që mbahet për zhvillim të planifikuar të sitit të muzeut apo ndërtesat e tij, të tilla si renovimi, zhvendosja, ndërtime të reja ose rinovim të ekspozitës;
- projektet e granteve: grantet qeveritare apo të fondacioneve shpeshherë kërkojnë kontabilitet të veçantë për projektet të cilat do të mbështeten;
- rezervat: shuma të mbajtura për shpenzime të paparashikueshme, ose për projektet e ardhshme zhvillimore.

PLANIFIKIMI FINANCIAR DHE ZHVILLIMI

Parimet e një plani afatgjatë financiar:

- sigurimi i stabilitet financiar për institucionin;
- sigurimi dhe mbështetja e programit edukativ;
- promovimi i muzeut si një pjesë vitale e industrisë kulturore të turizmit;
- fondet e dhuruara ose ndonjë formë tjetër ekuivalente e të ardhurave në investime;
- një program për angazhimin e vizitorëve duhet ta zgjerojë apelimin e muzeut në ata sektorë të komunitetit të cilët nuk janë mjaft të përfaqësuar prej vizitorëve;

- konsiderim të kujdesëshëm për të përfitur financim përmes kontrollit të imazhit të tij dhe markës;
- në rast të ndërtesës së madhe, renovimi apo zgjerimi mund të planifikohet, është e domosdoshme që të përgatitet një plan të detajuar biznesor/studim të realizueshmërisë.





Politikat për Menaxhimin e Muzeut në Shqipëri, nga Ols Lafe

Iniciativat për krijimin e muzeve në Shqipëri mund të datohet me më pak se 100 vjet më parë, ndërkohë që nisma më të forta janë marrë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, në vitet 1948-1949.

Kjo është koha kur tre muzetë e parë janë hapur në vend:

- Muzeu Kombëtar Arkeologjik dhe Etnografik
- Muzeu i Shkencave të Natyrës
- Muzeu i Luftës Nacional-çlirimtare

Të tre muzetë ishin të bazuar në Tiranë, në kryeqytetin e Shqipërisë. Pas kësaj periudhe, deri në fund të viteve të 1980'ta, më shumë se 220 muze të të gjitha llojeve dhe tipave ishin funksionale në vend. Këta muze ishin klasifikuar në bazë të karakteristikave të tyre dhe përmbajtjes, si në kategoritë e mëposhtme:

- Muzetë kombëtar;
- Muzetë historik krahinor;
- Muzetë e specializuar (muzetë arkeologjik, muzetë etnografik, muzetë e artit, muzetë e luftës, muzetë ushtarak, etj);
- Monumentet e ngjarjeve të rëndësishme dhe/ose të personave të rëndësishëm;
- Muzetë e Hapur (qytete muzeore, pazare të vjetra).

Inventari dhe menaxhimi i Koleksioneve të Muzeut

Inventari i trashëgimisë së paprekshme dhe koleksioneve të muzeut është një aktivitet i përhershëm dhe gjithmonë në zhvillim. Kjo është baza për menaxhim më të mirë të trashëgimisë dhe për gjetjen e mjeteve më të përshtatshme për promovimin e resurseve kombëtare të trashëgimisë kulturore, për vizitorët vendorë dhe ata ndërkombëtarë. Për secilin objekt krijohet një dokument dhe ia fillon një plan kombëtar i komunikimit për të.



Ligji Kombëtar për Muzetë

Ligji aktual shqiptar për Muzetë, është i bazuar kryesisht në ligjin e Estonisë për Muzetë dhe ishte miratuar nga Parlamenti Shqiptar në vitin 2005. Përveç kësaj, elementet themelore nga statuti i ICOM-it dhe elementet nga legjislacioni italian gjithashtu janë përfshirë në këtë ligj.

Por dobësitë janë evidentuar dhe aktualisht janë objektiv për t’u ndryshuar. Gjobat janë duke u futur tani në projektligjin e ri, si dhe dispozita më të mira për muzetë publik dhe privat. Rezultatet e pritshme do t’i parandalojnë veprimet e padrejta në menaxhimin e muzeut nëpër tërë vendin, do të rrisin cilësinë e profesionistëve në fushë, më shumë mjete fiskale dhe promovim më të mirë dhe siguri për muze.

Prioritetet / anët e forta

Rezultatet e pritura:

- Për herë të parë të parashikohen gjobat për veprimet e gabuara në, menaxhimin e muzeve,
- Rritja e cilësisë së profesionistëve,
- Më shumë mjete fiskale,
- Procesi i rreptë i miratimit për muzetë private,
- Promovim më të mirë dhe siguri.

Inventarizimi dhe menaxhimi i Koleksioneve të Muzeut

Inventari i trashëgimisë së paprekshme dhe koleksioneve të muzeut është një aktivitet i përhershëm dhe gjithmonë në zhvillim. Kjo është baza për menaxhim më të mirë të trashëgimisë dhe për gjetjen e mjeteve më të përshtatshme për ruajtjen, restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore – **QKIPK** është themeluar dhe është e qasshme përmes faqes së internetit WWW.QKIPK.GOV.AL

Të dhënat janë kujtesa e një muzeu

- Lejoni muzeun që ta identifikojë dhe të jep llogari për artikull në koleksion,
- Dëshmoni të drejtën e pronësisë së bashku me dëftesën,
- Bëjeni dallimin në mes të një objekti që është shembull i një lloji dhe një objekti që e tregon historinë e jetës së dikujt.
- QKIPK bën dokumentimin dhe katalogimin informatikë të objekteve të trashëgimisë kulturore në pronësi publike dhe private.
- Duke kartelizuar e kataloguar pasurinë private QKIPK u vjen në ndihmë, institucioneve shtetërore, koleksionistëve, poseduesve e pronarëve,

si dhe krijuesve të arteve pamore, të cilët përmes dokumentacionit të ruajtur në bazën e të dhënave, sigurohen ndaj humbjeve të mundshme, grabitjeve dhe dëmtimeve. Kështu sigurohet informimi dhe aktivizimi i Interpolit dhe sektorit Antitrafik në MB.

- Përmes raporteve, merret informacion për llojet e ndryshme të trashëgimisë, me specifikime të detajuara, në tërësi e sipas fushave, kategorive, vendndodhjeve, autorëve, pronareve etj.
- QKIPK është institucion në varësi të MTKRS, me veprimtari kryesore krijimin e rrjetit informatikë kombëtar të trashëgimisë kulturore duke inventarizuar dhe kataloguar vlerat materiale dhe shpirtërore të saj.
- Ky katalog është një bankë virtuale e cila pasqyron informacionin me tërëndësishëm rreth objektit, dhe lejon administratën të marrë të dhëna të detajuara rreth çdo objekti të regjistruar në një kohë të shkurtër.
- Në bazë të *ligjit 9048* Për Trashëgiminë Kulturore, të gjithë objektet që dalin jashtë shtetit, për një afat të përcaktuar, për ekspozim dhe restaurim, duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave të QKIPK, për tu pajisur me pasaportën përkatëse të objektit.

Për çdo objekt krijohet një fletë dhe ajo përfshin informatat në vijim:

Katalog

- Numri i pranimit
- Emri ose titulli
- Përshkrim i shkurtër
- Fotografi
- Vendi i prodhimit & viti
- Bërësi, teknika e prodhimit
- Materialet
- Përmasat
- Mbishkrimet
- Historia/Prejardhja
- Tjetër identifikim
- Klasifikim
- Vendndodhja në dyqanin tuaj
- kataloguesi dhe data

Pamja e te dhënave te plotësuara për një objekt ne programin e Qendrës

KODI

↓

Objektet kulturore

kod: 017 objekti: Kolë e Jezuit të Accolepust Shtim Fshije

tipologji

fasha: ARHEOLOGJIA
kategoria: Objekt Arti
lloji: Portret
materiali: Mermer
teknika: Antrazale
kultura: Italiane

posedues/pronare

pronari: Shteti
poseduesi: Muzeu Arkeologji_Shtetit
nr. regjistrimit: 0
vendodhje: SAKANDE
vlefte: 0 mln LEK

te dhena mbi objektin


autori: Arcinin Anonin
pershkrimi: Icolmale
nga vit: -300 deri: -200 autentik:
dimensioni: pesha:

status

status aktiviteti: ne kerkim
vd. konvertet: Muzeu Arkeol o rregullt
status detyrimi: 3

Foto

Krijuar nga: Ne Date: [21/09/2010 11:58:01] Shtet: Modifikuar nga: Ne date: [21/09/2010 11:58:00 AM]



Çdo objekt identifikohet me një kod i cili është i papërsëritshëm. Ky kod shënohet në pasaportën e objektit, mbi vulën përkatëse.

QKIPK dhe DREJTORIA PËR GJITHSHME E DOGANAVE kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi.

- QKIPK jep informacion periodik në website-in e saj mbi listën e objekteve të regjistruara pranë kësaj zyre, që kanë të drejtë të kalojnë kufirin, duke paraqitur imazhin, pronarin apo poseduesin, vendin ku shkon dhe autorizuesin e lëvizjes.
- QKIPK merr përsipër, sipas kërkesave të DPD, të bëjë kualifikimin e personelit të shërbimit doganor për njohjen, dallimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe për kontrollin informatikë të lëvizjes së tyre.
- DPD ka detyrimin e ndalimin të të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore që dalin jashtë vendit pa dokumentacion të rregullt ligjor (pasaportën e objektit të lëshuar nga QKIPK, lejen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ose të Këshillit të Ministrave). Lejet e lëshuara nga çdo institucion tjetër, qendror apo lokal, janë jo ligjore, dmth të pavlefshme.

Për informacion do të nënvizojmë se baza e të dhënave përbëhet nga tre katalogë:

- Katalogu “Onufri”, ku është informatizuar mbi bazën e kartelave dhe fotove, pasuria e rrjetit muzeor kombëtar lokal të vendit dhe galerive të artit. Përfshin 61328 kartela objektësh dhe 91.567 foto.
- Katalogu “Maro Kondi”, ku pasqyrohet pasuria e personave privatë, që nuk e ka statusin, por në të ardhmen mund ta marrë, dhe sipas ligjit është në lëvizje të lirë brenda vendit.

- Përfshin 11379 kartela me 13.170 foto
- Katalogu i Objekteve të Humbura.
- Ky është një katalog i veçantë ku pasqyrohen kartelat e objekteve të vjedhura nga viti 1991 deri më sot.
- Këtu figuron një % e vogël e objekteve realisht të vjedhura dhe për fat të keq me shumë pak foto.
- Përfshin 2182 kartela dhe vetëm 243 prej tyre me foto
- (të një rezolucioni të dobët)

"Pasaporta e objektit" është kartela e identifikimit të një objekti të trashëgimisë kulturore, ku vendosen fotografia e objektit, filmimet, skicat, vendndodhja, përmasat, pesha, materiali, kodi kompjuterik, autori, vendi i ruajtjes, përshkrimi dhe historiku.

Përshkrim i deklaratës së politikave për Procedurën e Katalogimit

- 1) Politikë e përgjithshme: Të gjitha objektet duhet të katalogohen për t'i regjistruar atributet e tyre fizike dhe prejardhjen, në përputhje me standardet e përcaktuara ose klasifikimet, për secilin lloj të koleksionit.
- 2) Numrat identifikues të katalogimit iu caktohen dhe vendosen të gjitha objekteve.
- 3) Nëse muzeu kryen, ose është i ndërlidhur me, gërmime arkeologjike apo punë të ngjashme në terren, duhet të bëhet çdo përpjekje për ta integruar regjistrimin në terren me katalogimin e përhershëm, p.sh. duke përdorur numrat e pranimit të muzeut dhe sistemet e katalogimit.
- 4) Objektet gjithmonë katalogohen para se ato të jenë të lejuara që të largohen nga muzeu në huazim.
- 5) Katalogimi kryhet sa më shpejt që është e mundur për ta shmangur

ngarkesën me punë.

- 6) Megjithatë aty ku ekziston një numër i pranimit dhe katalogimi, muzeu duhet ta zhvillojë dhe zbatojë një plan për të sjellë katalogimin deri në një standard të pranueshëm, sa më shpejt të jetë e mundur.

Inventarizimi i Pasurisë së Paprekshme dhe Koleksioni i Muzeut gjithashtu është funksional për identifikimin e nevojave të sigurisë:

Siguria e koleksioneve

- Hapësirat e magazinimit
 - Qasja e kufizuar në zonat e magazinimit
 - Nënshkrimi me rastin e hyrjes
 - Qasje e mbikëqyruar për studiuesit, njerëzit e profesioneve të ndryshme që bëjnë mirëmbajtjen etj
- Hapësirat e ekspozimit
 - Kuti të mbyllura të ekspozimit
 - Prezencë e stafit
 - Vëzhgim me kamera

Çështjet e sigurisë që duhet të mbulohen në Politikën e Menaxhimit të Koleksioneve

- 1) Qasja fizike në koleksione, madje edhe për stafin, është i kufizuar në një lokacion të mbyllur, të siguruar dhe me hyrje të kontrolluar.
- 2) Stafi i koleksioneve përgjegjës për një objekt të caktuar, koleksion të veçantë apo hapësirë të magazinimit do ta mbikëqyrë edhe qasjen e personelit tjetër dhe të vizitorëve.
- 3) Duhet të mbahen të dhënat për personelin që ka qasje kyçe.
- 4) Duhet të mbahen të dhënat për të gjithë vizitorët që lejohen në magazinë dhe në hapësirat tjera të mbyllura të muzeut,
- 5) Qasja për qëllime kërkimore bazohet në dizajnin e miratuar të kërkimit dhe të gjitha vizitat e ngjashme duhet të regjistrohen në mënyrë të ngjashme, siç duhet në fund të periudhës së huazimit.

Avantazhet e përdorimit të një baze të dhënave

- Përmirëson qasjen në koleksione
- Përmirëson mundësitë e kërkimit
- Rrit njohurinë për koleksionet
- Raportet e koleksioneve mund të shtypen në formate të ndryshme
- Mund të lidhen imazhet/videot/dhe audio skedat
- Ndihmon në detyrat e menaxhimit të koleksioneve, si për blerje, zhvendosje, inventarizime, huazime dhe në ekspozita

Në Shqipëri të gjitha aktivitetet që lidhen menaxhimin e Muzeut e ndjekin publikimin: Drejtimi i një Muzeu - Një Doracak Praktik i finalizuar nga ICOMManuali Drejtimi i një Muzeu: Një doracak praktik ka për qëllim që ta jep një pasqyrë të aspekteve kyçe të funksionimit të një muzeu, e cila dëshiron që t'iu shërbejë nevojave dhe shpresave të vizitorëve e saj dhe komunitetit të gjerë në shekullin e 21'të.

Muzetë duhet të mbesin besnik ndaj vlerave thelbësore tradicionale të muzeut dhe të vazhdojnë të theksojnë kujdesin dhe zhvillimin e koleksioneve që ofrojnë dëshmi fizike për kulturën dhe mjedisin e zgjedhur të muzeut, qoftë ky një sit i vetëm historik apo arkeologjik, një qytet, një rajon ose një vend i tërë.


Megjithatë, në mënyrë të barabartë, muzeu bashkëkohor duhet ta ketë një fokus të fortë për kërkimin e ekselencës me shërbimet e tij për publikun e vet të shumtë, qofshin këta nxënës të rinj të shkollave, studentë të avancuar, vizitorë të përgjithshëm të lokalitetit, turistë ndërkombëtarë apo kombëtarë, apo kërkues specialist.

Drejtimi i një Muzeu e ka për qëllim që t'iu shërbejë disa qëllimeve. Ne Shpresojmë se informacioni dhe këshilla në "Praktikën më të mirë aktuale"do të jetë e një vlere praktike:

- 1) për profesionistët e rinj apo të ardhshëm të muzeve me përvoja minimale në drejtimin e një muzeu;
- 2) për profesionistët dhe teknikët me përvojë në njërin prej shumë fushave të specializuara të punës së muzeut, duke ju shpjeguar atyre rreth përgjegjësive dhe punën e kolegëve të tyre në departamentet e tjera dhe specializimet;
- 3) si një burim i vlefshëm në diskutimet e brendshme mase të nevojshme midis stafit dhe autoriteteve qeverisëse për performancën aktuale dhe politikës së ardhme, si dhe në drejtimin e institucionit të tyre.

Mjetet promovuese

Mjetet e ndryshme dhe fushata promovuese është themeluar në Shqipëri, si dhe një Plan Kombëtar i Komunikimit. Një udhëzues në nivel kombëtar është publikuar duke paraqitur Muzetë kryesorë në Shqipëri:



2 NATIONAL MUSEUM “GEORGE KASTRIOT SCANDERBEG”



- Tel: +355 32 22 25
- Visiting Hours: 9^{am} - 12^{pm} and 1^{pm} - 10^{pm} (***)
- Holiday: Monday
- Address: Fortress of Krujë

National Museum “George Kastriot Scanderbeg” was inaugurated on 1 November 1982. It is built in the famous fortress of Krujë, capital of Arber state and personification of Turkish armies defeat for three successive times in the 14th - 15th century.

Many objects, original documents and bibliographies, authentic reproductions that depict clearly Albanian people history in the 15th and beyond are displayed in this museum. The museum counts such pavilions as Antiquity and Early Middle Age Pavilion, Albanian Princedom Pavilion, Pavilion of Ottoman Invasion and resistance to this invasion, medieval fortresses pavilion, Albanian resistance, Scanderbeg's office equipment and library, prince's hall and parsotheque and the last one is the heritage and echo pavilion.

Objects of ceramic, bronze, iron, copper, several facsimiles, original icons, writings, a hall of 1462, original swords of the 15th century, etc. are displayed in these pavilions.

(***) In May, June, July, August and September the visiting hours are 08^{am} - 12^{pm} and 10^{am} - 9^{pm}



Politikat kombëtare për luftën kundër trafikimit të paligjshëm

Në lidhje me muzetë, trafikimit të paligjshëm i mallrave kulturore është një çështje e rëndësishme që duhet të trajtohet. Historia e trafikimit të mallrave kulturore nuk është një fenomen i ri, ai e tejkalon mijëvjeçarin, ndërsa për territorin shqiptar, trafikimi (në një formë jo të ngjashme me të sotshmes) daton së paku 500 vjet më parë. Nga territori ku ne jetojmë sot, objekte të panumërta të cilat janë marrë, sot gjendet në muzetë e vendeve fqinje apo edhe në vendet tjera evropiane. Lufta lidhje me plaçkitjen ekzistoi deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Pas përfundimit të luftës kishte një mënyrë më të mirë për ta trajtuar

trashëgiminë kulturore, ligjet dhe aktet e tjera u miratuan dhe u kombinuan me një izolim të thellë, trafikimi pothuajse doli jashtë përdorimit.

Por ndryshimet demokratike sollën dritë në fenomenin e trafikimit. Plaçkitja nuk e kurseu as Butrintin apo Apoloninë, por përpjekjet e qeverisë shqiptare bënë të mundur që shumë objekte të kthehen në vendin e origjinës së tyre.

KORNIZA LIGJORE

Konventa e UNESCO-s — Masat për Ndalimin dhe Parandalimin e Importit të Paligjshëm, Eksportit dhe Transferimit të Pronësisë së Objekteve Kulturore e 14 nëntorit të vitit 1970 (e miratuar me ligjin nr 8523 data. 9.9.1999)

Në vitin 1970 Konventa e UNESCO-s mbi Masat për Ndalimin dhe Parandalimin e Importit të Paligjshëm, Eksportit dhe Transferimit të Pronësisë së Pronës Kulturore ishte miratuar. Qëllimi i saj ishte që të forcohen përpjekjet ndërkombëtare kundër trafikimit të trashëgimisë kulturore, duke themeluar një sistem të bashkëpunimit midis vendeve dhe standardeve etike të lëvizjes së mallrave kulturore.

Konventa

Në vitin 1970 UNESCO miratoi Konventën mbi Mënyrat e Ndalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Trashëgimisë Kulturore/ UNESCO Convention on the Means of Prohibiting the Illicit Import, Export and Transfer of Ownership of Cultural Property.

Qëllimi i saj ishte të përforconte angazhimin ndërkombëtar në luftën kundër trafikut të objekteve të trashëgimisë kulturore duke vendosur një sistem bashkëpunimi mes Shteteve dhe standardet etike të lëvizjes së pasurive kulturore.

Konventa përcakton detyrimet e Shteteve Palë të saj për:

- hartimin e legjislacionit për këtë qëllim;
- krijimin e inventarit të pasurive kulturore;
- mbikëqyrjen e gërmimeve arkeologjike dhe ruajtjen e tyre dhe të gjetjeve;
- të marrin masa për arsimimin edhe edukimin e brezave të rinj me respektin për trashëgiminë kulturore që zotërojnë;

Konventa

- Në kundër të Programit të UNESCO-s për vitin 2010-2011 lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të objekteve me vlerë historike janë parashikuar një sërë masash që synojnë:
- zbatimin sa më të mirë të Konventës së UNESCOs- për Mënyrat e Ndalim-

it dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurive Kulturore (1970).

- forcimin e kapaciteteve të ekspertëve në nivel kombëtar për ruajtjen e mbrojtjen e kësaj trashëgimie.
- përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar mes institucioneve të ndryshme për rikthimin e objekteve të grabitura a të trafikuar në mënyrë të paligjshme.

Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1999, ndërsa është përpjekur që t’i ratifikojë edhe konventat e tjera po aq të rëndësishme në fushën e trashëgimisë së prekshme dhe të paprekshme, si dhe një marrëveshje me Qeverinë e SHBA-ve në mbrojtjen dhe ruajtjen e mallrave të veçanta kulturore.

Ligje dhe akte nënligjore

- Ligj Nr 8523, datë 09/09/1999 “Për aderimin e RSH në Konventën e UNESCO-Or mjetet e ndalimit dhe të parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore”
- VKM Nr 639, datë 30/09/2004 Për miratimin e Marrëveshjes mes KM të RSH dhe qeverisë së SHBA për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive të caktuara kulturore

Korniza Ligjore

Momentalisht, çështjet që kanë të bëjnë me trashëgimi në Republikën e Shqipërisë janë të rregulluara me ligjin nr. 9048 të datës 7.4.2003 Për Trashëgiminë Kulturore, si dhe me ligjin nr. 9386 të datës 4.5.2005.

Ligji për “Trashëgiminë Kulturore”

- Nuk i adreson çështjet e kthimit të objekteve të cilat janë eksportuar/ importuar ilegalisht
- Ai ofron rregulla për lëvizjen e objekteve të klasifikuara të trashëgimisë
- Ai nuk është në përputhje me Direktivën 93/7/EEC të 15 marsit të vitit 1993 “Për kthimin e objekteve kulturore të cilat janë larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i një Shteti Anëtar”.

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR DOKUMENTACION

- QENDRA KOMBËTARE PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE KULTURORE
- Instituti i Monumenteve Kulturore
- INSTITUTI I ARKEOLOGJISË (përgjegjëse për gërmime dhe dokumentimin e të gjeturave)
- INSTITUTI I ANTROPOLOGJISË KULTURORE (përgjegjës për dokumen-

timin e zejeve, kostumeve popullore, këngëve, valleve, etj)

- DREJTORATI I PËRGJITHSHËM I ARKIVAVE (përgjegjës për ruajtjen e dokumenteve të shkruara, kopje të ngurta)

Gjithmonë është më e lehtë që të parandalohet trafikimi i një objekti sesa të kërkohet ai objekt i trafikuar. Kështu që, mbrojtja e muzeve tona, duke i menaxhuar ata më mirë dhe promovimin e mallrave kulturore të cilat të gjithë ne i ndajmë, është qëllimi ynë i përbashkët për një të ardhme më të mirë.


Problemet dhe ndërhyrjet

- Jo të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore janë të regjistruara në Qendër. (muzetë kombëtarë dhe Drejtoritë rajonale)
- Lidhja e të gjitha institucioneve me anë të rrjetit dhe instalimin e Bazës së dhënave në këto institucione dhe në zyrat doganore.
- Përmirësimin e kornizës ligjore – ndërrimi i Direktivës së BE)
- Qasje me anë të internetit.

Mënyra përpara


- Përmirësimi i bazës ligjore aktuale (është në proces përafrimi me Direktivën 93/7/EEC “Mbi kthimin e objekteve kulturore të nxjerra jo ligjërisht nga territori i një shteti anëtar”)
- Përmirësimi i ligjit të trashëgiminë kulturore me çështje që lidhen me rritjen e sigurisë dhe monitorimin e monumenteve kulturore, muzeve dhe galerive.
- Rregullime të mëtejshme dhe të mirëstudiuara për trafikimin e veprave kulturore në Kodin Penal.
- Informacioni mbi objektet kulturore të trafikuar duhet të jetë në çdo rast publik.
- Duhet të forcohet bashkëpunimi mes institucioneve që luftojnë fenomenin.
- Autoritetet përgjegjëse duhet të përmirësojnë burimet për trajnimin e nëpunësve të institucioneve të përfshira në çështje të parandalimit dhe luftës kundër trafikut të paligjshëm (VKM “Për miratimin e Plan-Veprimit Kombëtar “Për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Veprave të Artit e Kulturës”).

CULTURAL HERITAGE - THE EUROPEAN IDENTITY OF ALBANIA




- Ⓞ Theft of, looting of, and damage to the cultural monuments, ensembles and historic centers, parks and archaeological areas of Albania is strictly prohibited by law;
- Ⓞ The theft and looting of, or any damage to, the movable cultural heritage objects of Albania, including artifacts from archaeological sites and museum inventories, is strictly prohibited by law;
- Ⓞ Theft, looting and damage to any object with cultural heritage value to Albania is strictly prohibited by law, and is punishable by fines or jail time.

Call 129 if you have witnessed any of the above actions.




Ministry of Tourism, Culture,
and Sport of Albania
with the support of




Individuals who steal or buy, and transport cultural heritage objects without the proper permission of the authorities will be punished in accordance with the Criminal Code of the Republic of Albania and a fine up to 100,000 Euro.

CULTURAL HERITAGE - THE EUROPEAN IDENTITY OF ALBANIA




- Ⓞ Theft of, looting of, and damage to the cultural monuments, ensembles and historic centers, parks and archaeological areas of Albania is strictly prohibited by law;
- Ⓞ The theft and looting of, or any damage to, the movable cultural heritage objects of Albania, including artifacts from archaeological sites and museum inventories, is strictly prohibited by law;
- Ⓞ Theft, looting and damage to any object with cultural heritage value to Albania is strictly prohibited by law, and is punishable by fines or jail time;

Call 129 if you have witnessed any of the above actions.



Ministry of Tourism, Culture,
and Sport of Albania
with the support of



Individuals who steal or buy, and transport cultural heritage objects without the proper permission of the authorities will be punished in accordance with the Criminal Code of the Republic of Albania and a fine up to 100,000 Euro.

Kapitulli 4

Ekonomiciteti i Trashëgimisë

Vlera ekonomike e Trashëgimisë Kulturore, nga Xavier Greffe

1. Hyrje; Trashëgimia Kulturore për Zhvillim të Qëndrueshëm

Tani në përgjithësi pranohet se aktivitetet artistike kanë shumë cilësi të dobishme, përveç vlerave estetike dhe artistike që u atribuohen atyre. Kjo na sjell tek 'vlerat jothelbësore' të kulturës dhe arteve, në krahasim me "vlerat thelbësore" të tyre. Shumë organizata vazhdimisht e kanë theksuar këtë kontribut gjatë viteve të fundit. Duke njohur vlerat jothelbësore të kulturës gjithashtu do të thotë të theksosh rëndësinë e alokimit të burimeve të mjaftueshme për konsumim kulturor – edhe për konsum final edhe për atë të ndërmjetëm. Rëndësia e **vlerave jothelbësore** të kulturës mund të merret parasysh nga tri këndvështrime:

- Këndvështrimi i parë është **ekonomik**. Në këtë rast, aktivitetet artistike ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së objekteve të përdorimit të çdoditshëm. Ky është një debat i vjetër që ka ekzistuar që nga kohët e lëvizjes së Arteve dhe Zanateve e deri në "Art Nouveau" dhe lëvizjeve Bashkëkohore të Dizajnit. Si në format e saj të vjetra edhe në ato bashkëkohore, "zgjidhja" e saj ka hasur në shumë pengesa dhe shpeshherë ka përfunduar në një rrugë qorre. Mundësia për të paguar për produkte të cilat kanë cilësi estetike nuk është aq e përhapur sa besohet. Përdorimi i aftësive artistike në këto procese mund ta ndihmojë popullarizimin e tyre. Megjithatë, prodhuesit e produkteve të tilla artistike duhet të përballen me rrezikun e kopjimit.
- Këndvështrimi i dytë është shoqëror. Edhe këtu, debati është zhvilluar për një kohë të gjatë dhe edhe pse nuk është një argument i fortë se arti është për të gjithë, për shëndet të mirë dhe edukim, si dhe për integrim më të mirë shoqëror, ajo ka pjesën e saj të paqartësive dhe keqkuptime. Megjithatë, ky funksionalitet nuk ju bën mirë artistëve sistematikisht. Zgjerimi i tregjeve, veçanërisht i atyre për aktivitete socio-kulturore dhe terapi muzikore, ka qenë i dobishëm për zhvillimin e aftësive jo-artistike, si dhe për standardizimin e shkathtësive artistike më tradicionale.
- Këndvështrimi i tretë ka të bëjë me mjedisin dhe cilësinë e jetës. Ne në këtë modul do fokusohemi kryesisht në të mëparshmen, duke e theksuar faktin se trashëgimia kulturore lejon një alokim më të mirë të burimeve nga pikëpamja e kursimit të energjisë.

Kështu që kultura nuk duhet të konsiderohet si një shtyllë shtesë, por si një shtyllë qendrore. **Kultura** nuk është më një lehtësues për zhvillim të qëndrueshëm, **por është parimi i zhvillimit të qëndrueshëm**. Kultura i jep formë asaj të cilën ne e kuptojmë si zhvillim dhe e përcakton se si njerëzit veprojnë në botë.

Kjo pikëpamje e gjerë i ka tri pasoja:

- ✓ Ajo tregon se zhvillimi i qëndrueshëm është diçka më e thellë sesa modernizimi, pasi që kultura tregon se modernizimi nuk është një objektiv në vetvete dhe duhet të zotërohet.
- ✓ Ajo tregon se zhvillimi kulturor nuk mund të jetë vetëm një zhvillim nga lartë-poshtë, pasi që nuk ekziston një formulë për zhvillim e cila mund të pranohet pa diskutim. Kjo vlen për kombet, si për të gjitha grupet brenda të njëjtit komb.
- ✓ Ajo tregon se një e ardhme e qëndrueshme varet nga ajo se si “kulturat prodhuese” dhe “kulturat konsumuese” përshtaten me kontekstin ekologjik, socio-politik dhe teknologjik, i cili vazhdimisht ndryshon.

Agjenda 21 për kulturë është më e gjerë në fushëveprim sesa agjenda për zhvillim të qëndrueshëm, pasi që ajo pasqyron rëndësinë e kulturës për zhvillim të qëndrueshëm dhe në disa mënyra e pasuron debatin mbi qëndrueshmërinë.

Kjo *Agjendë 21 për kulturë* ishte dokumenti i parë që përkrahte mobilizimin e qyteteve dhe qeverive lokale për zhvillim kulturor dhe që lidhte zhvillimin kulturor me zhvillimin e qëndrueshëm.

Kjo Agjenda 21 për Kulturë fokusohet në pesë tema kryesore:

- ✓ Nevoja për t’i **respektuar të drejtat kulturore**, ku konsiderohet si pjesë e të drejtave të njeriut dhe më konkretisht, parim i Diversitetit Kulturor ose e drejtë e secilës qenie njerëzore që të përfitojë nga kultura e tij ose saj. Diversiteti kulturor definohet si *“një mjet për ta arritur një kënaqësi më të madhe intelektuale, emocionale, morale dhe ekzistencë shpirtërore”*.
- ✓ Ndërlidhja e **qeverisjes në zhvillimin lokal** në fushën e kulturës. Kultura duhet të gërshetohet me politikën e tjera të një procesi, ku qytetarët lokal mund t’i shprehin kërkesat e tyre.
- ✓ Njohja e **diversitetit kulturor si një komponent i qëndrueshmërisë** ashtu siç konsiderohet bio-diversiteti të jetë thelbësor për mbijetesën e jetës në tokë. Kjo i bie që kultura të konsiderohet si një ekosistem që i ka kërcënimet dhe mundësitë e veta, si dhe dinamikën e veta të virtutshme dhe vicioze.
- ✓ Rëndësia e kulturës për **përfshirje shoqërore**, kryesisht përmes qasjes së përhershme në kulturë nëpër të gjitha fazat e jetës dhe gjithashtu qasje të barabartë, pavarësisht karakteristikave të veta dhe diskriminimeve.

- ✓ Rëndësia e **efekteve ekonomike të kulturës**. Kultura mund të konsiderohet si një drejtues i zhvillimit ekonomik edhe sa i përket vendeve të punës dhe të ardhurave.

Përmbajtja e Agjendës 21 për Kulturë

Kultura dhe të drejtat e njeriut

- Kultura dhe zhvillimi njerëzor. Diversiteti kulturor si "një mjet për ta arritur një kënaqësi më të madhe intelektuale, emocionale, morale dhe ekzistencë shpirtërore".
- Të drejtat kulturore janë një pjesë integrale e të drejtave të njeriut. "Askush nuk mund të thirret në diversitet kulturor për t'i shkelur të drejtat e njeriut të cilat janë të garantuara me ligj ndërkombëtar, apo ta kufizojë fushëveprimin e tyre."
- Mekanizmat, instrumentet dhe burimet që garantojnë lirinë e shprehjes
- Ftesë për artistët që të angazhohen me qytetin, duke e përmirësuar bashkëjetesën dhe cilësinë e jetës, rritjen e kapaciteteve krijuese dhe kritike të të gjithë qytetarëve

Kultura dhe qeverisja

- Një rol të ri qendror të kulturës në shoqëri. Legjitimitet të politikave kulturore
- Cilësia e zhvillimit lokal varet nga gërshetimi i politikave kulturore dhe politikave tjera publike
- Qeverisja lokale: një përgjegjësi e përbashkët e qytetarëve, shoqërisë civile dhe qeverive
- Përmirësim të mekanizmave të vlerësimit në kulturë. Sistemi i treguesve kulturor
- Rëndësia e rrjeteve dhe bashkëpunimi ndërkombëtar
- Pjesëmarrja e qeverive lokale në politikat kulturore kombëtare dhe programe

Kultura, qëndrueshmëria dhe territori

- Diversiteti kulturor, i nevojshëm për njerëzimin siç është biodiversiteti për natyrën
- Diversiteti i shprehjeve kulturore sjell pasuri. Rëndësia e një ekosistemi të gjerë kulturor, me diversitet të origjinës, aktorëve dhe përmbajtjes
- Dialogu, bashkëjetesa dhe ndër-kulturat si parime themelore për dinamikën e marrëdhënieve të qytetarëve
- Hapësirat publike si hapësira kulturore

Kultura dhe përfshirja sociale

- Qasja në kulturë nëpër të gjitha fazat e jetës
- Shprehja si një dimension themelor i dinjitetit njerëzor dhe i përfshirjes shoqërore pa ndonjë paragjykim ndaj gjinisë, prejardhjes, varfërisë apo çfarëdo lloji tjetër të diskriminimit.
- Krijimi i audiencave dhe inkurajimin e pjesëmarrjes kulturore, si elemente vitale të qytetarisë

Burimi: Agjenda 21 për kulturë

2. Cilin fushëveprim për Trashëgiminë Kulturore?

Zgjerimi pothuajse i pakufizuar i konceptit të trashëgimisë kulturore është i destinuar që të sjell probleme. Kur gjithçka bëhet trashëgimi, çfarë do të mbetet? Shumë herët, në fillim të vitit 1902, Riegl kishte theksuar në librin e tij të famshëm "Le culte moderne des monuments" se ky kult do ta humbasë intensite-

tin e vet atëherë kur objektet gjithnjë e më shumë filluan të përfshihen në trashëgimi dhe antikiteti filloi të jetë më i rëndësishëm sesa rëndësia historike. Kur çfarëdo-qoftë dhe gjithçka që nuk i përket të tashmes bëhet trashëgimi, është e destinuar që të bëhet përsëritje e panevojshme dhe tepricë, pasi që ndërprerja në mes të kaluarës dhe të tashmes është anashkaluar në masë të madhe. Trashëgimia është një reflektim i përshtatshëm i së tashmes, e shkëputur nga kujtesa dhe historia²⁵.

Procesi i transformimit në Trashëgimi Kulturore

- Çfarë është përvetësimi?

Nëse disa elemente, duke ia filluar me monumentet, përfaqësojnë trashëgiminë më shumë sesa të tjerat, arsyeja për këtë është se ato janë bërë më të dukshme për komunitetin dhe kjo dukshmëri nuk vihet në pikëpyetje. Siç e paraqet F. Montpetit (1994, f.11), kur objektet të cilat janë pjesë e trashëgimisë së paluajtshme bëhen pika të fokusit dhe vendtakime të cilat tërheqin vëmendjen e vizitorëve, objektet e luajtshme bëhen më të pavërejtura; nuk kanë cilësi monumentale e as prezencë të përhershme të ndërtesave; për shkak të mungesës së ekspozimit dhe mungesës së vëmendjes nga mediat, ato lehtë mund të zhyten në harresë, të zhduken nga e tashmja dhe të humbin kontaktin me kulturën aktuale²⁶.

Atëherë si bëhen gjërat e prekshme dhe të paprekshme trashëgimi? Si është e mundur që në një moment të caktuar disa elemente të bëhen trashëgimi, kur ato nuk kanë qenë në të kaluarën dhe mund të mos mbesin të tilla në të ardhmen? Si është e mundur që disa objekte, të cilat nuk kanë pushuar ende të jenë të përdorshme, ose ende nuk kanë pësuar nga humbja e interesit, fitojnë vëmendje dhe të marrin një kuptim të ri? Problemi qëndron në të kuptuarit se nëse kjo dukshmëri është e transmetuar apo e trashëguar, ose nëse ajo është e qëllimshme dhe përfaqëson një përtëritje të interesit?

Disa elemente në fakt mund të përfitojnë nga një vëmendje e vazhdueshme e atillë, që prej momentit të paraqitjes së tyre, sepse tradita do të përkujdeset që ato ta mbajnë këtë status. Çdo brez ia transmeton këto kuptime brezit të ardhshëm përmes trashëgimisë, në këtë rast përmes të mirave materiale dhe përmes arsimimit apo emulacionit si në rastin e elementeve të paprekshme. Riprodhimi identik sipas disave ishte ligj i shoqërive primitive, ndërsa vazhdimësia e trashëgimisë nga një brez në tjetrin u bë domosdoshmëri me ndihmën e sjelljes

25 Riegl A.(1984), *Le culte moderne des monuments*, Le Seuil, Paris, p. 75

26 Montpetit F. (1994), *Essai sur la détermination du patrimoine*, Montréal : Presses de l'Université du Québec à Montréal

publike dhe përrallave mitike. Megjithatë, tani ky lloj i transmetimit është duke u bërë i rrallë.

Edhe pse nuk është detyrim për ne, pjesa më e madhe e trashëgimisë sonë tani me vetëdije zgjidhet nga ne. Shoqëria moderne nuk është më e ndikuar nga faktorët trashëgimor dhe traditës. Fitimi monetar luan një rol shumë të rëndësishëm në këtë proces. Kushtetuta e trashëgimisë moderne është më pak e varur nga vlerat e trashëguara simbolike dhe kulturore sesa në konsideratë të kujdesshme dhe zgjedhje kolektive. Ajo është e një natyre juridike ose politike. Një objekt nuk konsiderohet më të jetë pjesë e trashëgimisë sonë por jo për shkak të natyrës së vet, por sepse ai është rekomanduar për arsye të përshtatshme. Në anën tjetër, prishja e traditës ka çuar në shtimin e vendeve dhe miratimin e masave zëvendësuese në fushën e konservimit. Në një situatë të tillë ka gjasa që kohë-pas-kohe të sfidohet vlefshmëria e objekteve të trashëgimisë, sepse ato janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve të shpejta të sjelljes. E kaluara nuk është më faktor që merr vendim, «gjërat nuk janë njësoj sot»²⁷.

Në vend të zgjedhjeve të imponuara nga tradita, ekziston një përpjekje për t'i rivlerësuar dhe interpretuar objektet e trashëgimisë. Pas shkatërrimit të mekanizmeve të transmetimit tradicional, ne tani duhet të sajojmë mekanizma të rinj për t'i kuptuar gjërat që janë dobësuar ose janë në një gjendje kolapsi. Duke pasur parasysh se marrëdhëniet midis komunitetit dhe objekteve më nuk përputhen me rendin e natyrës, ne duhet të përpiqemi që ta kuptojmë se si formohen lidhje të reja dhe se si komuniteti do ta pranojë një trashëgimi.

- Cila është ajo gjë nga e kaluara që e paraqet e sotmja, për t'iu referuar në mënyrë konkrete?

Në radhë të parë ne mund të themi se trashëgimia para së gjithash është historike. Krejtësisht e kaluara është objekt i studimit, arkivat na japin trashëgimi arkivore, gërmimet na japin trashëgimi arkeologjike, koleksionet na japin trashëgimi muzeologjike e kështu me radhë. Por a nuk është atëherë një trashëgimi e specializuar nëse ajo jo domosdoshmërisht lidhet me kulturën e njerëzve të zakonshëm?

Në fakt, një objekt historik nuk është sistematikisht objekt trashëgimie. Le ta marrin rastin e një objekti të luajtshëm të cituar nga Heidegger: « *Antikitetet e konservuara në një muze si p.sh. një pjesë e mobilieve, i perkasin të kaluarës; megjithatë, këto gjëra vazhdojnë të ekzistojnë në të tashmen. Si mundet që ky objekt të jetë historik kur ai nuk është zhdukur me të kaluarën? A janë këto gjëra që vazhdojnë të ekzistojnë njëjtë siç ishin në të kaluarën? Padyshim që kanë ndry-*

shuar. *Me kalimin e kohës pjesa e mobilieve thyhet ose gërmitet nga krimbat. Por natyra specifike e së kaluarës së saj nuk gjendet në antikitetin e saj. Çfarë ka ndodhur me këtë rast? Asgjë përveç se bota është zhdukur brenda saj, duke qenë pjesë e një grupi të caktuar të mjeteve, ajo u paraqit si një instrument dhe ishte përdorur. Kjo botë nuk ekziston më. (Heidegger, 1988) »²⁸.*

Të gjitha gjërat që i shpëtojnë së kaluarës janë historike. Por vetëm disa prej tyre bëhen trashëgimi, sepse një komunitet apo një grup i personave i njohin ato si objekte të rëndësishme. Marrëdhënia e re që rezultojnë në mes të këtyre gjërave dhe komunitetit është ajo që ne e quajmë përvetësim. Prandaj del se trashëgimia është si pasojë e proceseve të përsëritura ose të ndërprera të përvetësimit dhe të ri-përvetësimit. Me fjalë të tjera «përzgjedhja e qëllimshme nuk ndodh vetëm në fillim të procesit të konservimit; *kjo është vetëm faza e parë e cila i bën të mundshme aktet e njëpasnjëshme të përvetësimit* »²⁹. Kjo e ka një rezultat të rëndësishëm. Kur të ndërliken me kontekstin e tyre origjinal, objektet e luajshme ose të paluajshme i nënshtrohen një procesi të vazhdueshëm të promovimit, përvetësimit dhe të ri-interpretimit në mënyrë që ato ta ruajnë rëndësinë e tyre kundrejt preokupimeve aktuale dhe mbesin pjesë e kulturës së sotme. Barthes e paraqet këtë shumë mirë kur thotë, « Çfarëdo që shoqëritë mund të mendojnë ose vendosin, vepra e artit shkon përtej tyre, përmes tyre, si një formë e cila është e pajisur pak-a-shumë me kuptime të rastësishme apo historike. *Një vepër arti është e përjetshme, por jo sepse ajo e imponon një kuptim të vetëm në persona të ndryshëm, por për shkak se ajo sugjeron kuptime të ndryshme tek një person i vetëm* »(Barthes, 1966) ³⁰.

Nga identiteti në shëmbëlltyrë

Tani besohet se trashëgimia dhe masat e përvetësimit që ndërliken me të janë rezultat i kërkimit të identitetit. Ne i ruajmë dhe i ekspozojmë objektet, sepse kjo është një mënyrë për ta portretizuar veten si të dallueshëm nga të tjerët. Kjo është arsyeja pse trashëgimia përshkruhet si kombëtare, evropiane, lokale, etj. Divergjenca shprehëse bëhen evidente dhe trashëgimia bëhet njëfarë reflektimi. Një objekt është më i përshtatshëm për t’u bërë pjesë e trashëgimisë nëse ai përmban apo shfaq tipare të veçanta. Kjo qasje ndaj trashëgimisë kishte dominuar shekullin e 19’të. Prodhimi kombëtar u bë një tregues i nivelit të civilizimit. Të dyja sferat edhe ajo publike edhe ajo private tentuan që t’ia tregojnë vetes avantazhin përmes posedimeve të tyre materiale, qoftë kjo një ndërtesë publike ose vendbanim privat.

28 Heidegger, *L’être et le temps*, Paris: Gallimard, pp. 180-2

29 Montpetit F. (1994), *Essai sur la détermination du patrimoine*, Montréal : Presses de l’Université du Québec à Montréal, p. 11

30 Barthes R. (1966), *Critique et vérité*, Paris: PUF, p. 51

Megjithatë, kjo qasje nuk është e bazuar aq mirë siç duket në shikim të parë. Le ta marrim institucionin e muzeve kombëtarë si "Louvre" (1793) dhe muzeun britanik (1753). Koleksionet që këta i mbajnë nuk kanë ndonjë karakter të veçantë kombëtar. Në të kundërtën, ekspozitat e tyre e kanë avantazhin të jenë paraqitje të civilizimit. Madhështitë e Greqisë antike apo Romës duket të jenë më të rëndësishme sesa portretizimi i shpirtit kombëtar. Ndërsa sa i përket vetë Francës, muzeu kombëtar i antikitetëve u krijua vonë në vitin 1867.

Në mënyrë të ngjashme, galeritë karakteristike ekspozojnë objekte natyrore ose artificiale si foto, vepra të artit, antikitete greko-romake, mostra të pazakonshme dhe gjëra tjera të çuditshme të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë me identitetin e grupit. Kjo qasje është gjithëpërfshirëse, e karakterizuar me kuriozitet dhe një kërkim filozofik dhe universal. Nëse ka ndonjë dyshim në lidhje me lidhjen esenciale midis trashëgimisë dhe identitetit në rastin e objekteve të paluajshme, do të ketë shumë më tepër kur është fjala për objektet e luajshme. Trashëgimia është shumë më tepër sesa një shprehje e identitetit.

Për këtë arsye ekziston një motivim themelor në lidhje me trashëgiminë, përkatësisht, kërkimi për shembuj. Kjo është shumë e dukshme gjatë përpjekjeve të para për t'i ngritur magazinat e trashëgimisë kulturore si muze të mëdhenj. Është vitale konservimi i objekteve që i përkasin Greqisë së lashtë të cilat përfaqësojnë idealet e bukurisë. Themelimi i Muzeut Louvre ishte justifikuar pjesërisht nga nevoja për t'iu ofruar referencë nxënësve dhe mësuesve, ku për disa ditë në javës muzeu ishte i rezervuar ekskluzivisht për ta.

Zgjedhja e shembujve nuk ishte e kufizuar nga cilësitë artistike apo estetike. Ajo shpejt fitoi një ngjyrë historike dhe politike. Ekspozitat janë një dëshmi jo vetëm për artin dhe historinë, por edhe për mençurinë e pushteteve të cilat e konsideruan të nevojshme për t'ia ofruar këtë spektakël të mrekullueshëm njerëzve. Por duke e miratuar këtë qëndrim në tentojmë që ta favorizojmë konformizmin dhe akademizmin pasi që modelet dhe novacionet nuk shkojnë së bashku.

Në një mënyrë më të përgjithshme, ne mund ta pyesim veten nëse ky rol tradicional i trashëgimisë është dalë jashtë mode. Në çfarë mënyre duhet estetika e së kaluarës të shërbejë si një referencë? Pse nuk munden teknikat e riprodhimit që të japin shembuj të cilësisë dëshiruar, të cilat do të na e mundësonin kursimin në operacionet e konservimit? Në fakt, ne mund ta pyesim veten nëse niveli i lartë i teknikave të riprodhimit nuk na lejon neve që t'i rikrijojmë të gjitha veprat e kaluara dhe t'i ndryshojmë qëndrimet tona në mënyrë që ato të bëhen të pranueshme si forma origjinale të artit. Kjo do të çonte në një jo-materializim të trashëgimisë, duke lejuar përvetësim distance dhe ndoshta edhe një ndryshim në referencat estetike.

3. Trashëgimia paqëllimshme, Vlera përkujtimore dhe Përdorimi Demokratik

Në një epokë kur antenat televizive janë duke u shumëzuar, vendet vazhdimisht janë duke bërë hapa për ta menaxhuar trashëgiminë e tyre dhe ta rregullojnë atë në emër të interesit kombëtar. Përveç monumenteve dhe objekteve të cilat janë të krijuara për ta mbajtur një kujtim të gjallë, ka një shumim të monumenteve të paqëllimshme të cilat janë duke u deklaruar si trashëgimi. Ato nuk e kanë për qëllim që t'i përkujtojnë gjeneratat e tashme dhe të ardhshme për të kaluarën e tyre, por për ta rrënjosur në gjeneratën tonë kujtesën për një periudhë, një komunitet apo një ngjarje.

Vlera përkujtimore të cilën Alois Riegl e ndan në dy vlera janë: e para, vlera historike e një objekti i cili e ilustron një moment në histori dhe e dyta, antikiteti i një objekti apo një monumenti i cili e ilustron efektin e kalimit të kohës, një test nëpër të cilën ai i nënshtron këto objekte dhe monumente.

Sipas Riegl, vlera e dytë është më e rëndësishme pasi që ajo mund të çmohet nga të gjithë, pa ndërhyrjen e specialistëve. Më shumë se vlera historike, antikiteti mund ta mbështetë konsumimin e popullarizuar të trashëgimisë në mënyrë që trashëgimia të mund të bëhet objekt i turizmit ose të paktën një atraksion shtesë. Në rastet kur vlera historike e trashëgimisë nuk shfrytëzohet në mënyrë të kënaqshme, antikiteti i saj duket ta ketë një atraksion më demokratik dhe prandaj ka më shumë gjasa që të krijohet një treg i gjerë ekonomik³¹.

Kriteret e Konventës së Trashëgimisë

A është e mundur që të shkohet përtej këtyre analizave dhe të shpjegohen modalitetet për zgjerimin e trashëgimisë?

Mund të thuhet se trashëgimia nuk ekziston teorikisht edhe nëse janë të pranishme kriteret e identitetit, shëmbëlltyrës dhe përkujtimit, duke ofruar mjete të pranueshme shpjeguese. Për të qenë më të saktë, një element apo një objekt bëhet pjesë e trashëgimisë sipas kushteve të një konvente. Siç thotë *JF Léniaud*, një objekt bëhet pjesë e trashëgimisë posa që ai e humbet përdorimin e vet në fund të një procesi të adoptimit, të cilin disa e quajnë përvetësim e të tjerët marrje të monumenteve (JP Sartre). Ky proces i të bërit pjesë e trashëgimisë kryhet nga ndërmjetës, më të shquarit prej tyre në shtet, në bazë të disa kriterëve shumë precize, përveç atyre të përmendura më herët, përkatësisht, identiteti, shëmbëlltyra dhe përkujtimi³².

I pari prej këtyre kriterëve është komunikimi. Një objekt bëhet pjesë e trashëgimisë, sepse ai është shumë domethënës për një komunitet. Ekzistenca e tij bëhet

31 Riegl A.(1984), *Le culte moderne des monuments*, Le Seuil, Paris

32 Léniaud (1992), *L'utopie du patrimoine*, Paris

mjet simbolizmi për historinë ose ndarja e vlerave me të tjerët. Por në cilëndo prej këtyre dy rasteve mund të ndryshojë kuptimi me kalimin e kohës.

Kriteri i dytë është cilësia e tij shkencore. Një objekt bëhet pjesë e trashëgimisë, sepse ai mund të njihet si me vlerë të madhe historike dhe artistike dhe si i pazëvendësueshëm. Ky kriter përdoret shpesh, ndryshe nga ai i mëparshmi, për t'ia mundësuar objektit apo monumentit që të mbetet pjesë e trashëgimisë, kur vlera e tij e komunikimit nuk është më e perceptueshme.

Kriteri i tretë është ekonomik. Një objekt bëhet pjesë e trashëgimisë sepse ai ka një vlerë ekonomike dhe zhdukja e tij do të ishte humbje për komunitetin. Kështu që materialet e rralla dhe të vlefshme të përfshira në një monument antik mund ta ruajnë atë. Por është e nevojshme që të jemi të matur pasi që ky kriter është i kthyeshëm dhe mund të çojë në shkatërrimin e një monumenti me heqjen e disa elementeve të vlerës ekonomike të përfshira në monument, të cilat nuk kanë përdorim monetar për aq kohë sa mbesin në të!

4. Një çështje kryesore: Muzetë evropianë në një kohë krize

Një univers heterogjen

Muzetë evropianë tregojnë shumëllojshmëri të madhe në aspektin e temës dhe statusit ligjor.

- Sa përket temës, referencë e zakonshme vazhdojnë të jenë Muzetë e Arteve të Bukura, të cilave iu është shtuar historia, arti modern dhe/ose bashkëkohor dhe muzetë e shkencës/teknologjisë. Për gati dyzet vjet, ne kemi parë edhe dukjen edhe shumëzimin e komunitetit dhe të eko-muzeve, për të cilët paraqitja shtrihet më pak në valorizimin e një koleksioni ekzistues, sesa në dëshirën për ta ri-afirmuar apo rindërtuar imazhin ose identitetin e një rajoni.
- Sa përket statusit ligjor, ne i gjejmë katër kategori kryesore: Muzetë Shtetëror që gëzojnë një autonomi më të madhe ose më të vogël, por larg më pak sesa numri që besohet në përgjithësi (zakonisht 3% deri në 7%, varësisht prej vendit); muzetë që u përkasin autoriteteve lokale, kryesisht komunave, të cilat i nënshtrohen menaxhimit duke kaluar prej një mungese të plotë të autonomisë në burime të jashtme të caktuara (zakonisht 40% deri në 45%, nga të cilat katër-të-pestat shkojnë për komunat); muzetë e kompanive, relativisht në numër të vogël, por pak a shumë të rëndësishme (rreth 3% deri në 5%); muzetë privat, që funksionojnë në bazën fitimprurëse (5% deri në 10%), muzetë e menaxhuar mbi një bazë jofitimprurëse, nga fondacionet, shoqatat, fondet e përbashkëta, etj (rreth 30%).
- Sa i përket madhësisë, muzetë dhe galeritë ndryshojnë në aspektin e ko-

leksioneve dhe mjeteve demografike të vendosjes. Ky heterogjenitet është i përhapur nga natyra e aktiviteteve të ndërmarra, pasi që burimet e tyre financiare dhe njerëzore ndryshojnë aq shumë. Ky konstatim mund të shihet gjatë dekadës së fundit në dallimin mes muzeve ‘super yll’ dhe të tjerëve. Ndërsa super yjet karakterizohen nga statusi i tyre ‘artistik’, ndërtesat e tyre arkitektonike, ekspozitat e tyre dhe numri i vizitorëve, ekzistojnë mijëra muze të vogël që hapen disa ditë në javë, duke i ekspozuar koleksionet që ishin trashëguar më parë, duke ofruar shërbime të siguruara nga vullnetarët, duke mos pasur shpresë se ndonjëherë do ta arrijnë qëndrueshmërinë financiare dhe thjesht duke shpresuar se edhe në të ardhmen do t’i mbajnë dyert e tyre të hapura. Sigurisht që këto dallime mund të lidhen me buxhetet e tyre, ashtu siç edhe e tregojnë shumë mirë krahasimet kombëtare. Në rastin e një shteti federal, si atij të Gjermanisë, shteti North Rhine-Westphalia shpenzon 1.35 milion euro, i pasuar nga Bavaria: 984 milion euro, Bremani: 97.5 milion euro, dhe Saarland: 52.8 milion euro (Kulturfinanzbericht 2008: 21).

Një realitet shqetësues

Çfarëdo qofshin profilet e muzeve, me një përjashtim të vogël, duhen të përballen me një realitet të zymtë financiar, në shumë raste i përforcuar nga mungesa e vizitave dhe/ose mos-rinimi i vizitorëve. Njëra nga pyetjet e anketimit tonë u përqendrua pikërisht në mënyrën se si muzetë e kishin përjetuar krizën e vitit 2008. Pothuajse të gjitha përgjigjet njëzëshëm theksuan se gjendja e tyre është gjithnjë e më shumë shqetësuese, ose duke u përkeqësuar. Disa muze duket se i kanë ikur pasojës së saj - ndoshta disa muze privat - dhe shumë shpesh ata ankohen për një grumbullim të vështirësive të cilat çojnë në situata të vështira për tërë stafin (Portugali). Muzetë të cilët nuk ankohen janë ata të cilët thonë se gjoja ata e kanë parë situatën duke u përkeqësuar shumë kohë para krizës (Gjermani)!

- Njëra ndër efektet e para të ndjera të kriza, ne vërejtëm kontribute më të ulëta financiare nga autoritetet lokale dhe/ose qeveritë qendrore, më ulët për 3% në 30%, për vitin 2008, që ishte viti i parë i krizës. Sjellje shqetësuese janë duke u shfaqur përgjatë linjave të njëjta. Për shembull, njerëzit që vinin në qytet për trajtim në ujëra termale (spa) ndaluan së vizituar muzeun lokal (edhe pse tarifa e hyrjes ishte 2€!);
- Familjet po vijnë më pak dhe po shpenzojnë më pak në dyqane;
- Industria e mikpritjes tenton që t’i rris çmimet për ta kompensuar zvogëlimin e numrit të turistëve, i cili krijon një rreth vicioz, pasi që kjo çon në një rënie të mëtejshme të konsiderueshme të turistëve;
- Reduktimi i fuqisë punëtore, për shkak të politikave shtetërore për të mos e zëvendësuar personelin derisa ata të dalin në pension, rezulton në një rritje

të moshës mesatare të personelit të muzeve (shih shtojcën, studimi i rastit n°1). Ne assesi nuk mund të japim gjykime për dallimin në cilësinë e shërbimeve të dhëna, por nga ana tjetër, mund të sugjerohet se politika padyshim nuk është duke bërë asgjë për ta reduktuar distancën reale apo simbolike e cila mund të ekzistojë në mes të muzeve dhe segmentit të ri të popullsisë;

- Për shumë muze nuk është një çështje e harresës së një viti të krizës, por fillimi i shkurtimeve financiare veçse të shpallura në disa vende (Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Franca), që do të vazhdojë gjatë viteve të ardhshme. Kjo padyshim se do të ketë ndikim në aktivitetet si dhe në disa lloje të ndryshme të burimeve në dispozicion nga muzetë;
- Sa i përket aktiviteteve, ekziston një rënie e përgjithshme në ekspozita dhe programe të cilat i kanë për objektiv audiencat, sidomos atë të rinisë (muzetë në Republikën Çeke, mbi një e pesta mbi mesataren në muzetë rumune);
- Institucionet arsimore janë gjithnjë e më shumë ngurruese për t'i mbajtur aktivitetet e tyre kulturore dhe udhëtimet;
- Ndalimi i aktiviteteve të cilat nxisin vizitorët e ka pasur efektin e kthimit të periudhave të ulëta të sezonit në periudha gati të vdekura (Estoni);
- Ne gjithashtu vërejtëm ndalimin e punës së konservimit apo renovimit e ndërtesave dhe rrethinave të saj (Kroaci, Francë), një ulje e buxhetit për blerje, një ndalim në investimet për rekrutim të stafit të kualifikuar (Mbretëria e Bashkuar, Franca), mos ripërtëritja e 'detyruar' e pozitave të lëna të hapura për shkak të daljes në pension dhe madje edhe largimi i menaxherëve kompetent, të cilët nuk e kanë ndërmend që të presin shkurtim në pagat reale dhe për këtë preferojnë që të largohen nga sektori i muzeve (Mbretëria e Bashkuar).
- Implementimi i fushatave të anëtarësimit, pashmangshëm të kushtueshme edhe nëse mund të shpresohet për rezultate pozitive, ishin ndërprerë, pasi që ato përfshijnë shpenzime fillestare të cilat nuk janë më të mundshme për t'u ndërmarrë edhe ashtu vonesat për marrjen e parave të reja janë edhe më të gjata (Spanjë);

Partneritetet financiare gjithashtu janë në rënie:

- Sponzorimi është në rënie, kompanitë janë duke i anuluar apo duke i ulur kontributet e tyre;
- Është gjithnjë e më e vështirë që të përmbushen kufizimet e granteve përputhëse dhe për disa muze është madje e pamundur për t'i paguar tarifat e kërkuara apo vullnetare. Të cilat do t'iu jepnin atyre qasje në burime të rrjetit (Hungari, Rumani);
- Për t'i përmbledhur të gjitha, ne e shohim një rezultat disi të papritur këtu: rënia e numrit të vullnetarëve, ku disa kishin kanë pritur që ata të jenë si faktor rezervë për vështirësitë me të cilat përballën (Austri). Kjo mund të

shpjegohet me faktin se këta vullnetarë janë tani duke e kushtuar më shumë kohën e tyre për ato që tani janë bërë detyra më urgjente në kontekstin e ri ekonomik. Komunitat gjithashtu theksojnë se kriza ka pasur shumë efekte në muzetë e tyre. Rënia e burimeve financiare, qofshin ato nga tarifat e hyrjes, grantet ose sponsorimet, çojnë në rënie të investimeve, ngjarjeve dhe ekspozitave, derisa kthimi i publikut, ose tërheqja e një audience të re varet aq shumë nga shpeshtësia dhe intensiteti i ngjarjeve. Në një afat të mesëm, këto efekte do të vazhdojnë si kërcënime për mirëmbajtjen dhe ruajtjen. Disa komuna gjithashtu theksojnë se cilësia artistike e disa aktiviteteve është duke u vënë në pikëpyetje pasi që është duke u bërë gjithnjë e më e vështirë sjellja e njerëzve me talente të rralla, ose me njohuri teknike. Rezultati i vetëm që nuk është negativ por marginal, sipas disa komunave dhe muzeve, është fakti se ky ngushtim i lirisë së veprimit ka çuar në një kërkim për partneritete të reja mes institucioneve kulturore, ose me organizata të tjera në zonë, ose ka çuar që njerëzit lokal t'i vizitojnë objektet e tyre gjatë festave të tyre apo kohës së lirë, në vend se të udhëtojnë, për shkak të krizës ekonomike (Francë, Finlandë, Gjermani). Por edhe një herë, marginat e ngushta financiare i kufizojnë mundësitë që mund të gjenden këtu, të paktën tani për tani.

5. Si duhet të menaxhohet kultura për ta mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm?

Çka duhet të bëhet në mënyrë që efektet e përshkruara më lart të mund të mobilizohen në mënyrë efektive në favor të zhvillimit të qëndrueshëm? Dhe në terma më të përgjithshëm, çka duhet të bëhet në mënyrë që trashëgimia kulturore të mund ta përmirësojë zhvillimin e qëndrueshëm, në aspektin e vlerave dhe sjelljeve duke e theksuar dimensionin njerëzor për një zhvillim të tillë. Nuk është në pyetje vetëm roli i kulturës si shtylla e katërt, por i integritetit të kulturës si një element themelor i zhvillimit të qëndrueshëm.


Përpara këtyre efekteve, janë disa burime të cilat ose mund të trashëgohen ose të krijohen, por të cilat duhet të ruhen ose të riprodhohen në çdo rast. Faktori përcaktues në një rast të tillë është aftësia jonë për ta kontrolluar këtë proces, i cili i kombinon veprimet publike dhe private, pavarësisht nga lloji i trashëgimisë në fjalë. Atëherë, ajo që është e rëndësishme është menaxhimi efikas i trashëgimisë kulturore.

Pa e bërë një studim në detale, ne do të donim t'i theksojmë elementet e mëposhtme:

- ✓ Trashëgimia kulturore varet nga një numër i madh i akterëve, veprimet të cilëve duhet të koordinohen. Ky është një tregues i ndryshimit të kon-

ceptit, pasi që trashëgimia kulturore nuk trajtohet më si një e mirë kolektive (ose pasuri), por si një e mirë e përbashkët (ose pasuri);

- ✓ Produkti i një numri të madh të veprimeve, trashëgimia kulturore përfundon duke marrë cilësi variabile e cila mund ose jo t'i mbajë elementet të cilat kanë qenë kontribut i veprimeve të anëtarëve të shoqërisë përkatëse. Nga kjo pikëpamje, trashëgimia kulturore përfiton duke u konsideruar si një ekosistem, zhvillimi i së cilës duhet të jetë i qëndrueshëm dhe kjo qëndrueshmëri do të varet nga përkujdesja e ofruar nga një shoqëri për trashëgiminë e vet kulturore.
- ✓ Kur të integrohet në një komunitet apo territor, trashëgimia kulturore bëhet një makinë për promovimin e kohezionit shoqëror, por ai gjithashtu mund të shkaktojë rritje të tensioneve dhe konflikteve. Atëherë dimensionin territorial të trashëgimisë kulturore e luan një rol vendimtar, siç është parë në prodhimin e peizazheve kulturore.
- ✓ Ashtu si në çdo vend-punishte, iniciativat për mbështetje të trashëgimisë kulturore duhet të vlerësohen, por metoda e vlerësimit duhet ta respektojë diversitetin e shprehjes kulturore, e cila i jep një karakter të veçantë një vlerësimi të tillë.



Nga administrimi i një të mire kolektive deri në administrimin e një të mire të përbashkët

Njerëzit që analizojnë mallrat kulturore nga një perspektivë ekonomike kanë prirje që t'i trajtojnë ato si mallra kolektive dhe pastaj deklarojnë se qeveria, qoftë ajo qendrore apo lokale, është përgjegjëse për qëndrueshmërinë e tyre.

Ata e mbështesin teorinë tradicionale ekonomike, sipas së cilës tregu mund të dështojë në mbështetjen e prodhimit të mallrave kolektive, ndërsa qeveritë i kanë në dispozicion instrumentet e tyre për ta bërë këtë të mundur. Kjo qasje i krijon tri probleme:

- ✓ E burokratizon kulturën dhe e bën qëndrueshmërinë kulturore krejtësisht të varur në zgjedhjet që i merr politika;
- ✓ Nuk mund të thuhet se mallrat kulturore mund të prodhohen vetëm nga qeveria, pasi që historia e sistemeve kulturore tregon se shumë mallra vibrante dhe novatore të kulturës janë prodhuar nga tregu.

Kjo lutje në favor të dimensionit kolektiv për një të mirë kulturore duhet të mbështetet nga një seri argumentesh, të tilla si qasja e mallrave dhe shërbimeve falas, barazisë shoqërore, besimin se “kultura na bën më të mirë” e kështu me radhë. Pra, është më interesante nëse i konsiderojmë mallrat kulturore si as kolektive e as private, por si të mira të përbashkëta. Ato përcaktohen në fushën e ekonomisë si mallra cilat janë rivale dhe jo përjashtuese. Kështu që, ato e përbëjnë njërin nga katër llojet kryesore të tipologjisë më të zakonshme të mallrave, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme: nëse konsumi i një të mire nga një person e pengon konsumin e saj nga një person tjetër (rivaliteti) dhe nëse është e mundur që të përjashtohet një person nga konsumimi i një të mire (përjashtimi).

Ky koncept i të mirave të përbashkëta është zhvilluar kryesisht në fushën e mjedisit, për ta theksuar faktin se duke i përdorur këto mallra siç ne kemi qejf, ne mund ta zvogëlojmë disponueshmërinë e tyre për të tjerët (çështje barazie) që shpie deri tek shterimi i këtij burimi (çështje qëndrueshmërie). Përderisa kërkesa për të mira të tërhequra nga e mira e përbashkët nuk e kalon një nivel të caktuar, rendimentet e ardhshme nuk do të zvogëlohen dhe e mira e përbashkët (apo cilësia e tij) si e tillë ruhet. Pra, nuk është e gabuar nëse thuhet se këto mallra të përbashkëta rezultojnë nga kombinimi i drejtë apo i gabuar i vendimeve të decentralizuara. Një sistem i veçantë rregullativ ose administrim është i nevojshëm për ta mbështetur këtë lloj burimi. Nëse qasja në një të mirë të përbashkët është e rregulluar në nivel të komunitetit, duke ia kufizuar përdorimin e saj anëtarëve të komunitetit dhe duke imponuar kufizime mbi sasinë e mallrave të tërhequra nga malli i përbashkët, ‘tragjedia e të përbashkëtave’ mund të shmanget. Të mirat e përbashkëta të cilat mbahen falë një marrëveshjeje institucionale të këtij lloji, referohen si grumbullim i burimeve të përbashkëta. [Grefe & MAUREL, 2009]

Por është e vështirë që mallrat kulturore të konsiderohen si mallra të mjedisit: Kjo supozon që çdo e mirë e marrë parasysh këtu definohet nga një kapacitet mbajtës ose një sasi minimale e vetë-riprodhimit, e cila nuk është karakteristika kryesore e mallrave kulturore: disa përshtaten me këtë definicion (p.sh. një performancë në një hapësirë të mbyllur), të tjerat nuk përshtaten (p.sh. një krijim

letrar). Analogjia me të mira të përbashkëta i referohet një dimensionit tjetër: sjellja e disa njerëzve mund të krijojë leverdi më të lartë ose më të ulët për të tjerët. Le t'i paraqesim dy ilustrime:

- ✓ Kur disa njerëz e rrisin nivelin e tyre të kuptuarit përmes praktikave kulturore, ata i bëjnë përpjekjet e të gjithë anëtarëve të komunitetit më efikase;
- ✓ Kur disa njerëz e shkatërrojnë një burim kulturor - dhe praktikat kulturore që ai e mbështet - ata e privojnë komunitetin nga një burim potencial i mirëqenies.

Për këtë arsye, burimet kulturore dhe mallrat mund të konsiderohen si të mira të përbashkëta. Rezultati kryesor i këtij këndvështrim të ri është të kuptuarit që shumë burime kulturore do të prodhohet dhe riprodhohet nga një grup i forcave që veprojnë pozitivisht ose negativisht. Një sistem i veçantë rregullativ është i nevojshëm. Por ky nuk do të jetë sistematikisht efikas, pasi që atij i duhet të ndikojë në sjelljen private që ta marrë vendimin e duhur. Kështu që ne e shohim dallimin në mes të mirave kolektive dhe të përbashkëta kur e analizojmë kulturën. Ndërsa mallrat kolektive kanë nevojë për vendim publik, e cila është përgjegjësi e qeverisë, të mirat e përbashkëta kanë nevojë për një përzierje të vendimeve private-publike, e cila vjen nën qeverisje. Nëse të mirave të përbashkëta iu jepet rëndësia e merituar, kjo është shumë domethënëse. Roli dominues i të mirave të përbashkëta në jetën tonë mund ta shpjegojë sjelljen bashkëpunuese, veprimet altruiste, besnikërinë, mbizotërimin e besimit, ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore, rolin e të ashtuquajturës sfera e tretë dhe mënyrën se funksionojnë artet; për më tepër, ai kujdeset deri në një masë për problemin e gratisit dhe fenomenin e faktorëve të jashtëm.

Kjo nënkupton progres, por ne duhet të jemi shumë të qartë. Një e mirë e përbashkët nuk do të thotë se një qeveri qendrore ose vendore duhet ta përcaktojë se çfarë është e përbashkët. 'Të mirat e përbashkëta' këtu i referohen rruajtjes dhe prodhimit bashkëpunues dhe të drejtave kolektive të përdorshme nga njerëzit, në përputhje me "kulturën" e vet [Klamer, 2004].

Çdo komunitet i zhvillon normat dhe rregullat e veta për mbikëqyrjen e burimeve të saj kolektive në një mënyrë të qëndrueshme. Dhe përdoruesit e burimeve mund të marrin pjesë në procesin e prodhimit duke kontribuar në nivelin lokal me idetë e tyre, mësimin, imagjinatën, debatet dhe me veprimet vetë-korrigjuese. Por ne nuk duhet të harrojmë se mund të ketë mospajtime të forta për shkak të kërkesës për shkatërrim! Sistemet e decentralizuara vetëqeverisëse të bashkë-prodhimit gjithashtu ofrojnë qasje më të drejtë ndaj burimeve (dhe kështu efikasitet më të lartë) sesa që mund të fitohet nëpërmjet ndërmarrjeve shpërndarëse të operuara si monopole private apo hierarki shtetërore. Prandaj, mallrat e zakonshme që janë të menaxhuara drejtpërdrejt dhe në nivel lokal janë

një sferë e prodhimit dhe qeverisjes e cila nuk është më një e mirë publike, të paktën për aq kohë sa konfliktet nuk e mbështesin nevojën për veprim të pastër publik së bashku me qeverisje të pastër publike. Kjo është arsyeja pse sistemi i ri rregullativ që është paraparë duhet të veprojë si një stimulim dhe të jetë aq i drejtë sa të jetë e mundur.

Ai gjithashtu mund të ketë nevojë për modele të reja institucionale si truste. Për t’i menaxhuar pasuritë kulturore në mënyrë kolektive dhe efikase, do të ishte e dobishme nëse krijohet një entitet juridik të quajtur trusti i përbashkët. Administruesi i besuar e përkufizon përdorimin e burimeve sipas metrikave jo-monetare të nën-gjeneratave të tilla si qëndrueshmëria, cilësia e jetës dhe mirëqenia. Trusti mund t’ia japë me qira një pjesë të burimeve të cilat e tejkalojnë limitin: sektorit privat ose bizneseve shtetërore dhe kompanive publike për ekstraktim dhe prodhim. Një përqindje e kësaj qiraje tatohet nga shteti dhe i rishpërndahet qytetarëve si dividend ose si të ardhura për mbijetesë, me theks të veçantë tek të varfrit dhe të klasës së ultë. Duke i përcaktuar interesat dhe duke i mbështetur të drejtat e të pa-përfaqësuarve, rrjetet globale, organizatat joqeveritare, shoqatat qytetare dhe lëvizjet sociale janë bërë një zë i mirëfilltë i opinionit publik global.

Si katalizatorë për integrimin e prodhuesve dhe konsumatorëve, shumë organizata zhvillohen në truste të përbashkëta apo ortakëri me ta. Kjo mund të ndihmojë në zgjidhjen e konflikteve monetare si dhe atyre jo-monetare, afatshkurtra dhe afatgjata, çështjeve të pastra private dhe atyre të pastra publike. Të mirat e përbashkëta i bëjnë njerëzit që të jenë pjesëmarrës aktiv, derisa tregu dhe veprimet publike nga lartë-poshtë i bëjnë ata klientë ose grupe të synuara. Duke u bërë pjesëmarrës aktiv ka gjasa që aftësia e tyre të ngritet dhe kjo ngritje do të kontribuojë në një ekuilibër më të qëndrueshëm midis prodhimit dhe konsumit. Siç thotë Klammeri, *“Kjo do t’i zgjidhë kontradiktat aktuale mes idealeve internacionaliste të grupeve të shoqërisë civile për rishpërndarjen e burimeve natyrore dhe sociale dhe frikën e tyre institucionale për përmbysjen e kufizimeve kushtetuese për një qasje të barabartë, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e këtyre gjërave të përbashkëta”. Me nxitjen e prodhimit kolektiv dhe administrimin e të mirave të përbashkëta përmes formave të reja të kujdestarisë (në vend të pronësisë private/publike), shoqatat e pazgjedhura dhe lëvizjet e vetë-emëruara të shoqërisë civile nuk do të jenë më të papërgjegjshme para njerëzve që pretendojnë se i ndihmojnë dhe i mbrojnë* [Klamer, 2004, f. 12]. Në vend të fuqizimit të të tjerëve, ne do ta fuqizojmë veten tonë, i cili është pikërisht qëllimi i kulturës.

Partneriteti duket mjaft i rëndësishëm në këtë kontekst. Duke punuar në partneritet me komunitetin dhe grupet e treta sektoriale, organizatat e trashëgimisë kulturore mund ta zhvillojnë të kuptuarit e tyre të nevojave të grupeve të ndryshme dhe ta integrojnë të mësuarit që ka për bazë komunitetin në punën e tyre, në mënyrë që të ofrojnë shërbime cilësore, derisa i ndërtojnë kapacitetet e tyre.

Përfitimet e të punuarit në partneritet janë: rezultate më cilësore për individë dhe organizata; qasje në një gamë të gjerë të financimit duke adresuar agjenda të shumta të politikave, ekonomitë e shkallës, sinergjitë dhe plotësimet e projektit; mundësitë për ndarje të ekspertizës midis personelit të plotësuar; të mësuarit ndër-profesional; aftësia për të arritur një audiencë më të gjerë dhe më të larmishme. Partneritetet mund të jenë të kushtueshme dhe vështirë për ti mbajtur; ata mund të mbështeten shumë në individë kyç të cilët mund të avancojnë, të cilët mund ta ngadalësojnë procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, kur ka partneritet mes individëve dhe agjencive me strategji të qarta që merren me këto çështje, përfitimet mund të jenë të mëdha. Partneritetet efektive nuk ndodhin thjesht në secilin dhe në të gjitha nivelet, ato kërkojnë qartësi të qëllimit, planifikim efektiv dhe veprim dashamirës.

Më konkretisht, ndërtimi i partneriteteve efektive kërkon: identifikimin e agjendave të përbashkëta të politikës për t'i ofruar publikut përfitim dhe vlera të qarta; identifikimin e fushave në të cilat organizatat mund ta plotësojnë njëra-tjetrën ose t'i sjellin anët e forta të tyre për të ofruar rezultate të cilësisë së lartë; për të arritur progres përtej burimit-konkurrues të mundësive për të siguruar financim të projektit i cili mbështetet dhe është në përputhje me programet kryesore të politikave; përfshirë këtu vlerësimin e paanshëm. Së bashku me vlerësimin e projekteve individuale, krijimi i vlerësimit të jashtëm të partneritetit është pjesë e rëndësishme e procesit të mësimit dhe zhvillimit dhe kjo mund të shpie në partneritete më të forta dhe më të qëndrueshme.

6. Peizazhet Kulturore si Shtytës i Zhvillimit

Tradicionalisht, kontributi më i dukshëm i peizazhit urban për zhvillimin qëndron në aftësinë e tij për t'i tërhequr turistët dhe efektet pasuese pozitive mbi të ardhurat, shpenzimet dhe punësimin. Potenciali ekonomik i peizazheve për territorin është i ngjashëm me një potencial eksporti, përveç se në këtë rast nuk janë shërbimet ato që eksportohen por konsumatorët të cilët sillen brenda. Në vitet e fundit, peizazhet urbane janë bërë të njohura si burime kulturore (përfshirë ato mjedisore), dhe ato tani konsiderohen të kenë një ndikim në zhvillim ekonomik të krahasuara me ato të burimeve të tjera kulturore.

Por, aktivitetet kulturore do të kenë ndikim më të madh në qoftë se janë të përfshirë njerëzit lokal. Clark dhe Alii ndërhyjnë në literaturën urbane që është në rritje, duke paraqitur argumente se efektet e globalizimit të bazuara në rritjen e të mirave janë bërë forcë lëvizëse prapa rinovimit dhe zgjerimit urban. Ata sugjerojnë për një teori të re të rritjes urbane, një e cila i përgjigjet kërkesës për ndërrim nga rritja e ndashme e kategorizuar nga mbështetja e tyre për klientët deri tek të mirat publike dhe të përbashkëta, si dhe një ndërrim nga rritja e pastër ekonomike në një strategji më të kontrolluar dhe më të menaxhuar të

rritjes. Një mënyrë për ta arritur këtë është shpërndaja e investimeve, përfshirë këtu edhe investimet kulturore, në tërë qytetin, duke e lënë qendrën urbane dhe duke lëvizur drejt periferive të lagjeve etnike, shpesh me të ardhura të ulëta dhe që vuajnë nga efektet e lëvizjes periferike. Kohëve të fundit, një vëmendje në rritje i është kushtuar trashëgimisë artistike dhe kulturore në nivel lagjeje dhe avokatët e rinj të artit po përqendrohen në potencialin ekonomik vetë-gjenerues të burimeve vendase kulturore. Shfaqja e lagjeve apo zonave të pa favorizuara urbane që janë përjashtuar në aspektin shoqëror dhe në atë gjeografik kërkon që ne të zhvendosemi nga i padobishmi "unë" në më efektiv "ne".

Se a ka një territor një strukturë produktive apo jo, nuk varet vetëm nga teket e investimeve, zhvendosjes industriale, apo disponueshmërisë së kapaciteteve menaxhuese, gjithashtu varet edhe nga vlerat të cilat i ka komuniteti dhe të cilat mund ose nuk mund të bëjnë që anëtarët e saj të kenë prirje për ti inkurajuar këto iniciativa, ose për t'i parandaluar aktivitetet ekzistuese nga zhdukja, përmes mos ofrimit të njohurisë teknike. Pasi që sistemet e përfaqësimit, ashtu edhe peizazhet kulturore mund t'i përfshijnë këto lloje të vlerave. Për shembull, ata mund ta distilojnë dhe përhapin një kulturë të projekteve duke i bërë njerëzit lokal që të jenë në gjendje që t'i identifikojnë të mirat dhe shërbimet e reja, si dhe hartimin e mënyrës përkatëse së të bërit. Seria e dytë e vlerave është më "shoqërore": Mënyrat e të bërit kontakt, pikat e përbashkëta të referencës, si dhe marrëdhëniet e besimit që ofrojnë të dyja, ngritën dhe rrjedhin prej tyre duke përbërë thelbin e zhvillimit lokal. Sot, ky debat mbi rolin e kulturës dhe zhvillimit lokal ka tendencë që të zhytet në nocionin e kapitalit social. Ndërsa referencat e zgjedhjes dikur mund të kenë qenë të Weber-it ose de Tocqueville, konteksti historik na ka drejtuar tek kërkimi i nocioneve të rrjeteve, partneriteve, dhe besimeve.

Për të fituar mbështetje për sa i përket ruajtjes së peizazheve kulturore, ngritja e çështjeve të tilla është e mundur si për etikën e maturinë ashtu edhe për moralin e ndërgjegjes. Por, ne nuk mund t'i konsiderojmë individët krejtësisht autonom pasi që janë të ndërvarur për aq kohë sa përballen me kufizime kolektive siç janë mungesa e burimeve ose efektet e jashtme të zhvillimit teknologjik. Gjithashtu është e nevojshme që të marrim parasysh marrëdhëniet e mundshme në mes komplekseve alternative sociale dhe cilësisë së peizazheve kulturore. Kështu pra janë të mundura tri pikëpamje:

- ✓ Komuniteti racional është komunitet i individëve të cilët e shohin shoqërinë si konstrukt artificial dhe qeverinë si një mekanizëm të errët që në rastin më të mirë tolerohet si një domosdoshmëri e padëshirueshme. Në qendër të kësaj qasjeje është individi i motivuar nga interesi vetjak, i udhëhequr nga arsyeja dhe i mbrojtur nga të drejtat. Ky model mund të shihet në procesin politik: kjo është parë gjithmonë si kënaqje e in-

teresave të veçanta përmes një procesi të konkurrencës politike. Disa ndryshime mund të bien ndesh me këtë model: para ndotjes dhe efekteve të jashtme negative, mund të ndërmerren veprime kolektive për t'i mbrojtur dhe ruajtur peizazhet kulturore. Por, kjo është një pamje shumë konservatore e frymëzuar nga parimi i parandalimit, kur problemi identifikohet në mënyrë të qartë, analizohet dhe pranohet si legjitim. Në një komunitet të tillë, peizazhet kulturore do të jenë të mbrojtura pak-a-shumë prej sfidave të rënda apo edhe atyre të pakthyeshme.

- ✓ Komuniteti moral prodhon lidhje të shumta në mënyrë që anëtarët e një komuniteti të mbahen së bashku. Ndërvarësia e tyre buron nga morali i ndërgjegjes: Obligimi moral është një forcë lidhëse që shkon përtej dëshirës ose dobisë. Këto komunitete mund të nxisin disa vlera të përbashkëta, por brishtësia e lidhjeve në mes të individëve mund ti bëjë këto objektiva shumë sipërfaqësore. Në rastin e peizazheve kulturore, ekziston frika se forcat kundërshtarë që mund të përcaktojnë cilësinë e peizazheve do të mund ta destabilizojnë një komunitet të tillë. Nëse nga njëra anë, mund të pritet një sasi e caktuar e solidaritetit brenda komunitetit, derisa në anën tjetër ekziston gjithmonë frika se disa kompani private të pasurive të patundshme me ndikim të mjaftueshëm mund të dëmtojnë bazën për mirëmbajtjen kolektive dhe të koordinuar të tyre.
- ✓ Komuniteti i hapur apo estetik bazon marrëdhëniet midis individëve në një dimension të jashtëm dhe jo në autonomi (komuniteti racional) ose kontrollin e brendshëm (komuniteti moral). Lidhja me natyrën dhe mjedisin e jashtëm është ndoshta faktori më i rëndësishëm i lidhjes së brendshme. Komuniteti estetik është një komunitet ku dallimi në mes të jashtëmes dhe të brendshmes është i paqartë, një komunitet ku vëzhguesi është edhe pjesëmarrës. Opozita në komunitetet racionale dhe morale ruan dallimin midis vëzhguesit dhe pjesëmarrësit në atë mënyrë që gjykimet bëhen në mënyrë të pavarur nga veprimet dhe mund të shpie tek strategjitë personale. Në komunitetin estetik, pjesëmarrës është kryesisht një person i përkushtuar dhe kjo i inkurajon të tjerët. Vetëdija e vëzhgimit është dytësore dhe e varur. Duke njohur reciprocitetin shumëdimensional të një peizazhi kulturor, ne njohim dimensionin social dhe kushtet e përmbushjes estetike të njeriut. Ne i mbrojmë peizazhet kulturore jo si një thesar të jashtëm që do të transmetohet për breza, por si një pjesë e identitetit tonë të vazhdueshëm dhe jetës.

7. Vlerësimi i Trashëgimisë: Garantimi i së Drejtës në Kulturë

Ashtu si të gjitha iniciativat edhe iniciativat kulturore duhet t'iu nënshtrohet vlerësimit. Qëllimi i parë i vlerësimit ekonomik të projekteve të trashëgimisë kulturore është për të kuptuar nëse janë marrë efektet e dëshiruara. Kjo është e

nevojshme për tri arsye: na lejon të kontrollojmë dhe arsyetojmë përdorimin e fondeve, na ndihmon të kuptojmë nëse një veprim i ka prodhuar efektet e pritura dhe i thekson përgjegjësitë e përfshira, na lejon të përcaktojmë nxitjet e reja për arritjen e rezultateve të pritura. Por, dihet gjithashtu se çdo proces i vlerësimit në këtë fushë nuk përbëhet nga një kontabilitet i thjeshtë i pranimeve të pritshme dhe shpenzimeve për një projekt, por është vlerësim i asaj se çfarë do të thotë ky proces në aspektin e mësimit, monitorimit dhe ndërmjetësimit:

- ✓ **Monitorimi:** Mbledhja e informacionit për mënyrën se si janë zhvilluar veprimet është një lloj i vlerësimit të përhershëm. Ky informacion trajton dimensionet e ndryshme të projektit, si dhe ndryshimet nga një periudhë në tjetrën. I jepet akterëve dhe palëve të interesit si pasqyrë e veprimtarisë së tyre, dhe kjo bën të mundur azhurnimin e projektin në përputhje me rrethanat në ndryshim. Ekzistojnë tregues emergjent dhe vigjilent që ndihmon zbatimin e këtij aktiviteti. Grumbullimi i të dhënave periodike mund të ofrojë informacion mbi sjelljen e agjencive relevante administrative dhe në lidhje me atë nëse ata janë duke i bërë korrigjimet e nevojshme. Monitorimi mund të konsiderohet si një burim i vlerësimit të vazhdueshëm në veprim. Shumë shpesh, kjo përcjellje është e fokusuar në normën e shpenzimeve buxhetore. Në këtë rast, monitorimi ka avantazhin e identifikimit të vonësive të papritura apo problemeve me rrjedhën e parasë së gatshme që mund të komprometojë zhvillimin e projektit. Por, ky lloj i monitorimit është me interes të kufizuar dhe duhet të shkojë përtej përcjelljes së thjeshtë të të dhënave buxhetore.
- Rritja e qasjes në njohuri. Pasi informacionet të vihen në dispozicion për përdoruesit, institucionet ofrojnë më shumë informacione për çdo përmbajtje kulturore, nga kontekstualizimi i përmbajtjes (si informacione për kontekstin në të cilën objekti është zbuluar/bërë, kuptimi i vetë objektit, përdorimi i tij, ndërlidhja me objektet tjera, etj) në mënyrë që të fitohet njohuria relevante, duke bashkëvepruar aktivisht me vetë përmbajtjen.

Çështjet e komunikimit dhe interpretimit që kanë të bëjnë me muzetë, sitet dhe atraksionet tjera të trashëgimisë fokusohen në teorinë e të mësuarit dhe komunikimit, përshkrimin për audiencën, nevojat komunikuese të vizitorëve, marrëdhënien me publikun, përgatitjen e projekteve komunikuese, shkrimin e teksteve interpretuese dhe mjetet e mediave të komunikimit, në mënyrë që të nxitet një kuptim më i gjerë i parimeve të përgjithshme të komunikimit efektiv me vizitorët e muzeve dhe të vendeve të trashëgimisë, e cila është e bazuar në praktikat më të mira, kërkime dhe teori të bazuara në komunikim, studime

muzeore, studime kulturore, teori mësuese dhe letërsi për studimet vizitore; dhe për t'i inkurajuar akterët që të marrin përgjegjësinë për ta kuptuar marrëdhënien e muzeve dhe siteve të trashëgimisë me institucionet tjera kulturore dhe arsimore, si dhe vendin e tyre në kuadër të infrastrukturës arsimore.

Sipas gjurmëve strategjike Europeana, janë 4 fjalë kyçe që e vejnë Trashëgiminë Kulturore në dispozicion: agregimi, lehtësimi, distribuimi dhe angazhimi.

“Agregimi” është që të ndërtohet një burim i hapur i besuar për përmbajtjen e trashëgimisë kulturore dhe shkencore, “Lehtësimi” është për ta mbështetur sektorin e trashëgimisë kulturore dhe shkencore nëpërmjet transferimit të njohurive, risive dhe avokimeve; “Distribuimi” është për ta vënë trashëgiminë në dispozicion për përdoruesit kudo që ata janë, kurdo që ata e duan; “Angazhimi” është për të kultivuar mënyra të reja për përdoruesit që të marrin pjesë në trashëgiminë e tyre kulturore dhe shkencore.

Promovimi dhe Komunikimi

Është e rëndësishme që të ndahet me të tjerët koncepti se trashëgimia kulturore nuk është e kufizuar me shfaqje të materialeve, të tilla si monumentet dhe objektet të cilat janë ruajtur me kalimin e kohës, por ajo gjithashtu përfshin shprehjet e jetesës dhe traditat që grupet dhe komunitetet në mbarë botën i kanë trashëguar nga paraardhësit e tyre dhe ua kanë transmetuar pasardhësve të tyre. Pasi që Trashëgimia Kulturore është e bazuar në territor, ne gjithashtu mund të flasim për trashëgiminë territoriale si një shumë e përvojave dhe dëshmime historike të kreativitetit në një territor të caktuar. Ky definicion hapet për shtrirjen e parë: Trashëgimi territoriale janë gjithashtu edhe aftësitë e prodhimit artizanal, teknika të ndryshme që karakterizojnë zona të ndryshme të prodhimit. Këto fenomene të paprekshme duhet të mbahen dhe të ruhen si pasuri të prekshme.

“Trashëgimi e paprekshme kulturore” nënkupton praktikat, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, aftësitë - si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore të lidhura me to – të cilat komunitetet, grupet dhe në disa raste, individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore, siç është definuar nga UNESCO gjatë Konventës për ruajtjen e trashëgimisë së paprekshme kulturore, në Paris në vitin 2003.

Tani, në epokën e informacionit, ideja e ‘objektit’, ‘vizitës’ madje edhe ‘sit’ janë transformuar. Derisa hyjmë në domenin e Trashëgimisë Digjitale çështje ka të bëjë me atë që të krijohet një projekt të komunitetit për ta digjitalizuar dhe për ta krijuar një memorie kolektive – e cila është tërësisht e qasshme “online”.

Duke u kthyer prapa në një supozim të hershëm, TK është e dhënë, kështu që për ta bërë një absurditet, çdo skanim midis trashëgimisë pozitive apo negative: ek-

ziston vetëm ajo që e kemi vënë në dispozicion/të qasshme si trashëgimi "cool". Komunikimi dhe pastaj promovimi i TK nuk është shumë ma ndryshe sesa të ope-rosh me çfarëdo sistem produktiv: Ka të bëjë me shfrytëzimin e faktorit "cool".

Veprimet dhe strategjitë

Marrë parasysh dy fjalët e TK "Ruajtja" dhe "Qasja" ne duhet ta theksojmë menjëherë se për momentin është e pamundur për ta bërë tërë përmbajtjen të qasshme dhe për t'i ruajtur të gjitha që duhet ruajtur. Pra, cilat kriteret të përdoren për zgjedhjen më të arsyeshme? Ne mund të përqipemi që t'i identifikojmë ato kryesoret:

- më të lehtat
- më ekonomiket
- më të shkallëzuarat
- më të përdorurat
- më efektivet në aspektin e komunikimit

Kjo është një procedurë e caktimit të prioriteteve. Por ana tjetër e medaljes sa i përket caktimit të prioriteteve është heqja dorë nga ajo e cila nuk do të jetë e qasshme ose nuk do të ruhet. Në të njëjtën kohë a mundemi ta konsiderojmë ruajtjen si për të gjitha? Po, por do të ishte e sinqertë që ta specifikojmë se është e rekomanduar për një komunitet të caktuar, duke ia filluar nga banorët. A mund ta konsiderojmë qasjen për të gjithë? Po përsëri, por shpeshherë është e dedikuar për një audiencë të veçantë.

Posa që një përmbajtje, një sit, të ruhet atëherë bëhet e nevojshme që për të informatat të jenë në dispozicion - të organizuara të përhapura dhe të promovuara - në mënyrë që të shkohet tek hapi i qasshmërisë. Funkionimi në epokën e globalizimit për ta komunikuar dhe promovuar TK nënkupton, përsëri, kemi të bëjmë me një sistem të produktit që kërkon marka. Kemi hyrë në fushën e Markave të Trashëgimisë. T'i shpjegojmë disa definicione. Çfarë është marka? Sipas Shoqatës Amerikane të Marketingut ne mund ta definojmë një markë "një emër, term, shenjë, simbol apo dizajn, ose një kombinim i tyre, me qëllim për t'i identifikuar mallrat ose shërbimet e një shitësi (siti, apo kombi?) prej atyre të konkurrentëve". Me fjalë të tjera një markë "është një mbledhje e karakteristikave aktuale dhe emocionale që ndërlidhen me një produkt apo shërbim të caktuar dhe e dallon atë produkt apo shërbim nga pjesa tjetër e tregut", Keegan, Moriarty, Duncan & Paliwoda, 1995, Marketing, Canadian Edition, Prentice Hall. Për një kuptim më të mirë le t'i shtrojmë disa pyetje: a është markë logoja e "Nike"? A është "iPhone"? Ndoshta, por unë nuk do ta them atë. Për mua, si një konsumator, është një markë që të gjitha pamjet në mendjen time më sillen rreth këtyre dy shembujve që i kam krijuar. Nga një identitet i thjeshtë tani kemi hyrë në ekuitetin e markës. IDENTITETI I MARKËS është produkt i të gjitha përfaqësimeve

dhe koncepteve mendore që lidhen me markën, kjo imagjinare i krijon kushtet për ta ndërtuar një kapital të besueshëm: EKUITETIN E MARKËS.

Kjo imagjinare përbëhet nga imazhi (marka) pa dyshim, por kryesisht përbëhet nga tregimet.

Shumë shpesh tregimet janë të bazuara në territore. Një pyetje shfaqet: a është marka juaj dhe mallrat e saj, përfaqësuese të trashëgimisë kulturore dhe territoriale të zonës në të cilën ajo ndodhet? Kjo pyetje menjëherë na tregon se si markat komerciale duhet ta ndërlidhin veten me identitetet territoriale për ta mbështetur zhvillimin e tyre. Në tregun global, një projekt bëhet më i vlefshëm kur ai është në gjendje që t'i komunikojë rrënjët e veta kulturore dhe gjeografike dhe kur është dëshmitar i një tregimi. Ne mund të supozojmë se TK është për territorin siç është TREGIMI I MARKËS për një KOMPANI.

Marka territoriale në shkallë të gjerë i takon kombit si shumë e perceptimeve të vullnetshme dhe të pavullnetshme, imazheve dhe emocioneve të ndërlidhura me një njësi gjeopolitike. Kjo do të thotë se një vend nuk mund të jetë markë, por vetëm t'i vejë themelet që të themelohet një markë e mirë. Kjo do të thotë krijimi i një produkti të mirë.

Trashëgimia Kulturore dhe Teknologjitë e Reja

“Digjitalizimi dhe qasshmëria në internet janë mënyra thelbësore për ta theksuar trashëgiminë kulturore dhe shkencore, për ta frymëzuar krijimin e përmbajtjes së re dhe për ta inkurajuar ofrimin e shërbimeve të reja “online”. Ato ndihmojnë për ta demokratizuar qasjen dhe për ta zhvilluar shoqërinë e informacionit dhe ekonominë e bazuar në njohuri”, Këshilli Evropian i Ministrave, me rastin e lansimit të prototipit Evropian, Bruksel, 20 nëntor 2008.

Duke i marrë parasysh disa prej koncepteve të shprehura në paragrafin e mëparshëm në lidhje me qëllimet kryesore dhe rezultatet për ta vënë TK në dispozicion, është e lehtë për ta pohuar se domeni digjital po bëhet gjithnjë e më shumë i rëndësishëm për ta komunikuar dhe promovuar TK. Në bazë të dritares kryesore të grafikut në figurën më poshtë “ekziston një kuptim në rritje se qasja në kulturë është themeli i ekonomisë krijuese”.

<p>“Thirrjet për digjitalizim të financuar nga publiku, që të jetë i qasshëm po bëhen më të zhurshmë. Punimet e domenit publik duhet të mbesin në domenin publik pas digjitalizimit.”</p>	<p>“Barrierat e qasjes teknologjike në internet vazhdojnë të ulen, me kosto në rënie dhe shpejtësia e të dhënave duke u rritur.”</p>	<p>“Personalizimi dhe pjesëmarrja janë gjithnjë e më shumë të nevojshme. Shërbimet e gjeo-lokacionit, realiteti në rritje dhe lojërat i theksojnë këto trende, duke i ofruar përdoruesit frymëzim dhe pjesëmarrje.”</p>
<p>“Pajisjet mobile si telefonat dhe kompjuterët tabletë janë gjithnjë e më shumë të fuqishëm dhe më të popullarizuar për përdoruesin. Pajisjet portative sigurojnë qasje të lehtë në informata e uebit.”</p>	<p>“Ekziston një kuptim në rritje se qasja në kulturë është themeli i ekonomisë krijuese”</p>	<p>“Agregimi në nivel kombëtar duket të jetë mënyra më e efikase dhe më e qëndrueshme për ta agreguar dhe ofruar informacionin.”</p>
<p>“Shkëmbimi i informacionit është normë. Të dhënat ripërdoren dhe bëhen për qëllime tjera, për të krijuar shërbime dhe burime të pasuruara.”</p>	<p>“Ekziston një rritje e platformave dhe aplikacioneve kundrejt faqeve të internetit dhe portaleve. Njerëzit harxhojnë më shumë kohë në platformat si Google apo Facebook.”</p>	<p>“Institucionet kulturore duhet që rënjësisht t'i ndryshojnë praktikat e tyre të punës për të qëndruar relevante në shekullin e 21”</p>
<p>“Angazhimi me kulturë e frymëzon krijimtarinë e njerëzve dhe pasurimin personal.”</p>		

Pasi që është e pamundur që të komunikohen përmbajtjet e njëjta për secilin lloj të audiencës, është e rëndësishme që në të njëjtën kohë të identifikohen dhe të formohen kategoritë e konsumatorëve. Grafikët në figurën e mëposhtme paraqesin dëshmitë se si Multimedia/NTIC duhet të formojnë « Amatorët » si pranues të fundit të komunikimit të TK.



Burimi, Eidelmann 1999

Duke vazhduar me profilizimin, ne mund t'i identifikojmë 2 kategori kryesore të pranuesve nga qasja e tyre kur kanë të bëjnë me teknologjitë e informacionit: Navigatorët dhe Eksploruesit.

Eksploruesit janë ata përdorues të cilët eksplorojnë fuqishëm”. Jashtëzakonisht të ndryshëm në sjellje, ata rrallëherë i bëjnë të njëjtat gjëra dy herë. Kërkimi i tyre për informacion është larg lineares, degëzohet në të gjitha drejtimet, në shumë domene të ndryshme, shumë devijime. Disa aspekte të detyrës hetohen nga ata në të njëjtën kohë, kërkimi është aq lehtë i hutuar (apo i frymëzuar) nga linçe interesante. Shumica e tyre përdorin qasje të ngjashme kur kërkojnë frymëzim.

Navigatorët janë fuqimisht përdorues “Navigator”. Ata janë të karakterizuar nga një model tejet konsistent të ndërveprimit, pothuajse gjithmonë duke e përdorur pikërisht të njëjtën metodë për kërkime në internet, pavarësisht detyrës. Ata i


përdorin faqet e njohura të internetit, ndjekë një shteg relativisht të drejt nga kërkimi e deri në përfundimin e detyrës, ata pothuajse nuk bëjnë asnjë devijim. Shumica prej tyre përdorin një qasje të ngjashme, kur qëllimi është i përcaktuar mirë ose njohuria e detyrës është e mirë.

Pra, nuk ekziston një përdorues objektiv, por të gjithë përdoruesit duan:


- Kërkim të Mirë
- Navigim të Mirë
- Shfletim të Mirë
- Linçe të Mira
- Zotërim të Mirë
- Udhëzime të Mira
- Tavolinë të Mirë Ndhimëse
- Dizajn të Mirë
- Shumë-Gjuhësi të Mirë

Me përkushtimin e përpjekjeve për ta organizuar përmbajtjen në atë mënyrë për t'i plotësuar dëshirat e përdoruesve, askush nuk mund të harrojë që të kujdeset për reputacionin e uebit, që si çdo përmbajtje tjetër, nevojitet që të kontrollohet, monitorohet, mbështetet dhe në fund të përmirësohet nëpërmjet të gjitha kanaleve në dispozicion, sidomos në këtë kohë që është duke e sjellë domenin digjital nga "web2.0" në "Web Squared".

"Web 2.0" ka të bëjë me krijimin e lidhjeve të reja me anë të kontributit njerëzor. Ka të bëjë me ndërtimin e përmbajtjes globale nëpërmjet kontributit të njerëzve që i bëjnë faqet e internetit, portalet...Në perspektivë "Web Squared" ka të bëjë me atë që ta bëjë internetin që të ikë nga ekrani dhe të përhapet në realitet. Kjo ka të bëjë me ndërtimin e përmbajtjes globale nëpërmjet kontributit të çfarëdo pajisjeje (PC, telefona celularë, kompjuterë tabletë...). Në këtë peizazh të lëngshëm janë dy tema tjera që do të kontribuojnë në formimin e sjelljeve digjitale të të gjithë: " Informatika e gjithë-pranishme ", pasi që mundësia e kompjuterëve i është dhënë të gjitha objekteve dhe mjedisëve të jetës sonë dhe "internetit të Gjërave", si një shans i paredaktuar për t'iu dhënë objekteve të pajetë një identitet digjital dhe t'i detyrojmë që të bashkëveprojnë me njëra-tjetrën, jo vetëm me ne siç ka qenë deri më tani.



INFORMATIKA E GJITHË-PRANISHME



RFID - Identiteti i Radio Frekuencës, esenca teknike e internetit të Gjërave

Këto koncepte janë drejtpërdrejt të lidhura me konceptin gjithnjë e më shumë bashkëkohor të “ Muzeut Digjital “ që karakterizohet nga disa subjekte kryesore:

- Ekspozita e trashëgimisë së paprekshme dhe/ose arkivat audio-vizuale
- Lehtësimi i qasjes në koleksione
- Përmirësimi i ndërhyrjes në një mënyrë të qëndrueshme
- Promovimin e shkëmbimeve midis muzeut dhe vizitorëve dhe ndërmjet vizitorëve

Hapat e ardhshëm në evolucionin e Muzeut Digjital janë “RRITJA e MUZEUT” që ka të bëjë me etiketimin e objekteve për ndërtimin e një sistemi të përdorshëm me realitet të rritur dhe “MUZEU INTELIGJENT” i ndërtuar rreth konceptit të mjedisit reaktiv, i vënë në dispozicion nga pajisjet mobile dhe inteligjente.

Në një peizazh aq në zhvillim të teknologjive të informacionit fjala magjike është shpik! Nga prapavija e një qasjeje strategjike procesi i komunikimit të TK fillon me identifikimin e një koncepti të fortë. Një “koncept” është shpikje e mendjes, me një kuptim, aty ku çdo veprim fillon.

Fjalorth nga Maria Luigia Calia

TERMI	PËRKUFIZIMI
Adaptimi për ripërdorim	Ri-adaptimi e një strukture të vjetër për një qëllim apo funksion të ri. Restaurimi gjithëpërfshirës ose rehabilitim i interierit dhe eksterierit. Ndonjëherë përfshin ndryshime gjithëpërfshirëse edhe të interierit edhe të eksterierit.
Adaptimi	Adaptimi nënkupton modifikimin e një vend për ta përshtatur për përdorimin ekzistues ose për një përdorim të propozuar.
Analizë	Interpretimi i rezultateve kërkimore dhe hetimore për ta përmirësuar të kuptuarit e vendeve të trashëgimisë kulturore. Ekzaminimi i një objekti, veprimi, materiali, apo koncepti në detaje, duke e ndarë atë në elementet e veta themelore apo pjesë përbërëse.
Gërmimet arkeologjike	Gërmimet arkeologjike nënkuptojnë çdo kërkim që synon zbulimin e objekteve të karakterit arkeologjik, qoftë nëse kërkimet përfshijnë gërmimin e tokës apo eksplorim sistematik të kryer nën-tokë ose në ujërat territoriale
Trashëgimia arkeologjike	“Trashëgimia arkeologjike” është ajo pjesë e trashëgimisë materiale për të cilën metodat arkeologjike ofrojnë informacion primare. Ajo përfshin të gjitha gjurmët arkeologjike të ekzistencës njerëzore dhe përbëhet nga vendet që kanë të bëjnë me të gjitha manifestimet e veprimtarisë njerëzore, strukturat e braktisura dhe të mbeturat e të gjitha llojeve (përfshirë sitet nëntokësore dhe nënujore), së bashku me tërë materialin e bartshëm kulturor që lidhet me to. (<i>ICOMOS Karta për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë arkeologjike (1990)</i>).
Siti arkeologjik	Çdo lokalitet specifik në të cilin ka prova fizike që njeriu ka banuar në të kaluarën, një sit ku provat për veprimtari të së kaluarës janë duke u hetuar ose janë hetuar duke përdorur disiplinën e arkeologjisë. Një vend i lidhur me aktivitetin njerëzor dhe i cili nëpërmjet hetimeve me teknika arkeologjike, mund të sigurojë prova shkencore, kulturore apo historike, si për profesionin e eksplorimit, vendbanimit, apo zhvillimit.
Konservimi arkitektural	Ndërhyrja në një ndërtesë për t’iu kundërvepruar prishjeve ose për ta siguruar stabilitetin e saj strukturor.

<p>Konservimi</p>	<p>Konservimi nënkupton të gjitha masat dhe veprimet që synojnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore të prekshme, derisa duke siguruar qasjen në të për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Konservimi përkrah konservimin parandalues, konservimin riparues dhe restaurues. Ai përfshin proceset për t’ua ruajtur rëndësinë kulturore të monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe objekteve me vlerë kulturore, siç definohet në nenin 1 të Konventës së Trashëgimisë Botërore, duke përfshirë studimin, mbrojtjen, zhvillimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe interpretimin, shqyrtimin, dokumentimin, trajtimin dhe kujdesin parandalues, të mbështetur nga kërkimi dhe edukimi për burimet e trashëgimisë, nëse ato janë objekte, ndërtesa ose struktura, ose mjedise. Të gjitha veprimet ose proceset që kanë për qëllim ruajtjen e elementeve që përcaktojnë karakterin të një burimi kulturor, në mënyrë që të ruhet vlera e trashëgimisë dhe të zgjate jeta e saj fizike. Kjo mund të përfshijë “Ruajtjen”, “Rehabilitimin”, “Restaurimin”, ose një kombinim i këtyre veprimeve apo proceseve. Rikonstrukcioni ose rikrijimi i një burimi të zhdukur kulturor nuk konsiderohet konservim.</p>
<p>Administrator i konservimit</p>	<p>Një profesionist me njohuri të konservimit i cili është përgjegjës për aspektet administrative dhe implementimin e aktiviteteve të konservimit në përputhje me udhëzimet kombëtare.</p>
<p>Plani i Konservimit</p>	<p>Ky dokument përcakton procesin e konservimit. Ai përcakton se çfarë është e rëndësishme në një vend dhe si rrjedhim cilat politika janë të përshtatshme të cilat do ta mundësojnë se rëndësia e vendit do të mbahet për përdorim dhe zhvillim të së ardhmes.</p>
<p>Procesi i konservimit</p>	<p>Siguron konservimin në të gjitha nivelet, do t’i respektojë vlerat dhe rëndësinë e vendit të trashëgimisë kulturore.</p>
<p>Profesionist i konservimit</p>	<p>Profesionist i konservimit është çdo person i cili ka njohuri, aftësi, arsim dhe përvojë për ta formuluar dhe për të kryer aktivitete të konservimit në përputhje me një kod etik si ky Kod i Etikës dhe Udhëzim për Praktikë. Ata të cilët (historianët e artit, arkitektët, arkeologët, konservatorët, planbërësit, etj) angazhohet në praktikën e konservimit dhe janë të angazhuar për aplikimin e parimeve dhe standardeve më të larta të fushës në të cilën punojnë. Prandaj, përfshin konservatorët në praktikë (të cilët janë të caktuar zakonisht në përputhje me fushat e specializimit p.sh. konservues i pikturave, konservues i tekstilit, konservues arkitektonik), si dhe shkencëtarët të konservimit, teknik të konservimit, edukatorë të konservimit, menaxherë të konservimit dhe konsulentë të konservimit.</p>
<p>Shkencëtar i konservimit</p>	<p>Është një shkencëtar profesionist fokusi kryesor i të cilit është aplikimi i njohurive dhe aftësive të specializuara për t’i mbështetur aktivitetet e konservimit.</p>
<p>Teknik i konservimit</p>	<p>Një individ i cili është i trajnuar dhe me përvojë në aktivitete specifike të konservimit dhe i cili punon i lidhur me ose nën mbikëqyrjen e ndonjë konservatori. Një teknik i konservimit mund të jetë i trajnuar dhe me përvojë në aktivitete specifike të kujdesit parandalues.</p>

Konservatori	Një profesionist, profesioni kryesor i të cilit është praktika e konservimit dhe i cili, përmes edukimit të specializuar, njohurisë, trajnimit dhe përvorjes, formulon dhe implementon të gjitha aktivitetet e konservimit. Njerëz që janë përgjegjës për trajtimin, kujdesin parandalues, dhe kërkimin drejt ruajtjes afatgjatë të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
Konsolidimi	Një trajtim që përdoret për t'i forcuar materialet e prishura, për ta siguruar integritetin e tyre strukturor. Aftësitë dhe materialet tradicionale janë të preferuara. Intervenimi duhet të jetë i kthyeshem. Stabilizimi i zonave të degraduara ose dobësuar duke aplikuar ose bashkëngjitur materiale të cilat mundën që t'i mbajnë të bashkuara.
Aktivitetet kulturore, mallrat dhe shërbimet	"Aktivitetet kulturore, mallrat dhe shërbimet" i referohet atyre veprimtarive, mallrave dhe shërbimeve, të cilat në atë kohë ato konsiderohen si një atribut, përdorim apo qëllim i veçantë, shprehin ose përcjellin shprehjet kulturore, pavarësisht nga vlera tregtare të cilën ato mund ta kenë. Aktivitetet kulturore mund të jenë një qëllim në vetvete, ose ato mund të kontribuojnë në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve kulturore. <i>(Në UNESCO Konventa për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore 2005)</i>
Diversiteti kulturor	"Diversiteti kulturor" i referohet mënyrave të shumfishta në të cilat kulturat e grupeve dhe shoqërive gjejnë shprehje. Këto shprehje janë trashëguar përbrenda dhe ndërmjet grupeve dhe shoqërive. Diversiteti kulturor është bërë i qartë jo vetëm nëpërmjet mënyrave të ndryshme në të cilat trashëgimia kulturore e njerëzimit është shprehur, rritur dhe transmetuar, por gjithashtu edhe nëpërmjet shumëllojshmërisë së shprehjeve kulturore, por edhe nëpërmjet mënyrave të ndryshme të krijimit artistik, prodhimit, përhapjes, shpërndarjes dhe kënaqësive, çfarëdo qofshin mjetet dhe teknologjitë e përdorura. <i>(në UNESCO Konventa për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore 2005)</i> Neni 1 - Diversiteti kulturor: trashëgimi kulturore e përbashkët e njerëzimit merr formë të ndryshme me kalimin e kohës dhe hapësirës. Ky diversitet është i ngulitur në veçantësinë dhe pluralizmin e identiteteve të grupeve dhe shoqërive që e përbëjnë njerëzimin. Si një burim i këmbimit, risisë dhe kreativitetit, diversiteti kulturor është aq i nevojshëm për njerëzimin ashtu siç është bio-diversiteti për natyrën. Në këtë kuptim, ajo është trashëgimi e përbashkët e njerëzimit dhe duhet të njihet dhe të afirmohet për të mirën e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm. <i>(në UNESCO Deklarata Universale mbi Diversitetin Kulturor 2 nëntor viti 2001)</i>

<p>Trashëgimia kulturore</p>	<p>Për qëllime të kësaj Konvente, të mëposhtmet do të konsiderohen si “trashëgimi kulturore”: Monumentet: veprat arkitektonike, vepra të skulpturës monumentale dhe piktura, elementet apo strukturat e natyrës arkeologjike, mbishkrimet, shpellat vendbanime dhe kombinime të karakteristikave, të cilat janë të Vlerës së Jashtëzakonshme Universale e papaguar universale nga pikëpamja e historisë, artit ose shkencës; grupet e ndërtesave: grupe të ndërtesave të ndara ose të ngjitura të cilat për shkak të arkitekturës së tyre, homogjenitetit të tyre ose vendit të tyre në peizazh, janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja historike, arti apo shkenca; sitet : vepra të njeriut ose vepra të kombinuar të natyrës dhe të njeriut dhe zonat që përfshijnë vendet arkeologjike të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja historike, estetike etnologjike apo antropologjike. <i>(në UNESCO Konventa mbi Mbrojtjen e Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore të Botës 1972)</i></p>
<p>Politikat kulturore</p>	<p>“Politikat kulturore dhe masat” iu referohen atyre politikave dhe masave që lidhen me kulturën, qoftë në nivelin lokal, kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar dhe që ose janë të përqendruara në kulturën si të tillë, ose janë të dizajnuara që të kenë një efekt të drejtpërdrejtë në shprehjet kulturore të individëve, grupeve ose shoqërive, përfshirë krijimin, prodhimin, përhapjen, shpërndarjen dhe qasjen në aktivitetet kulturore, mallrave dhe shërbimeve. <i>(në Konventën për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore 2005)</i></p>
<p>Turizmi kulturor</p>	<p>Dega e turizmit objektiv i të cilit është për të siguruar njohuri të madhe për monumentet dhe sitet, duke u fokusuar në autenticitetin historik, ruajtjen, dhe përfshirjen lokale.</p>
<p>Zonat historike dhe arkitektonike</p>	<p>Zonat historike dhe arkitektonike nënkuptojnë çdo grup të ndërtesave, strukturave dhe hapësirave të hapura që përbëjnë vendbanimet njerëzore në një mjedis urban apo rural, kohezioni dhe vlera e të cilit njihet nga pikëpamja arkeologjike, arkitektonike, parahistorike, historike, estetike apo sociale-kulturore. Ndër këto zona ‘, të cilat janë shumë të ndryshme për kah natyra, është e mundur që të dallohen si në vijim, në veçanti: sitet parahistorike, qytetet historike, lagjet e vjetra urbane, fshatrat e zakonshme dhe fshatrat e vogla, si dhe grupe homogjene monumentale, duke kuptuar se si rregull kjo e fundit duhet të ruhet me kujdes dhe të mos ndryshohet</p>
<p>Ndërtesat historike</p>	<p>Ndërtesa të rëndësishme në historinë e arkitekturës, që inkorporojnë karakteristika arkitekturore dhe që kanë luajtur rol historik në zhvillimin lokal kulturor ose shoqëror; mund ose jo të caktohen zyrtarisht.</p>

Mirëmbajtja	<p>Mirëmbajtja do të thotë kujdesi i vazhdueshëm mbrojtës i tekstilit dhe rregullimi i një vendi dhe duhet të dallohet nga riparimi; ajo përfshin veprime të padëmshme të cilat janë të nevojshme për ta ngadalësuar prishjen e një vendi historik. Riparimi përfshin restaurimin ose rindërtimin.</p> <p>Mirëmbajtja kryesisht është e ndarë në 3 kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <u>Mirëmbajtja emergjente</u>: Mirëmbajtja që duhet të kryhet menjëherë, në mënyrë që të stabilizohet struktura për banim në të ardhmen. 2. <u>Mirëmbajtja parandaluese</u>: Veprim që ndërmerret për t'iu shmangur dështimeve të pritura. Mirëmbajtja më e thjeshtë parandaluese është inspektimi i rregullt i sistemeve të ndërtimit. Ky proces gjithashtu monitoron jetën shërbyese të materialeve dhe sistemeve. 3. <u>Mirëmbajtja e rregullt</u>: Aktivitetet që zhvillohen në baza të rregullta. <p>Në terma teknik, mirëmbajtja përbëhet nga inspektime të rregullta të një monumenti apo siti dhe mund të përfshijë në shkallë të vogël trajtimeve (p.sh. pastrim sipërfaqësor, rinovimi i shtresave mbrojtëse etj). Mirëmbajtja parandaluese është një mjet i fuqishëm për ta parandaluar prishjen dhe për t'iu shmangur shkallëve të mëdha të trajtimeve të konservimit-restaurimit. Një program i përshtatshëm i mirëmbajtjes që implementohet pas trajtimit të konservimit, synon që t'i ruajë kushtet e tij të përmirësuara.</p>
Menaxhmenti	<p>Menaxhmenti përfshin gamën më të gjerë të mundshme të veprimeve dhe të vendimeve, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimin e grupit të përshtatshëm të vendimmarrjes dhe procese; • Vlerësimin e rëndësisë • Vendimin për ta hapur ose jo sitin për vizitorët • Miratimin e punëve në sit dhe konservimit fizik • Krijimin e strukturave të vendimmarrjes për t'i implementuar strategjitë • Rregullimin e të drejtave të qasjes apo mjetet për të arritur deri tek qasja (si transporti) • Vendimin për të mos marrë veprime.
Plani i menaxhimit	<p>Një dokument i cili detajon se si të bëhet kujdesia për karakteristikat e trashëgimisë dhe të jo trashëgimisë së një vendi. Ai mund të përmbajë një plan konservimi dhe/ose komponentët e tij, duke përfshirë edhe kontekstin ekonomik dhe politik i cili ndikon në përdorimin e vendeve.</p>

<p>Ruajtja</p>	<p>Ruajtja nënkupton mirëmbajtjen e teksturës së një vendi në gjendjen e tij ekzistuese dhe ngadalësimin e prishjes. Është një proces për aplikimin e masave për ta mbajtur formën ekzistuese, integritetin dhe materialin e ndonjë ndërtese apo strukture dhe formën ekzistuese dhe mbulesën vegjetative të një siti të ndërlidhur me restaurimin dhe rehabilitimin, adaptimi për ri-përdorimin e strukturave historike. Mbrojtja e pasurisë kulturore nëpërmjet aktiviteteve të cilat e minimizojnë prishjen kimike dhe fizike dhe dëmet dhe që të parandalojnë humbjen e përmbajtjes informative. Qëllimi kryesor i ruajtjes është që të zgjatet ekzistenca e pasurisë kulturore.</p> <p>Të gjitha veprimet e ndërmarra për ta ngadalësuar prishjen, ose për ta parandaluar dëmtimin e pronës kulturore. Ruajtja përfshin menaxhimin e mjedisit dhe kushtet e përdorimit, si dhe mund të përfshijë trajtim në mënyrë që të mirëmbahet një pronë kulturore, aq më shumë që është e mundur, në një gjendje të qëndrueshme fizike. Disa kanë të bëjnë me materialin i cili vlerësohet ekskluzivisht për përmbajtjen e vet informative, për shembull disa materiale arkivore, ruajtja mund të përfshijë ri-formatimin. Aktivitetet tjera përfshirë identifikimin, vlerësimin, interpretimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e burimeve historike, e formojnë një pjesë integrale të lëvizjes për t'i mbajtur elementet nga e kaluara. Ky shpesh përdoret si një sinonim i konservimit; shumë njerëz e përdorin këtë fjalën në një kuptim gjithëpërfshirës, duke përfshirë edhe çështjet që lidhen me kontekstin më të gjerë administrativ, ekonomik, ligjor, politik dhe sociale në të cilën zhvillohet konservimi (p.sh. mbrojtja ligjore, politikat, vetëdijesimi publik).</p>
<p>Konservimi parandalues</p>	<p>Nënkupton të gjitha masat dhe veprimet që synojnë shmangien dhe minimizimin e prishjeve në të ardhmen ose humbjen. Ato kryhen në kuadër të kontekstit ose në rrethinat e një artikulli, por më shpesh një grup të artikujve, pavarësisht moshës dhe gjendjes së tyre. Këto masa dhe veprime janë të tërthorta - ato nuk ndërhyjnë në materialet dhe strukturat e artikujve. Ato nuk modifikojnë pamjen e tyre.</p> <p>Të gjitha veprimet e ndërmarra për ta zvogëluar prishjen dhe dëmtimin e pronës kulturore. Kjo arrihet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave nëpër fushat si ndriçimi, kushtet mjedisore, cilësia e ajrit, menaxhimi i integruar nga insektet e dëmshme; trajtimi, paketimi dhe transporti, ekspozita, magazinimi, mirëmbajtja, përdorimi, siguria, mbrojtja nga zjarri, dhe gatishmëria emergjente dhe reagimi.</p>

Mbrojtja	<p>“Mbrojtja” do të thotë adoptimi i masave që synojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe shtimin e diversitetit të shprehjeve kulturore. “Mbrojtja” do të thotë të miratosh masat e tilla. (Në Konventën e UNESCO-s mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore 2005). Defino aktin apo procesin e aplikimit të masave të dizajnuara për të ndikuar në gjendjen fizike të një prone, duke e mbrojtur apo ruajtur atë nga prishja humbja ose sulmi, ose ta mbulosh apo ta mbrosh pronën nga rreziku apo dëmtimi. Në rastin e ndërtesave dhe strukturave, trajtimi i tillë përgjithësisht është i një natyre të përkohshme dhe parashikon trajtim historik të ardhshëm për ruajtje. Në rastin e vendeve arkeologjike masa mbrojtëse mund të jetë e përkohshme ose e përhershme.</p> <p>Për qëllimet e kësaj Konvente, mbrojtja e pasurisë kulturore do ta përbëjë ruajtjen dhe respektimin e pronës së tillë. (në Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore me rast të Konfliktit të Armatosur me Rregulloret për Zbatimin e Konventës së 1954)</p> <p>Në term ligjore, ruajtja është veprim i nevojshëm për t’ia siguruar kushtet një monumenti, siti apo zone historike për të mbijetuar. Termi është i lidhur edhe me mbrojtjen fizike të vendeve historike për të siguruar sigurinë e tyre kundër vjedhjes apo vandalizmit, si dhe nga sulmet mjedisore dhe ndërhyrje vizuale. Zonat neutrale gjithashtu sigurojnë mbrojtje për zonat historike. Mbrojtja ligjore, e cila është e bazuar në legjislacionin dhe normat e planifikimit, synon të garantojë mbrojtje kundër çdo trajtimi të dëmshëm, të ofrojë udhëzime për veprime të duhura, si dhe të krijojë sanksionet përkatëse ndëshkuese. Mbrojtja fizike përfshin shtimin e kulmeve, strehimoreve, mbulesave, etj, apo edhe heqjen e një objekti të rrezikuara për shkaqe sigurie.</p>
Rindërtimi	<p>Rindërtimi do të thotë kthimi i një vendi në një gjendje të njohur më parë dhe dallon nga restaurimi me futjen e materialit të ri në teksturë. Përfshin ri-krijimin e një ndërtese jo-ekzistuese në sitin e vet origjinal. Bazuar në dëshmitë historike, letrare, grafike dhe pikturë, si dhe arkeologjike, një replikë e origjinalit ndërtohet duke përdorur metoda moderne si dhe/ose tradicionale të ndërtimit. Rikrijimi i një objekti, ndërtese apo strukture e cila nuk ekziston më, mbi bazën e dëshmive arkeologjike, letrare dhe historike (p.sh. fotografitë e vjetra, ditarët), shpeshherë ngre shqetësimet në lidhje me saktësinë, pasi që disa elemente shpesh janë të bazuara në supozime kur nuk gjenden prova. Të gjitha veprimet e ndërmarra për të rikrijuar, në tërësi ose pjesërisht, një pronë kulturore, bazuar në prova historike, letrare, grafike, pikturë, arkeologjike dhe shkencore. Rindërtimi synon promovimin e një kuptimi të një prone kulturore.</p>

<p>Rehabilitimi</p>	<p>Rehabilitimi zakonisht kryhet në mënyrë që të zgjatet jeta një ndërtese dhe/ose qëndrueshmëria e saj ekonomike. Ky mund të përfshijë më shumë përshtatje sesa konservim, por prapë do të vazhdojë të ruajë shumicën e tipareve origjinale të ndërtesës. Ky mund të përfshijë përmirësimin, disa modifikime, rimodelimin rindërtimin, ose meremetimin, si dhe disa riparime. Ky mund të bëhet në eksterierin dhe në interierin e ndërtesës. Ai mund të referohet si i madh apo i vogël. Në bazë të përdorimit të fjalës gjatë viteve të fundit, projektet e rehabilitimit bien disi të mangët ndaj projekteve të rinovimit në masë dhe/ose në koston e punës. Shpesh përdorur si i ngjashëm me rinovimin për ta përshkruar modifikimin e një ndërtese ekzistuese. Ky proces e zgjat jetën e shfrytëzueshme të strukturës nëpërmjet ndryshimeve dhe riparimeve të rëndësishme, derisa ruan atributet e saj arkitektonike, historike dhe kulturore. Definohet si akt ose proces i kthimit të pronës në një gjendje të shfrytëzueshme nëpërmjet riparimit apo ndryshimit, i cili e bën të mundur përdorimin efikas bashkëkohore, duke i ruajtur ato pjesë ose karakteristika të pronës të cilat janë të rëndësishme për vlerat e veta historike, arkitektonike dhe kulturore.</p> <p>Veprimi ose procesi që e bën të mundshme përdorimin e vazhdueshëm bashkëkohor të një vendi historik apo të një komponenti individual, nëpërmjet riparimit, ndryshimit, dhe/ose shtesave, duke e mbrojtur vlerën e tij të trashëgimisë.</p>
<p>Rinovimi</p>	<p>Rinovimi përshkruan nivele të ndryshme të ndërhyrjes, përfshirë rimodelimin, riciklimin dhe rehabilitim. Ai i referohet përmirësimit të ndërtesave ekzistuese apo lagjeve, mund të përfshijë rehabilitimin, rindërtimin dhe disa aktivitete të tjera. Gjithashtu, rinovimet janë zakonisht më të shtrira dhe të kushtueshme sesa këto aktivitetet tjera për një ndërtesë të caktuar. I referohet procesit për të bërë ndryshime të objekteve, veçanërisht të ndërtesave apo strukturave tjera, me qëllim të përmirësimit të gjendje së tyre fizike. Modernizimi i një ndërtese të vjetër historike që mund të prodhojë ndryshime të papërshtatshme apo të eliminojë karakteristika dhe detaje të rëndësishme.</p>

Restaurimi	<p>Restaurimi nënkupton kthimin e teksturës ekzistuese të një vendi në një gjende të njohur më parë, duke i hequr rritjet gjeologjike ose duke i rivendosur komponentët ekzistues pa përdorimin e materialit të ri. Procesi i restaurimit është një operacion shumë i specializuar, qëllimi i të cilit është ruajtja dhe zbulimi i vlerës estetike dhe historike të monumentit, ndërsa është i bazuar në respektin për materialin original dhe dokumentet autentike. Ai duhet të ndalet në pikën ku fillojnë pretendimet dhe në këtë rast nëse kryhet ndonjë punë ekstra e cila është e domosdoshme, duhet të jetë e dallueshme nga përbëra arkitektonike dhe duhet ta mbajnë një vullë bashkëkohore. Restaurimi, në çdo rast duhet të paraprihet dhe pasohet nga një studim arkeologjik dhe historik të monumentit.</p> <p>Procedurat e trajtimit kanë për qëllim kthimin e një prone kulturore në një gjendje të njohur apo të supozuar, shpesh përmes shtimit të materialeve të cilat nuk janë origjinale. Aktivitetet restauruese mund të jetë aq të shtrira dhe të shtrenjta sikurse ato që lidhen me renovimin (ose rehabilitimin) ; megjithatë, ndryshe nga veprimtaritë rinovuese, ato zakonisht bëhen për trashëgiminë apo për qëllime historike dhe janë të bazuara në prova të dokumentuara të gjendjes më të hershme të ndërtesës. Shkalla e intervenimit dhe heqja ose zëvendësimi i pjesëve mund të përcaktohet nga një ngjarje historike lidhur me ndërtimin ose me integritetin estetik. Restaurimi mund të përfshijë heqjen e shtesave dhe ndryshimeve të bëra pas një kohe të caktuar kohore, si dhe rindërtimin e tipareve të humbura më parë. Veprimi ose procesi i saktë i zbulimit, shërimit ose përfaqësimit të gjendjes së një vendi historik apo të një komponenti individual, ashtu si dukej në një periudhë të caktuar në historinë e vet, duke mbrojtur vlerën e vet trashëgimore, vlerësimin dhe përdorimin. Këto veprime kryhen vetëm kur artikulli e ka humbur një pjesë të rëndësishme të vet ose funksionin përmes ndryshimit ose përkeqësimit nga e kaluara. Ato janë të bazuara në respektimin e materialit origjinal. Shpesh herë veprimet e tilla e modifikojnë pamjen e artikullit. Qëllimi i restaurimit është që të zbulohen cilësitë kryesore kulturore të pronës kulturore. Restaurimi është i bazuar në respektin për materialin e mbetur origjinal dhe dëshmitë e qarta të gjendjes së hershme. Akti ose procesi që saktë e përshkruan formën, tiparet dhe karakterin e pronës ashtu si dukej në një periudhë të caktuar kohore, me anë të largimit të karakteristikave nga periudhat tjera në historinë e saj dhe rikonstruksionin e karakteristikave të zhdukura nga periudha e restaurimit.</p>
Rivitalizimi	<p>Një proces i ri-zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të një zone civile ose lagjeje. Rivitalizimi i zonës së trashëgimisë përqendrohet në ndërtesat historike dhe burimet tjera të trashëgimisë për t'i arritur objektivat ekonomik, social dhe kulturor.</p>

Mbrojtja e trashëgimisë së paprekshme kulturore	Mbrojtja nënkupton masat që synojnë sigurimin e realizueshmërisë të trashëgimisë së paprekshme kulturore, përfshirë identifikimin, dokumentimin, kërkimin, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin, zgjerimin, transmetimin, veçanërisht nëpërmjet edukimit formal dhe jo-formal, si dhe rivitalizimin e aspekteve të ndryshme të trashëgimisë së tillë.
Sitet	Veprat e njeriut ose veprat e kombinuara të natyrës dhe njeriut dhe zonat që përfshijnë sitet arkeologjike të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja estetike, historike, etnologjike apo antropologjike.

Bibliografi

Për konventa vizitoni faqen e internetit të

- CoE:
- European Cultural Convention: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Summaries/Html/018.htm>
- Convention for the Protection of the Architectural Heritage of Europe http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/heritage/Archeologie/default_en.asp
- Convention on the Value of Cultural Heritage for Society (Faro, 2005)
- http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/heritage/Identities/default_en.asp
- European Landscape Convention (2000);
- http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/heritage/Landscape/default_en.asp
- European Convention on the protection of Archaeological Heritage (1992):
- <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/143.htm>
- Convention for the Protecting of the Architectural Heritage of Europe (1985)
- <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=121&CM=1&CL=ENG>
- UNESCO Conventions: <http://www.unesco.org/new/en/culture/>
- ICOMOS: http://www.international.icomos.org/centre_documentation/coe_eng.htm
- The Getty Conservation Institute: http://www.getty.edu/conservation/publications_resources/research_resources/charters.html#1990

Kartat Themelore mbi Restaurimin

- Karta e Athinës për Restaurimin e Monumenteve Historike (1931) <http://www.icomos.org/en/charters-and-texts/179-articles-en-francais/ressources/charters-and-standards/167-the-athens-charter-for-the-restoration-of-historic-monuments>

- Karta e Venecias: international charter for the conservation and restoration of monuments and sites (1964) http://www.international.icomos.org/e_venice.htm

The Venice Charter codifies the internationally accepted standards of conservation practice relating to architecture and sites. It sets forth principles of conservation based on the concept of authenticity and the importance of maintaining the historical and physical context of a site or building.

International Organizations:

- **UNESCO (United National Education, Scientific and Cultural Organization):** <http://www.unesco.org/new/en/culture/>
- **Council of Europe:** <http://www.coe.int/aboutcoe/>
- **ICOM (International Council of Museums):** <http://icom.museum/>
- **ICOMOS (International Council on Sites and Monuments):** <http://www.icomos.org/en/>
- **ICAHM (International Committee on Archaeological Heritage Management (a committee of ICOMOS):** <http://www.icomos.org/ica hm/>
- **IFLA (International Federation of Library Associations and Institutions):** <http://www.ifla.org/>
- **OWHC (Organization of World Heritage Cities):** <http://www.ovpm.org/>
- **WMF (World Monuments Fund):** <http://www.wmf.org/>
- **ICCROM (International Centre for the Study of the Preservation and Restoration of Cultural Property:** <http://www.iccrom.org/>
- **European Commission – Education and Culture:** http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/index_en.htm
- **The Getty Conservation Institute:** <http://www.getty.edu/conservation/>



An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

Implemented by:



in consortium with

